Ferid Selimi

QEVERISJA VENDORE
- SHQYRTIME KRAHASIMTARE

Prishtinë
2008

Botues
VATRA

Redaktor:
Akademik Esat STAVILECI

Recensentë:
Prof. Dr. Agim ZOGAJ
Prof. Dr. Ibrahim GASHI

Lektor:
Jonuz FETAHAJ

PËRMBAJTJA

Hyrje 7
1. Përkufizimi i nocionit "Qeverisje Vendore" 8
2. Dokumentet ligjore mbi Qeverisjen Vendore 9
3. Disa fjalë për përmbajtjen e punimit 9

Pjesa e parë 11
Njoftime të përgjithshme për Qeverisjen Vendore dhe Njësitë e saj 13
I. Ndarja e Pushtetit 13
1. Pushteti i Qeverisjes Vendore 14
2. Qeverisja Vendore dhe Pushteti Qendror 16
3. Qeverisja Vendore, veprimtaritë dhe qytetarët 18
II. Njësitë e Qeverisjes Vendore 21
1. Komunat si njësi të Qeverisjes Vendore 21
1.1. Themelimi i Komunës 22
1.2. Përbërësit e Komunës 24
1.2.1. Banorët e Komunës 24
1.2.2. Territori emërtimi dhe kufijtë e Komunës 25
1.3. Të drejtat e Komunës 26
1.3.1. Themelimi i Ndërmarrjeve dhe Bashkëpunimi me Komunat dhe asociacionet e tjera Kombëtare dhe Ndërkombëtare 27
1.3.2. Bashkëpunimi ndërkomunal 28
1.3.3. Marrëveshjet për bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe Komunës 28
1.3.4. Bashkëpunimi i Komunës me fshatrat 29
1.3.5. E drejta e përcaktimit të gjuhës 30
1.4. Statuti i Komunës 30
1.4.1. Vendimi Statutar 31
1.4.2. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit 31
1.4.3. Aktet e tjera të Komunës 32
1.5. Simbolet e Komunës 32
1.6. Interesi i përgjithshëm në realizimin e Qeverisjes Vendore 33
1.6.1. Veprimtaritë Komunale 34
1.6.2. Shërbimet Publike të Ndërmarrjeve Komunale 36
1.7. Buxheti dhe financimi i Komunës 36

1.7.1. Të ardhurat e Komunës 37
1.7.2. Të hyrat e Komunës 37
1.7.3. Pasuria e Komunës 38
1.8. Mbikëqyrja e ligjshmërisë e akteve të Komunës 39
1.8.1. Organet e mbikëqyrjes në Komuna 39
1.8.2. Format dhe mënyra e mbikëqyrjes së punës së Komunave 40
1.9. Mbrojtja e Komunës 40
1.9.1. Mbrojtja e Komunës në gjendje Lufte 41
1.10. Bartja e pushtetit nëpër Komuna 41
1.10.1. Kompetencat e Komunës 42
1.10.2. Punët e besuara Komunës 46
1.10.3. Kompetencat e deleguara 46
1.10.4. Përgjegjësitë e Komunës 47

Pjesa e dytë 51
Udhëheqja dhe Administrata Komunale 53
I. Organet udhëheqëse nëpër Komuna 53
1. Kryetari i Komunës 53
1.1. Zgjedhja, të drejtat dhe detyrat e Prefektit 55
1.2. Kompetencat e Kryetarit të Komunës 57
1.3. Kompetencat e deleguara Kryetarit të Komunës 59
1.4. Përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës, përkatësisht e Prefektit 60
1.5. Mungesa e përkohshme e Kryetarit 61
1.6. Ndërprerja e mandatit të Kryetarit, përkatësisht, e Prefektit 62
1.7. Kryetari-nënkryetari - Konflikti i interesave 64
1.8. Nënkryetari i Komunës 65
II. Kuvendi Komunal 67
1. Funksioni i Kuvendit të Komunës 69
1.1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komunës 70
1.2. Të drejtat e Këshillit të Komunës në Maqedoni 71
1.3. Obligimet dhe të drejtat e këshilltarëve të Kuvendit Komunal 71
1.4. Ndërprerja e mandatit e Këshilltarit të Kuvendit Komunal 73
1.5. Kushtet e shpërndarjes së Këshillit Komunal 74
1.6. Procedura e shpërndarjes së Këshillit 75
1.7. Konflikti i interesave të Këshilltarëve të Kuvendit Komunal 75

1.8. Mbledhjet dhe Dokumentacioni i Kuvendit Komunal .. 76
1.9. Thirrja e mbledhjes së jashtëzakonshme e Këshillit 79
1.10. Procesverbali për mbledhjet e Kuvendit Komunal 80
1.11. Vendimmarrja e Këshillit të Komunës 80
1.12. Kompetencat e Kuvendit të Komunës 81
1.13. Përgjegjësitë e Kuvendit Komunal 84
1.14. Kryetari i Kuvendit Komunal..... 86
1.15. Nënkryetari, përkatësisht zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal 88
1.16. Sekretari i Kuvendit Komunal..... 88
1.17. Komitetet e Kuvendit Komunal në Kosovë..... 89
1.18. Këshilli për Marrëdhënie Ndërnacionale 90
1.19. Komisionet e Këshillit të Komunës në Maqedoni 91
1.20. Përbërja, zgjedhja dhe mënyra e punës në komisione....91
1.21. Kompetencat e komisioneve..... 92
1.22. Komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërime 92
1.23. Komisionet e tjera..... 93
1.24. Bashkësia Ndërkomunale 94
2. Këshilli Komunal në Kosovën Lindore 94
2.1. Kompetencat e Këshillit Komunal në Kosovën Lindore.... 95
III. Administrata Komunale..... 96
1. Administrata Komunale, Përbërja, Funksioni..... 96
1.1. Nëpunësit Lokal 98
1.2. Mbikëqyrja administrative..... 99
1.3. Kompetencat e Administratës Komunale..... 100
1.4. Përgjegjësitë e Administratës Komunale 101
1.5. Kryeshefi i Administratës Komunale 102
1.6. Arkitekti kryesor dhe Kompetencat e tij në Kosovën Lindore..... 103
1.7. Menaxheri dhe Kompetencat në Kosovën Lindore..... 103
1.8. Shërbimet e tjera të Komunës..... 104
1.8.1. Policia Komunale në Malin e Zi dhe në Kosovën Lindore 104
1.8.2. Shërbimi i Sigurisë në Malin e Zi..... 104
1.8.3. Qendra Informative në Kosovë Lindore dhe në Malin e Zi 104

Pjesa e tretë 105
Të drejtat e qytetarëve dhe të drejtat e pakicave kombëtare..... 107
I. Të drejtat e qytetarëve 107

1. Pjesëmarrja e qytetarëve në Qeverisje Vendore 108
2. Qendra informative 109
2.1. Informimi i publikut 110
3. Shërbimi publik i qytetarëve 110
4. Këshilli për mbrojtjen e konsumatorit 110
5. E drejta në vendimmarrje 110
5.1. Iniciativa në Mal të Zi 111
5.2. Iniciativa qytetare 111
5.3. Tubimi i Qytetarëve 112
5.4. Referendumi 113
5.5. Diskutimi Publik 114
5.6. E drejta në peticion 114
5.7. Ankesat dhe vërejtjet e qytetarëve 115
5.8. Vetëkontributi 116
II. Të drejtat e pakicave kombëtare (minoriteteve) 118
1. Përkufizimi i emërtimit pakicë kombëtare (minoritet) dhe trajtimi i tyre 118
2. Integrimi i minoriteteve në Qeverisjen Vendore 119
2.1. Përdorimi i gjuhës së pakicave kombëtare 120
2.2. Përdorimi i simboleve Kombëtare 123
2.3. Përfaqësimi i pakicave kombëtare (minoriteteve) 124
2.4. Posti i zëvendëskryetarit, nënkryetarit të Kuvendit të Komunës 124
3. Përfaqësimi i pakicave nëpër Komisione, Këshilla e Pleqësi 124
3.1. Komiteti i komuniteteve (i bashkësive) 125
3.2. Komiteti për ndërmjetësim 126
3.3. Zyra e komunitetit në Kosovë 127
4. Shërbimi civil dhe të drejtat e pakicave 127
5. E drejta e pakicave në bashkëpunim me Komunat dhe asociacionet e tjera 128
6. Kompetencat e zgjeruara për Komunat me popullsi serbe në Kosovë 129
6.1. E drejta e Komunave me popullsi serbe në Kosovë për arsim të lartë dhe shëndetësi dytësore 130

Shqyrtime përfundimtare 131
Concluding analyses 140

BIBLIOGRAFIA 147

HYRJE

Një sistem politik demokratik nuk do të mund të paramendohej pa ekzistimin e një shkalle të zhvilluar të Qeverisjes Vendore, ku qytetarët do të mund t'i realizonin të drejtat më elementare brenda për brenda saj. Duke pasur për bazë të drejtën elementare të jetës, ata pretendojnë: Të drejta dhe liri themelore për një jetë normale, të cilat do t'i përmbushnin nevojat më elementare jetësore; Udhëheqje më të drejtë dhe administrim të veprimtarive publike me karakter të interesit të përgjithshëm; dhe Vendosje të drejtpërdrejtë nëpër njësitë e Qeverisjes Vendore, që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të banorëve lokal. Janë mbase këto kërkesa elementare që kanë për tendencë të arrijnë drejt një demokracie dhe të ndërtimit të një shoqërie civile më të avancuar si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social, juridik e politik. Meqë, të gjitha shtetet, Qeverisjen Vendore e konsiderojnë si një nga vlerat elementare të arritjeve demokratike dhe me rëndësi të veçantë e sistemit politik në përgjithësi, jam munduar që në këtë libër me titull: "Qeverisja Vendore – Shqyrtime krahasimtare[1], të vë në pah të përbashkëtat dhe dallimet e Qeverisjes Vendore të shteteve që me dekada kishin jetuar bashkë, në Jugosllavi. Maqedonia që nga fillimi i viteve 90-ta, është shtet më vete dhe ka të gjitha atributet e pavarësisë. Mali i Zi, në vitin 2006 shpalli pavarësinë. Ndërkaq Kosova, u pavarësua nga Serbia më 17 shkurt të vitit 2008. Presheva e Bujanoci gjenden në pjesën më jugore të Serbisë e në Lindje të Kosovës. Këto Komuna, me shumicë shqiptare, kanë mbetur ende nën kufijtë administrativ të Serbisë, por në vitin 1992 kanë organizuar Referendumin për Autonomi Politike Territoriale

[1] Në këtë libër bëhet fjalë për shqyrtimet krahasimtare të Qeverisjes Vendore në Kosovë, në dy komunat e Kosovës Lindore (Preshevë e Bujanoc), Maqedoni e Mal i Zi (shënim i autorit).

me të drejtë bashkimi me Kosovën e që mbi 90% e popullatës shqiptare të atjeshme i kanë thënë "po" pyetjes së parashtruar në atë Referendum. Që të dyja Komunat, qeverisen nga shqiptarët dhe meqë gjenden në pjesën lindore të Kosovës, ato i konsiderojmë si Komuna të Kosovës Lindore. Këto Komuna, Qeverisjen Vendore e udhëheqin dhe e administrojnë nëpërmjet Ligjit mbi Vetadministrimin Lokal të Serbisë, duke pasur për bazë interesin e përgjithshëm të banorëve lokal. Andaj, kujtoj që është arsye e fortë të shtjellohen të përbashkëtat dhe dallimet e këtyre katër vendeve që dikur jetonin nën një kulm të quajtur Jugosllavi, e që tani kanë pavarësinë e tyre. Kësisoj, nëpërmjet komentimeve të ligjeve në fuqi dhe dokumenteve të tjera ligjore që rregullojnë ose pretendojnë një Qeverisje më të avancuar Vendore, jam munduar t'i bëj një vështrim krahasimtar të gjitha segmenteve që e përbëjnë Qeverisjen Vendore në këto vende. Për të kuptuar më mirë çështjen që po parashtroj, të qartësoj nocionin Qeverisje Vendore.

1. Përkufizimi i nocionit "Qeverisja Vendore"

Fjalori i Oxfordit Qeverisjen Vendore e sheh si: *"Institucion qeverisës që ushtron autoritetin në një zonë territorialisht të përcaktuar të vendit"*.[2] Sipas këtij përkufizimi, mund të konstatohet që Qeverisja Vendore ka të bëjë me një qeverisje të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të banorëve lokal e që aktivitetin dhe pushtetin e vet e shtrinë në një hapësirë të ngushtë, të përcaktuar brenda një shteti. Kështu, me të drejtë mund të konstatohet që *"qeverisja territoriale, përkatësisht qeverisja me njësitë territoriale, është një proces shumë i përbërë dhe mund të thuhet se përbëhet nga shumë funksione, përkatësisht veprimtari"*.[3] Andaj, ia vlen të merremi me këtë problem dhe sfidat me të cilat përballet ajo.

---

[2] Iain Mc Lean. Fjalor Politik. Tiranë, 2001, faqe 479

[3] Esat Stavileci: Hyrje në Shkencat Administrative. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës. Prishtinë, 1997, Fq. 247

2. Dokumentet ligjore mbi Qeverisjen Vendore

Dokumentet që bëjnë fjalë për Qeverisjen Vendore, si Kushtetutat; Ligjet mbi Vetadministrimin Lokal (Rregulloret në Kosovë të cilat u shfuqizuan me miratimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës); Statutet e Komunave të ndryshme; Karta Evropiane e Autonomisë Lokale; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut; si dhe Të drejtat mbi përdorimin e gjuhës; vënë në pah të gjitha obligimet, të drejtat, kompetencat e përgjegjësitë e Qeverisjes Vendore.

Duke shfletuar këto dokumente ligjore, si dhe literaturën ndihmëse të autorëve të ndryshëm që për temë kishin Qeverisjen Vendore, ose kishin përmendur këtë temë, u përpoqa të vë në shesh të përbashkëtat dhe dallimet e Qeverisjes Vendore, që kanë mes veti, këto shtete.

3. Disa fjalë për përmbajtjen e punimit

Duke marrë për bazë gjithnjë, dokumentet që përmenda më lart si dhe mendimet e ndryshme të teoricienëve modern, u përpoqa që:

- të paraqes realitetin ekzistues; dhe
- të bëj një krahasim të atij realiteti ekzistues;

I tërë materiali që përbën këtë punim është ndarë në tri pjesë. Pjesa e parë, ka të bëj me njoftime të përgjithshme mbi Qeverisjen Vendore dhe njësitë e saj. Në këtë pjesë është bërë fjalë për Funksionimin, Organizimin, dhe udhëheqjen e Qeverisjes Vendore në Kosovë, Kosovë Lindore, Maqedoni e Mal i Zi, sipas Kushtetutave, Ligjeve që rregullojnë Qeverisjen Vendore, Statuteve, përkatësisht Vendimeve Statutare. Aty në pika të përgjithësuara paraqitet ndarja e pushteteve në mes të organeve të Komunës, marrëdhënieve në mes saj dhe Pushtetit Qendror si dhe për veprimtaritë dhe obligimet që ka ndaj

qytetarëve. Këtu, kam bërë fjalë edhe për njësitë e Qeverisjes Vendore, përkatësisht Komunat, duke filluar nga themelimi, territori, kufijtë, bashkëpunimi me organizatat e tjera, kompetencat, përgjegjësitë, mbikëqyrjen e ligjshmërisë, mbrojtjen e saj etj.

Në pjesën e dytë kam trajtuar udhëheqjen dhe administratën Komunale duke filluar nga organet e Komunës, njësitë e saj dhe veprimtaritë që ato kryejnë. Në këtë pjesë, jam munduar të paraqes çështjet që kanë të bëjnë me udhëheqjen, zgjedhjen e tyre, kompetencat, të drejtat, vendimmarrjen e deri te Komisionet a Komitetet që themelohen në kuadër të Komunës. Më pas kam shtjelluar Administratën Komunale. Aty kam bërë fjalë për organizimin e saj dhe ndarjen e detyrave si dhe shërbimeve publike.

Pjesa e tretë ka të bëj me të drejtat e qytetarëve dhe të pakicave kombëtare në Qeverisjen Vendore. Në këtë pjesë flitet për pjesëmarrjen e tyre direkte, iniciativat qytetare, tubimet, referendumet, debatet publike, informimi, vetëkontributi etj.

Sa i përket të drejtave të pakicave kombëtare, ato i kam shtjelluar duke filluar nga e drejta në përfaqësim, të drejtën e gjuhës, simboleve kombëtare etj.

Kësisoj, jam munduar t'i zbërthej problemet që kanë të bëjnë me Qeverisjen Vendore duke krahasuar në mes vete. Kjo nuk do të thotë e as pretendoj që ky trajtim imi, të jetë "fjala e fundit" por jam munduar së paku të jap një kontribut në zbardhjen e të drejtave, kompetencave, obligimeve, përgjegjësive, si dhe veprimtarive tjera të të Qeverisurit Vendor, në këto vende. Sa ia kam arritur, mbetet të vlerësohet.

PJESA E PARË

NJOFTIME TË PËRGJITHSHME PËR QEVERISJEN VENDORE DHE NJËSITË E SAJ

Qeverisja Vendore, në Kosovë, në Kosovën Lindore, në Maqedoni e Mal të Zi, organizohet dhe udhëhiqet sipas Kushtetutave, Ligjeve të Vetadministrimit Lokal, (në Kosovë deri më 17 shkurt të vitit 2008, Qeverisja Vendore ishte rregulluar nëpërmjet Rregulloreve të UNMIK-ut: Rregullores: 2000/45, përkatësisht Rregullores 2007/30, por që me aprovimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, këto rregullore u shfuqizuan), si dhe Statuteve, përkatësisht Vendimeve Statutare të Komunave të të gjitha shteteve që janë objekt shtjellimi.

Njësitë që bartin Qeverisjen Vendore, sipas Kushtetutave dhe Ligjeve mbi Qeverisjen Vendore të këtyre shteteve, janë Komunat. Ato, kanë karakterin e personit juridik. Si të tilla, kanë organet e veta, statutin si aktin më të lartë juridik, simbolet dhe festën e tyre. Qytetarët që jetojnë nëpër Komuna, në të katër vendet, konsiderohen banorë lokal që nënkupton të gjithë ata persona që janë të vendosur me banim ose kanë pasuri të patundshme në territorin e asaj Komune.

I. Ndarja e Pushtetit

Në Kosovë, organi më i lartë i Komunës deri para zgjedhjeve të Nëntorit të vitit 2007, ishte Kuvendi. Kuvendi Komunal nga radhët e veta, zgjidhte Kryetarin dhe organet e tjera udhëheqëse. Nga nëntori i vitit 2007, doli edhe organi tjetër: Prefekti. Ky është organi i dytë i Komunës i cili sipas Rregullores mbi Zgjedhjet në Kosovë (Rregullore 2007/27) zgjedhet drejtpërdrejtë nga vota e qytetarit. Kështu, sipas Rregullores në fjalë, Komunat në Kosovë bënë dy organe: Kuvendin Komunal dhe Kryetarin. Sipas Rregullores 2007/30 të UNMIK-ut, Kryetari i Komunës ishte edhe

kryesues i Kuvendit. Mirëpo, me aprovimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nga Parlamenti i Kosovës, Qeverisja Vendore sërish pësoi ndryshime. Kështu bazuar në këtë Ligj, Kryetari i Komunës në Kosovë do të zgjedhet nga zgjedhjet e drejtpërdrejta dhe demokratike, do të thotë nga vota e lirë e qytetarëve për një mandat katër vjeçar, por, nuk do të bart më funksionin e kryesuesit të Kuvendit Komunal. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Kosovë do të zgjedhet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Në Kosovën Lindore janë tri organe që ndajnë pushtetin, ato janë: Kuvendi i Komunës, Prefekti i Komunës i cili zgjedhej drejtpërdrejtë nga vota e qytetarëve. (Me ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë, më nuk parashihet që ky organ të zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vota e fshehtë e qytetarëve, por zgjedhet nga anëtarët e Kuvendi të Komunës). Organ i tretë në këto dy Komuna të Kosovës Lindore, paraqitet Këshilli Komunal. Ndërkaq në Maqedoni e Mal të Zi janë dy organe: Këshilli Komunal (në Maqedoni) përkatësisht Kuvendi i Komunës në Mal të Zi dhe Kryetari i Komunës. Siç shihet nga kjo që shtjellova më lart, si në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, janë nga dy Organe udhëheqëse: Kuvendi Komunal që ka funksionin e legjislativit dhe Kryetari i Komunës me funksion të ekzekutivit. Ndërsa në të dy Komunat e Kosovës Lindore paraqitet edhe Organi i tretë që ndihmon Kuvendin e Komunës dhe Kryetarin e Komunës në kryerjen e punëve të tyre, si dhe kryen punë që bien në kompetenca të veta. Ky është Këshilli Komunal.

1. Pushteti i Qeverisjes Vendore

Në të gjitha Komunat e këtyre shteteve, Qeverisja Vendore organizohet dhe udhëhiqet nga njerëz të zgjedhur nga vota e lirë e qytetarëve me të drejtë vote. Kosova, ndryshe nga Kosova Lindore, Maqedonia e Mali i Zi, që nga Qershori i vitit 1999 deri më 17 shkurt 2008, kur edhe shpalli pavarësinë, ishte nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut, do të thotë: udhëhiqej prej këtij Asociacioni Ndërkombëtar. (Kjo nuk do të thotë që UNMIK-u është larguar nga Kosova, por ky organizëm politik është rikonfiguruar dhe ende vepron, por ka qasje tjetër). Shi për këtë,

me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ishte autorizuar Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, për të organizuar dhe mbikëqyrur zhvillimin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes të Kosovës deri në vendimin politik të statusit përfundimtar të Kosovës. Në këtë mënyrë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të përgjithshëm të KB, në vitin 2000, kishte shpall Rregulloren 2000/45, ku ishin përshkruar të gjitha kompetencat, përgjegjësitë, obligimet, të drejtat dhe mënyrat e udhëheqjes së Qeverisjes Vendore në Kosovë. Rregullorja 2000/45, e cila kishte mbështetjen në Rregulloren 1999/1 e lëshuar nga UNMIK, u shfuqizua nga Rregullorja 2007/30. Kështu si Rregullorja e parë ashtu edhe kjo e dyta që hyri në fuqi në tetor të vitit 2007, bazoheshin në po të njëjtat Rregullore, të miratuara nga UNMIK. Si e tërë Rregullorja 2007/30, kishte përcaktuar të gjitha kompetencat, përgjegjësitë, obligimet dhe të drejtat e Qeverisjes Vendore, me disa ndryshime të vogla. Rregulloret ishin firmosur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Kombeve të Bashkuara, "d*uke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, mbi autoritetin e Misionit të Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 2000/1, të datës 14 dhjetor 2000 mbi strukturën e Përbashkët Administrative të Kosovës*".[4] Me Rregulloren 2007/30, ishin përcaktuar qartë ndryshimet që ishin bërë sidomos duke nxjerrë edhe një organ: atë të Kryetarit të Komunës, i cili ka rol të rëndësishëm në Qeverisjen Vendore në Kosovë. Që të dyja këto Rregullore mbështeteshin në Kartën Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale e sidomos nenit 3, ku flitet për përcaktimin e të drejtave dhe të kompetencave të organeve Vendore, për të rregulluar dhe udhëhequr një pjesë të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre që janë në interes të popullatës së Kosovës. Pos dokumenteve që përmenda më lart, vlen të përmend edhe dy Rregullore të tjera që kishin të bënin me Qeverisjen Vendore në Kosovë e ato ishin: Rregullorja 2001/36, e miratuar në vitin 2001, që bën fjalë për Shërbyesit civil në Kosovë, si dhe Rregullorja

[4] Shih: Rregullore Nr. 2007/30: Për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës. Fq. 1

2007/27 që bën fjalë për zgjedhjet. Si Rregulloret në fjalë, ashtu edhe Ligji i miratuar kohë më parë që rregullon Qeverisjen Vendore në Kosovë, kishin, përkatësisht ka parasysh pesë dokumente evropiane që bëjnë fjalë për vetëqeverisjen, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen dhe të drejtat e pakicave edhe atë:

Nën një: Kartën evropiane mbi vetëqeverisjen lokale

nën dy: Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokollet e tyre;

nën tre: Kartën evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave;

nën katër: Konventën e Këshillit Evropian për mbrojtjen e pakicave kombëtare; dhe

nën pesë: Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave.

Me miratimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Komunat ndryshuan të punuarit. Do të thotë, ato që nga miratimi i këtij ligji e sidomos pas 15 Qershorit, kur hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Rregulloret, pushuan së funksionuari dhe Komunat qeverisen duke iu referuar këtij Ligji që bazohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e që pos dokumenteve ligjore evropiane që përmenda më lart, mbështetet edhe në Dokumentin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari.

2. Qeverisja Vendore dhe Pushteti Qendror

Shpallja e Rregullores 2000/45, në Kosovë, u mor si hap i parë drejt bartjes së përgjegjësive administrative nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), te vendorët. Me anë të kësaj rregulloreje, popullit dhe instancave politike kosovare u bë e qartë që: "*Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e mban tërë pushtetin që i është dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ai e ka fjalën përfundimtare në marrjen e vendimeve përkitazi me çdo dispozitë të kësaj Rregulloreje*".[5] Ky ishte një fakt, që do të mund të merrej si dëshmi e që karakterizonte një ndryshim

[5] Rregullore 2007/30, Për Ndryshimin e Rregullores 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, neni 46.1

nga shtetet fqinje. Derisa në Kosovën Lindore, Maqedoni e Mal të Zi si Pushtet Qendror paraqiten Qeveritë e tyre, në Kosovë, Parlamenti, Qeveria dhe Presidenti ishin nën hijen e UNMIK-ut. Pushtet Qendror, deri në pavarësimin e Kosovës, ishte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Mirëpo, nga 17 Shkurti i vitit 2008, e sidomos me miratimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, dolën në shesh ndryshimet e para. Kështu, më nuk figuron Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, si pushtet i tërë, por, me anë të këtij ligji janë rregulluar funksionet, kompetencat dhe të drejtat e Komunave për pa përmendur Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara edhe pse në Kosovë tashmë është instaluar EULEX-i, i cili është nën ombrellën e OKB-së, e ku thuhet që UNMIK-u është rikonfiguruar. Sipas të dhënave të deritanishme, thuhet që EULEX do të ketë rolin e mbikëqyrësit dhe këshillëdhënësit sidomos për sa u përket drejtësisë, policisë dhe të drejtave të pakicave e në veçanti të drejtave të pakicës serbe. Andaj tani e tutje, Qeverisja e Komunave do të bëhet nëpërmjet Ligjit që mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e që ka të bëjë me të gjitha veprimtaritë e kompetencat që nuk janë të rezervuara për Pushtetin Qendror të Republikës së Kosovës. Do theksuar që Ligji që rregullon Qeverisjen Vendore në Kosovë, qartëson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e saj. Kështu, *"ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brendakomunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror."*[6] Që në fillim të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, janë përcaktuar parimet kryesore si do të funksionojë kjo Qeverisje nëpër Komunat e Kosovës.

Qeverisja Vendore në Kosovën Lindore e në Maqedoni, po ashtu mbështetet në Ligjet për Qeverisje Vendore të tyre, për të realizuar të drejtat e qytetarëve në çështjet që kanë të bëjnë për interesin e përgjithshëm të banorëve lokal. Këto veprimtari janë të

[6] Ligji mbi Vetadministrimin Lokal i Republikës së Kosovës, neni 2. Alinea 1

përcaktuara me ligj dhe me Kushtetutë, ashtu që janë vënë raportet në mes të Qeverisjes Vendore dhe asaj Qendrore.

Realizimi i Qeverisjes Vendore, në Mal të Zi, sipas Ligjit në fuqi mbi Qeverisjen Vendore bëhet në bazë të veprimeve demokratike, decentralizimit të pushtetit, si dhe autonomisë në marrjen e vendimeve që u përkasin kompetencave që u janë dhënë Komunave. Kjo qeverisje po ashtu bazohet në ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga organet Komunale, profesionalizmit në kryerjen e veprimtarive, efikasitetit të punës së organeve të Qeverisjes Vendore si dhe bashkëpunimit me Pushtetin Qendror. Nga kjo sa u tha, del një pasqyrë e qartë e raporteve në mes të Pushtetit Qendror dhe organeve të Qeverisjes Vendore në të gjitha këto vende.

3. Qeverisja Vendore, veprimtaritë dhe qytetarët

Komunat e Kosovës, më parë, kryenin të gjitha veprimtaritë që nuk ishin rezervuar për UNMIK-un, ndërkaq tani, kryejnë të gjitha veprimtaritë që janë të interesit të përgjithshëm lokal e që nuk janë të rezervuara për pushtetin Qendror. Në këtë shtet të ri, disa veprimtari u janë dhënë si kompetenca të zgjeruara Komunave të populluara me pakicën serbe e që në tri vendet tjera u takojnë Pushteteve Qendrore.

Komunat e Kosovës Lindore kryejnë veprimtari që nuk i takojnë kompetencave të Pushtetit Qendror, por, në raste të veçanta mund t'u delegohen edhe veprimtari që i takojnë Pushtetit Qendror. Meqë, Pushteti Qendror i Serbisë në kuadër të menaxhimit, udhëheqjes, qeverisjes e kontrollit të territorit të vet, ka paraparë edhe një institucion të quajtur Autonomia Territoriale, njësive të Qeverisjes Vendore me anë të rregullores të organeve të Autonomisë Territoriale u besohet kryerja e disa veprimtarive që i takojnë dhe janë nën kompetencë të Autonomisë Territoriale. Delegimi apo besimi i këtyre veprimtarive nga Autonomia Territoriale në ato Komunale bëhet në atë mënyrë që sigurimi i të gjitha mjeteve përcjellëse bëhet nga Pushteti Qendror, përkatësisht Autonomia Territoriale. Sa u përket punëve të besuara, Komuna ka të drejtën e nxjerrjes në mënyrë të pavarur të rregulloreve dhe akteve të tjera si dhe drejton veprimtaritë bazuar

në kompetencat që i ngarkohen. Ato financohen nga burimet vetanake si dhe nga mjetet shtesë që sigurohen nga Pushteti Qendror apo donacionet e tjera.

Në Maqedoni, me Qeverisje Vendore nënkuptohet realizimi i vetadministrimit vendor drejtpërdrejt dhe nëpërmjet përfaqësuesve në Organet Komunale, si njësi të Qeverisjes Vendore nëpër zonat e caktuara, që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të banorëve të atyre zonave. Po ashtu edhe në Mal të Zi, Komunave u janë dhënë kompetenca e përgjegjësi për kryerjen e disa veprimtarive që kanë të bëjnë me atë territor. Këto veprimtari kryhen nëpërmjet organeve të Komunës që dalin nga zgjedhjet e drejtpërdrejta që organizohen çdo katër vjet. Bazuar në dokumentet ligjore (Ligjet), në të gjitha vendet në të cilat po shqyrtojmë Qeverisjen Vendore, Komunave, u janë dhënë kompetenca e përgjegjësi gati të njëjta me pak ndryshime për të realizuar veprimtaritë dhe çështjet që kanë të bëjnë me banorët lokal të një zone të përcaktuar territorialisht.

Qytetarë konsiderohen ata persona që janë të vendosur dhe jetojnë në territorin e asaj Komune, ndërsa zgjedhës, personat që kanë të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur për këshilltar Komunal. Qytetarët në Kosovë, kanë të drejtën t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Të zgjedhurit (këshilltarët komunal nëpër Komunat e Kosovës) në mandatin e parë do të kenë një kohëzgjatje veprimi prej dy vjetësh, ndërsa mandatet tjera do të jenë me kohëzgjatje katërvjeçare[7] siç është e rregulluar edhe nëpër Komunat e tre shteteve të tjera. Duke marrë pjesë në zgjedhje të organizuara nga Pushteti Qendror, qytetarët, drejtpërdrejtë marrin pjesë në Qeverisjen Vendore.

E drejta e qytetarëve për Qeverisje Vendore në Komunat e Kosovës Lindore, realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur. Përfaqësuesit e zgjedhur udhëheqin veprimtaritë që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm për banorët lokal. Me Ligjin mbi Vetadministrimin Lokal, janë paraparë disa të drejta edhe për të huajt,[8] sa i përket

---

[7] Shih: Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës, neni 37, alinea 1

[8] Për informacion më të hollësishëm, shih: Zakon o Lokalnoj Samoupravi Republike Srbije: neni 1

realizimit të Qeverisjes Vendore. Edhe në Maqedoni, qytetarët e realizojnë të drejtën e Qeverisjes Vendore drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet përfaqësuesve në Organet Komunale. Ata, këtë e realizojnë si bashkësi e qytetarëve në një zonë të caktuar, nëpërmjet organeve të veta dhe administratës duke organizuar shërbime publike për të mundësuar kryerjen e veprimtarive që bien në kompetenca të veta. Qeverisja Vendore në Mal të Zi, po ashtu, në vete ngërthen të drejtën e qytetarëve dhe organeve të Qeverisjes Vendore, për të rregulluar dhe drejtuar veprimtaritë e caktuara publike bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e veta që janë në interes të banorëve lokal. Me vendim të Kuvendit të Komunës themelohen bashkësitë lokale. Nëpër këto bashkësi Lokale, qytetarët vendosin dhe marrin pjesë në vendimet për realizimin e nevojave dhe interesave lokale. Mjetet e nevojshme për bashkësinë Lokale sigurohen nga të ardhurat e Komunës, të cilat u lejohen Bashkësive lokale, mjeteve vetanake, mjeteve të tubuara nga vetëkontributi i tyre si dhe ndihmave, dhuratave dhe donacioneve që Bashkësia Lokale mund të sigurojë.

Siç do të shihet nga shtjellimi i kësaj çështjeje me interes për banorët lokal, në këto shtete, pavarësisht që vërehen disa reforma, sidomos në të drejtat e qytetarëve, pushteti i Qeverisjes Vendore nuk është në nivelin e duhur, ngase Pushteti Qendror, nuk u delegon a u beson e as u jep hapësirë organeve të Qeverisjes Vendore për një veprimtari më të madhe në nivel vendor. Ndryshe nga shtetet e tjera evropiane ku *"Shteti u delegon organeve Vendore gjithnjë e më shumë detyra..,"*[9], në këto vende, nuk zbatohet një gjë e tillë. Dhënia e besimit, ose besimi i detyrave e kompetencave Komunave, nuk do të thotë edhe dobësim i Kontrollit i Pushtetit Qendror, por një lehtësim i veprimtarive ku qytetarët do të ishin më afër shtetit.

[9] Kval-Mellbye-Tranoi: Politika dhe Demokracia. Prishtinë, 2006, faqe 93

II. Njësitë e Qeverisjes Vendore

Në Kosovë, më parë, bazuar në Rregulloren 2007/30, e tani bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në Kosovën Lindore, Maqedoni e Mal të Zi, sipas Ligjit mbi Vetadministrimin Lokal, njësi themelore territoriale të Qeverisjes Vendore janë Komunat. Ato kanë të drejtën e ushtrimit të pushtetit vendor, pushtet ky që nuk është i rezervuar për Pushtetin Qendror.

1. Komunat si njësi të Qeverisjes Vendore

Komuna është njësi e Qeverisjes Vendore në të cilën qytetarët e realizojnë të drejtën e vetëqeverisjes lokale. Punët që i përkasin kompetencave të veta i kryejnë përmes organeve të zgjedhura drejtpërdrejtë nga qytetarët. Kanë simbolet dhe pronën e vet. E drejta e Qeverisjes Vendore realizohet nëpërmjet përfaqësuesve të qytetarëve në organet e Komunës dhe me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në vendimmarrje.

Ato mund të nxjerrin Rregullore që i përkasin çështjeve përbrenda kompetencave të Komunës. Të miratojnë ose të nxjerrin Statutin e Komunës, të miratojnë buxhetin Komunal si dhe të nxjerrin akte të tjera të përgjithshme që bien në kompetencë të tyre. Atyre u është dhënë e drejta të rregullojnë dhe të udhëheqin çështjet publike në territorin e tyre brenda kufijve të përcaktuar. *"Çdo Komunë e ka statusin e vet juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë i paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë"*.[10] Ndërkaq me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Komuna në Kosovë pos që është person juridik dhe i ka këto kompetenca që

[10] UNMIK, Rregullore Nr. 2007/30 Për Ndryshimin e Rregullores 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës: neni 2, alineja 4

referuam nga Rregullorja 2007/30, ka të drejtë dhe "*mund të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të Komunës në raport me qytetarët*"[11]. Në përgjegjësinë e Komunave të Kosovës, është që t'u sigurojnë kushte për jetë normale dhe të qetë të gjithë banorëve. Kanë përgjegjësinë e kujdesit për çështje me interes të përgjithshëm, çështje ato, të cilat kanë të bëjnë me Komunën. Në Kosovën Lindore, Komunat si njësi të Qeverisjes Vendore, përpiqen të sigurojnë një jetë normale për të gjithë qytetarët e atij territori.

Në Maqedoni, në kuadër të Qeverisjes Vendore dhe zhvillimit e të prosperitetit të një zone të caktuar të nivelit lokal, ato kryejnë punët të cilat u janë ngarkuar, deleguar e besuar nga Pushteti Qendror. E gjithë kjo bëhet për një Qeverisje, planifikim, udhëheqje, administrim e kontroll më të mirë të burimeve njerëzore si dhe të të mirave materiale të shtetit e që kanë të bëjnë me atë zonë të përcaktuar territorialisht.

Në Mal të Zi, Komuna është njësi territoriale, në të cilën banorët lokal realizojnë të drejtën e Qeverisjes Vendore. Në këtë shtet të ri janë dy Komuna që udhëhiqen nga shqiptarët. Ulqini ka statusin e Komunës ndërsa, Tuzi ka statusin e Komunës Urbane në kuadër të Podgoricës. Derisa Komuna e Ulqinit e ka Statutin, Tuzi punon dhe vepron me Vendim Statutar.

1.1. Themelimi i Komunës

Komunat themelohen me nismë të qytetarëve të atij territori e me pëlqim dhe vendim të Pushtetit Qendror. Në Kosovë, në vitin 2000, u themeluan institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes demokratike dhe të pavarura. Edhe pse ishin themeluar si të tilla, ato nuk e kishin autonominë e plotë në kompetenca dhe përgjegjësi, ngase veprimtaria e tyre varej edhe nga vullneti i Përfaqësuesit Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Në të vërtetë, Komunave u bëhej e ditur që ato mund të ushtronin tërë pushtetin por jo edhe atë pushtet që ishte rezervuar për PSSP me Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara. Mirëpo, pas

[11] Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës, neni 5, alinea 1 paragrafi 3

pavarësisë së Kosovës dhe pas miratimit të Ligjit që ka të bëjë me Qeverisjen Vendore, pas 15 qershorit kur në fuqi hyri Kushtetuta e Republikës së Kosovës, pushteti që mbante PSSP i Kombeve të Bashkuara iu hoq dhe iu dha Pushtetit Qendror të Republikës së Kosovës. Kështu që, tani e tutje Komunat menaxhojnë, udhëheqin, qeverisin e administrojnë me të gjitha veprimtaritë të cilat shprehimisht nuk u janë rezervuar Pushtetit Qendror, do të thotë Parlamentit dhe Qeverisë së Kosovës. Dokumenti Gjithëpërfshirës i Ahtisarit bën përjashtim për kushtet e themelimit të Komunave të reja me popullsi serbe.

Në Kosovën Lindore, është paraparë që si themelimi, ashtu edhe shpërbërja e Komunës, përcaktimi i territorit, i selisë si dhe ndërrimi i kufijve të Komunave, të bëhet, duke marrë parasysh edhe pëlqimin e banorëve të Komunës si dhe Organit kompetent të Autonomisë Territoriale që i përket ajo Komunë.

Në Maqedoni, po ashtu, parashtrohen kushtet e themelimit të një Komune të re. Për t'u arritur një gjë e tillë, do të duhej të plotësohen kriteret sa i përket: numrit të banorëve; zhvillimit të infrastrukturës rrugore, objekteve bashkëkohore ekonomike e industriale; si dhe të jetë një territor ku do të mund të gravitonin qytetarët drejt qendrës pa ndonjë pengesë.

Në Mal të Zi, Kusht për themelimin e një komune është që territori të ketë një hapësirë natyrale; Një tërësi gjeografike e ekonomike që do të ketë komunikim me të gjitha vendbanimet që hyjnë në kuadër të asaj komune; Qarkullimi i qytetarëve dhe i të mirave materiale të jetë i mundshëm drejt qendrës; si dhe infrastruktura rrugore edhe e objekteve bashkëkohore të jenë të zhvilluara.

Nga kjo që u tha më lart, kuptohet që nuk ka ndonjë ndryshim të madh në mes të Kosovës, Kosovës Lindore, Maqedonisë dhe Malit të Zi, sa i përket themelimit të një Komune, pos që në Kosovë, sipas Dokumentit gjithëpërfshirës të Ahtisarit, do të mund të themeloheshin Komuna të reja në territoret (fshatrat) ku jetojnë pakica serbe e që janë shumicë ose janë të populluara kryesisht me serb. Në këto raste, nuk merren parasysh kriteret që do të duhej plotësuar një Komunë.

1.2. Përbërësit e Komunës

Komuna, si tërësi territoriale e një shteti, duhet t'i plotësojë disa parametra për t'u konsideruar Komunë. Ajo do të duhej të kishte popullsinë, me një numër të konsiderueshëm. Ta ketë territorin, emërtimin dhe kufijtë e saj.

1.2.1. Banorët e Komunës

Me emërtimin banorë lokal nënkuptohen të gjithë ata persona që janë të vendosur me banim ose kanë pasuri të patundshme në territorin e asaj komune. Qytetarët janë ata persona që janë vendosur dhe jetojnë në territorin e asaj Komune, ndërsa zgjedhës janë ata persona që kanë të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur për këshilltar.

Organet dhe instancat e Komunës, në Kosovë, kujdesen që banorët e Komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim: race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni dhe mendimi politik. Në këtë drejtim do të duhej përmendur edhe pa marrë parasysh: prejardhjen kombëtare; sociale; pa dallim prone; lindje; apo ndonjë statusi tjetër. Andaj, mund të konstatojmë që Komunat në Kosovë, përpiqen që qytetarët të ndihen të barabartë. Organet dhe instancat Komunale, marrin përgjegjësi të kujdesen që banorët e Komunës të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të drejta për punësim në shërbimet Komunale në të gjitha nivelet. Nëpërmjet politikës dhe praktikës së tyre, ato, vënë në veprim nevojën për të nxitur bashkëjetesën në mes të banorëve si dhe të krijojnë kushte për t'u mundësuar të gjitha komuniteteve të shprehin, të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë që kanë vendbanim të përhershëm në territorin e një Komune, janë banorë të Komunës në fjalë. Nëpërmjet Komunës (organeve të saj) sigurohet e drejta për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, me të cilat disponojnë ndërmarrjet publike dhe institucionet e themeluara nga Komuna si dhe personat fizik e juridik, që kryejnë autorizime publike të besuara nga Komuna. *"Komuna është e obliguar që qytetarëve t'u mundësojë qasje në*

informatat bazë për shërbimet që kryen në mënyrën dhe kushtet e rregulluara me statut"[12]. Nga kjo shihet që pushteti vendor si në Maqedoni, ashtu edhe në shtetet e tjera, është përkujdesur të inkriminojë në ligj edhe obligimin për të informuar dhe shërbyer banorët lokal.

1.2.2. Territori, emërtimi dhe kufijtë e Komunës

Territorin e Komunës e përbëjnë zonat e një ose të më shumë vendbanimeve që hyjnë në atë përbërje. Territori në të cilën themelohet Komuna, paraqet tërësi natyrale e gjeografike e cila është një hapësirë e lidhur ekonomikisht dhe ka të zhvilluar komunikimin në mes vendbanimeve, me selinë si qendër qarkulluese. Mënyra e përcaktimit të territorit është paraparë me ligj në të gjitha vendet. Kështu "*territori në të cilin themelohet Komuna, duhet të paraqesë një tërësi të lidhur natyrore gjeografike dhe ekonomike, me një komunikim në mes të vendbanimeve dhe gravitimin kah qendra si dhe të ketë të rregulluar infrastrukturën dhe objekte me një standard të nivelit të përgjithshëm"*[13]. Si në Kosovë (hiq rastet e veçanta), në Kosovë Lindore, në Maqedoni e Mal të Zi, Komunat janë themeluar ose mund të themelohen në një territor të një vendbanimi, ose të më shumë vendbanimeve, ku konsiderohet që qytetarët kanë lidhje mes veti për nevoja dhe interes të përbashkët. Këtu kihen parasysh dhe kushtet ekzistuese për një zhvillim jetësor dhe material. Në këtë mënyrë, do t'u mundësohet pjesëmarrja qytetarëve në vendimmarrje për nevojat dhe interesat e përgjithshme në nivelin lokal.

Ndërrimi i selisë së Komunës po ashtu është i mundshëm, kur selia e mëparshme nuk i plotëson kushtet e kërkuara për të qenë edhe më tutje seli e asaj Komune.

Komuna ka emrin dhe territorin e vet. "*Territori i Komunës është caktuar me ligj"*[14]. Ky territor, apo kufijtë e Komunës mund

---

[12] Zakon za Lokalnata Samouprava ("Sluzben vesnik na Republika Makedonija" br. 5 od 29 januari 2002 god): neni 8, alineja 2

[13] Po aty: neni 17

[14] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Crne Gore, dok. i cituar: neni 21

të ndryshojnë vetëm me pëlqimin e banorëve lokal e me miratimin e Pushtetit Qendror, do të thotë Qeverisë.

Nëpërmjet Qeverisjes Vendore janë saktësuar kushtet për përcaktimin e territorit, kufijve si dhe emërtimin e Komunës. "*Përcaktimi i territorit, emri, selia dhe kufijtë e Komunës, procedura për themelimin e Komunave të reja (bashkimi, ndarja apo ndërrimi i kufijve) dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me ndarjen territoriale, rregullohen me ligj*"[15].

Përcaktimi i territorit të një komune bëhet me kujdes që kufijtë e Komunës të mos i presin kufijtë kadastral të Komunës. Në këtë mënyrë, territori i Komunës përfshin të gjitha territoret e vendbanimeve që bëjnë pjesë në kufijtë e saj.

Kufijtë e Komunave si në Kosovë, Kosovë Lindore, Maqedoni e Mal i Zi, nuk mund të ndryshohen nga asnjë organ ose instancë Komunale, por ato, mund të ndryshohen vetëm nga Pushteti Qendror. Ky veprim do të mund të realizohej pasi që Pushteti Qendror të jetë konsultuar paraprakisht me banorët e Komunave përkatëse.

1.3. Të drejtat e Komunës

Komuna ndan mirënjohje dhe shpërblime komunale. Mirënjohjet ndahen në shenjë respekti për realizimet e arritura që paraqesin kontribut të veçantë për zhvillimin e Komunës dhe për përparimin e saj të gjithëmbarshëm si dhe afirmimin e sferave ekonomike, shkencore, artistike, kulturore, arsimore, mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes sociale, sportit, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës si dhe sferave të tjera.

Në të gjitha Komunat e këtyre vendeve, dhuratat u ndahen personave fizik dhe juridik nga Komuna, Republika e shtetet tjera. Pastaj edhe organizatave ndërkombëtare e asociacioneve ose përfaqësuesve të tyre. Komunat kanë të drejtë që herë pas here të konsultohen për procedurat e planifikimit dhe vendimmarrjes sa u përket problemeve të Komunës. Ato e kanë të drejtën e konsultimit për planifikimin e veprimtarive publike gjatë përgatitjes të planit hapësinor të Republikës. Për

[15] Po aty: neni 19, alineja 1

hir të mbrojtjes dhe përparimit të interesave të përbashkëta, Komunat mund të bashkohen në bashkësi Komunash. (asociacion) Ky lloj asociacioni ekziston në të gjitha këto vende. Bashkimi i Komunave i përbërë prej dy të tretave të Komunave të Republikës së Maqedonisë, duke pasur për bazë mbrojtjen dhe përparimin e interesave të përgjithshëm që kanë të bëjnë me banorët lokal, ka të drejtë: të bashkëpunojë me Qeverinë për çështjet e rëndësisë të Komunave të këtij shteti; të iniciojë nxjerrjen e ligjeve që kanë të bëjnë me përparimin e Qeverisjes Vendore; të jep propozime dhe projekt-propozime në buxhetin e Republikës së Maqedonisë, në pjesën ku bëhet fjalë për ndarjen e mjeteve të parapara për Komuna; të realizojë bashkëpunim me organizatat e shteteve tjera dhe ka të drejtën e përfaqësimit të Republikës së Maqedonisë në Organizatën Ndërkombëtare të Qeverisjes Vendore.

1.3.1. Themelimi i Ndërmarrjeve dhe Bashkëpunimi me Komunat dhe asociacionet e tjera Kombëtare dhe Ndërkombëtare

Për të përmbushur kërkesat e banorëve lokal në Komunat e Kosovës, Kosovës Lindore, Maqedonisë e Malit të Zi, si dhe për të realizuar të drejtat dhe obligimet e veta, ato, mund të themelojnë ndërmarrje dhe Organizata tjera që kryejnë shërbime publike. Kështu, ato e kanë të drejtën e bashkëpunimit dhe të vëllazërimit me Organizatat e Qeverisjes Vendore si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare të shteteve tjera, me pëlqimin e Qeverisë. Kjo nënkupton që çdo nismë për ndonjë bashkëpunim apo edhe vëllazërim, duhet të aprovohet nga Pushteti Qendror. Kanë të drejtën e bashkëpunimit edhe me Organizatat joqeveritare dhe Organizatat humanitare si dhe me Organizatat tjera në interes të Komunës dhe qytetarëve të asaj ane. Ky bashkëpunim bëhet me qëllim të arritjes së qëllimeve të përbashkëta, planeve dhe programeve zhvillimore si dhe për nevojat tjera që kanë të bëjnë me interesin e përbashkët.

1.3.2. Bashkëpunimi ndërkomunal

Me qëllim të mbrojtjes së interesave të përbashkëta, Komuna, në Kosovë, Kosovë Lindore, Maqedoni e Mal të Zi, me vendim të miratuar nga Kuvendi i Komunës (Këshilli i Komunës), ka mundësi të bashkohet në shoqata. Në Maqedoni, është edhe mundësia tjetër që të merret vendim. Së bashku me Komunat tjera të Republikës të bashkojnë mjetet dhe të formojnë shërbime publike të përbashkëta, me qëllim të realizimit të interesave të përbashkëta dhe kryerjes së punëve të përbashkëta nga kompetencat e tyre. Në marrëveshje me Komunat tjera, mund të formojnë trupa të përbashkët administrativ në sfera të caktuara, me qëllim të zbatimit të kompetencave të caktuara. Komuna merr vendim për bashkëpunim me Komunat e Republikës, me njësitë e vetëqeverisjes lokale të vendeve të tjera si dhe me Organizatat Ndërkombëtare të bashkësive Vendore dhe pushteteve Vendore. Komuna si subjekt, mund të anëtarësohet në Organizatat Ndërkombëtare të pushteteve Vendore. Ka të drejtën e bashkëpunimit me Komunat tjera në kryerjen e punëve që bien në kompetenca të veta. *"Bashkëpunimi ndërkombëtar i Komunave është çdo veprim i Komunave të Republikës së Maqedonisë, të marra në përputhje me ligjin, për të lidh bashkëpunim në mes tyre dhe bashkësive lokale ose të qeverisjes Vendore të një ose të më shumë shteteve tjera, anëtarësimi i asociacioneve të tyre në organizatën ndërkombëtare të bashkësive lokale ose të qeverisjes"*[16]. Nga kjo mund të konstatohet që Komunat, mund të lidhin bashkëpunim me të gjitha Komunat dhe ato organizatat ndërkomunale për të plotësuar kërkesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të banorëve të asaj zone të përcaktuar të atij vendi.

1.3.3. Marrëveshjet për bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe Komunës

Sa u përket marrëveshjeve për bashkëpunim (më parë) në mes të UNMIK-ut dhe Komunave në Kosovë, e tanimë

[16] Zakon za Lokalnata Samouprava, ("Sl. Vesnik na R. Makedonija" br. 5 od 29 januari 2002 god), dok. i cituar, neni:2, alineja 3

Institucionet Qendrore të Kosovës, si dhe Qeverive dhe Komunave të shteteve që po krahasohen në mes vete, ekzistojnë mundësitë që ato të merren vesh rreth bashkëpunimit. Kështu, gjatë planifikimit, programimit dhe implementimit të politikave në fusha të caktuara ose në ndonjërën nga sferat e ndryshme lidhin marrëveshje me Komunën për një koordinim sa më të mirë të punëve. Qeveria bashkëpunon me Komunat për çështjet që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm edhe atë për ligjet që bëjnë fjalë për Komunat; shumën e përgjithshme të donacioneve që duhet t'u ndahen Komunës për vitin vijues kalendarik; burimet e financimit; si dhe për bashkëpunim që u përket çështjeve të interesit të përgjithshëm.

1.3.4. Bashkëpunimi i Komunës me fshatrat

Ajo që ishte e veçantë në Kosovë e që nuk përmendet në Ligjet e Qeverisjes Vendore të Serbisë, Maqedonisë e Malit të Zi është se Komunës në Kosovë me anë të Rregullores 2000/45 i është ngarkuar si detyrë të bëj "*marrëveshje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane përbrenda territorit të saj në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e nevojave të të gjithë banorëve në Komunë*"[17]. Kjo e drejtë për marrëveshje në mes të Komunave dhe fshatrave, vendbanimeve e lagjeve urbane në Kosovë, është paraparë edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës[18]. Çdo Komunë në Kosovë, është e obliguar që brenda për brenda territorit të vet të bëj marrëveshje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane për të siguruar përmbushjen e nevojave të banorëve në atë Komunë. Komuna, mund t'u jep pëlqim fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, për të ushtruar edhe aktivitete të cilat me anë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, hyjnë në përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës. Kështu që këto organizma mund të veprojnë edhe në këto sfera, duke marrë fonde gjegjëse nga Komuna. Por, kjo nuk do të thotë që, fshatrat, vendbanimet dhe

---

[17] United Nations - UNMIK, Rregullore Nr. 2007/30, dok. i cituar, neni: 5, alineja 1

[18] Më gjerësisht, shih: Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës, neni 34, alinea 1.

lagjet urbane nuk do të jenë të detyruara të respektojnë Ligjin në fuqi. Ndërkaq në Kosovën Lindore, Maqedoni e Mal të Zi është paraparë që në kuadër të Komunës të themelohen bashkësitë e qytetit, ato urbane si dhe bashkësitë lokale në fshatra.

1.3.5. E drejta e përcaktimit të gjuhës

E drejtë e Komunës, sipas statuteve të tyre është që të përcaktohen për gjuhët zyrtare që do të përdoren si në dokumentet e shkruara ashtu edhe në të folur nëpër organet Komunale. Ligjet mbi Vetadminsitrimin Lokal të Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi si dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, kanë përshkruar kushtet mbi përcaktimin e gjuhës së shkruar zyrtare nëpër Komuna. Sipas kushteve të përcaktuara në ato dokumente ligjore, duke pasur për bazë edhe Konventën mbi gjuhët rajonale, Komunat në Republikën e Kosovës, kanë rregulluar këtë çështje nëpërmjet statutit të tyre, përkatësisht Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

1.4. Statuti i Komunës

Çdo Komunë në të gjitha këto vende vepron sipas statutit që e miraton Kuvendi Komunal. *"Statuti i Komunës është akti kryesor ligjor që miratohet nga Komuna dhe në pajtim me legjislacionin e qeverisë qendrore që rregullon organizimin e brendshëm të Komunës"*[19]. Kjo lë të kuptohet që Statuti i Komunës, parashtron dhe rregullon kushtet për nismat që dalin nga qytetarët dhe veprimtaritë tjera që janë me interes të përgjithshëm e që kanë të bëjnë me Qeverisjen nëpër Komuna. Nga kjo vihet re që çdo Komunë ka aktet e veta ligjore. *"Akti themelor i njësisë të qeverisjes Vendore është Statuti"*[20]. Ai ka të bëj me rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të Komunave dhe mënyrën si do të realizoheshin ato. Nëpërmjet tij, caktohet

---

[19] Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës, neni 3

[20] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Republike Srbije, dokument. i cituar: neni 10, paragrafi 1

numri i këshilltarëve të Komunës. Përcaktohet mënyra e organizimit dhe e angazhimit të organeve në kuadër të Komunës dhe shërbimeve, përfshirë edhe mënyrën e udhëheqjes së punëve nga qytetarët që i përkasin përgjegjësisë së Komunave. Përcaktohen kushtet e themelimit të bashkësive lokale, puna e tyre, si dhe kushtet për organizimin dhe themelimin e formave të tjera të Qeverisjes Vendore.

Nëpërmjet tij, rregullohen organizimi dhe puna e organeve të Komunës; organizimi dhe puna e pleqësive, komiteteve, komisioneve të Kuvendit a Këshillit; kryerja e punëve që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të asaj zone e që janë në kompetencë të Komunës; mënyra e informimit e qytetarëve; rastet e përjashtimit ose mospjesëmarrjes së publikut dhe medieve në mbledhjet e Kuvendit (Këshillit); mënyra si duhet dorëzuar ankesat dhe propozimet sa i përket punës së organeve të Komunës; mënyra si duhet organizuar tribunat dhe debatet publike nga ana e Kuvendit Komunal; mënyra e anketimit dhe marrja e propozimeve nga qytetarët; mënyra si duhet përmbushur obligimet për mbrojtjen e banorëve dhe e të mirave materiale në gjendje lufte; mbikëqyrja dhe kontrolli i ligjshmërisë së dispozitave të miratuara nga Kuvendi Komunal para publikimit të tyre etj.

1.4.1. Vendimi Statutar është akti themelor i Komunës së Tuzit dhe ka të bëj me përcaktimin e detyrave, kompetencave, përgjegjësive e të drejtat e kësaj komune që është themeluar për banorët lokal që jetojnë në territorin e kësaj Komune Urbane në kuadër të kryeqytetit të Malit të Zi, përkatësisht, Podgoricës.

1.4.2. Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit

Në Kosovë, Statuti mund të ndryshohet a plotësohet me së paku votimin e dy të tretave të anëtarëve të Kuvendit Komunal. Në Kosovën Lindore, iniciativën për ndryshim a plotësim të statutit të Komunës mund ta marrin së paku 10% e votuesve ose një e treta e këshilltarëve të Kuvendit Komunal. Ndërsa për të ndryshuar a plotësuar Statuti, duhet votuar shumica e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve Komunal. Në Maqedoni, ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të ndonjë Komune mund

t'i iniciojnë gjysma e anëtarëve të Këshillit të Komunës, Kryetari i Komunës ose së paku 10% e zgjedhësve në Komunë. Ndërsa vendimin për fillimin e ndryshimeve të statutit e merr Këshilli i Komunës me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit. Për t'u ndryshuar a plotësuar duhet votuar gjysma e këshilltarëve të Komunës. Në Mal të Zi, ndryshimet e statutit të Komunës miratohen nëse për ato ndryshime votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Komunës. Komuna e Ulqinit ka në diskutim projekt-statutin e ri i cili ende nuk e ka marrë formën e duhur. Ajo punon sipas statutit të vjetër. Miratimi i projekt-statutit të Komunës së Ulqinit ka hasur në kundërshtime, për shkak të disa pakënaqësive që kanë shfaqur partitë opozitare shqiptare që bëjnë pjesë në Kuvendin e Komunës së Ulqinit.

1.4.3. Aktet tjera të Komunës

Statuti është akti themelor me anë të cilit Komuna, rregullon mënyrën, kushtet dhe format e realizimit të veprimtarive të veta. Por, pos Statutit janë edhe aktet tjera të përgjithshme si rregulloret, vendimet, udhëzimet administrative etj, që shërbejnë dhe ndihmojnë Komunën në rregullimin e veprimtarive që bien në kompetencat e veta.

1.5. Simbolet e Komunës

Komunat, në të gjitha këto shtete, mund të kenë stemën, flamurin si dhe festën e tyre. Këto simbole rregullohen me statut të Komunës por ato duhet të jenë të veçanta. Kjo do të thotë që nuk duhet të jenë të ngjashme me simbolet e Komunave të tjera si dhe të shteteve të tjera e të Komunave të shteteve të tjera dhe Organizatave të tjera si shtetërore ashtu edhe ndërkombëtare e joqeveritare. Përdorimi i tyre rregullohet me aktin më të lartë juridik të Komunës, që është statuti i Kuvendit Komunal. Zakonisht, simbolet kanë përmbajtje historike, kulturore të asaj rrethine. Mënyra dhe procedura e përcaktimit të simboleve, në të gjitha këto shtete, është rregulluar me statut të Komunës. Stema, flamuri dhe festa e çdo

Komune në Maqedoni janë përcaktuar dhe përcaktohen me vendim të Këshillit të Komunës.

Komunat formojnë komisione dhe hapin konkurs për përcaktimin e stemës dhe të flamurit të tyre. Komisioni i formuar përcaktohet për njërën nga punët e arritura në atë konkurs dhe atë, punimin e zgjedhur, ia dërgon Këshillit të Komunës, për miratim. "...*Përcaktimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të Komunës, miratohen me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit të cilët i përkasin bashkësisë që nuk është shumicë e popullatës në atë komunë*"[21]. Vendimi i Këshillit për përcaktimin e stemës, përkatësisht të flamurit të Komunës është pjesë përbërëse e statutit të Komunës. Stema e Komunës në këtë Republikë është e shtypur në vulën e Komunës. Stema e Komunës mund të shtypet në thirrje zyrtare, dekorata dhe në akte tjera që i shfrytëzon Këshilli dhe Kryetari i Komunës. Nëse vlerësohet se është në interes të Komunës, Këshilli i Komunës ka të drejtën t'u lejojë personave fizik dhe atyre juridik përdorimin e stemës së Komunës. Me statut të Komunës në Maqedoni, është paraparë edhe vendosja e flamurit. "*Flamuri i Komunës vihet në ndërtesën e Komunës dhe në vende të dukshme në Komunë*"[22]. Me po të njëjtin statut, stema dhe flamuri ndalohen të përdoren nëse janë dëmtuar ose pamja e tyre është e papërshtatshme për përdorim. Simbolin, (flamurin) Komuna, mund ta përdor edhe jashtë ndërtesës së Komunës nëse merr pjesë ose prezantohet në gara, takime e tubime të tjera ndërkombëtare.

1.6. Interesi i përgjithshëm në realizimin e Qeverisjes Vendore

Kur flitet për çështjet e interesit publik, ato janë të rëndësisë lokale dhe bëhet fjalë për interesin e tërë bashkësisë lokale ose i disa pjesëve të saj. Në kuadër të realizimit të interesit të përbashkët bëjnë pjesë: zhvillimi ekonomik dhe industrial i Komunës; infrastruktura Komunale; pjesëmarrja e

---

[21] Zakon za Lokalnata Samouprava ("Sl. Vesnik na Republika Makedonija" br. 5 od 29 januari 2002 god) dok. i cituar, neni: 41, alineja 3

[22] Statuti i Komunës së Tetovës, ("gazeta Zyrtare R. M. Nr. 55/04), neni 154, alineja 1

drejtpërdrejtë e qytetarëve në vendimmarrje; organizimi dhe puna në organet Komunale; administrata Komunale; aktet e organeve; pasuria e Komunës; mbikëqyrja e punëve të organeve Komunale; shpërndarja e Këshillit të Komunës; mekanizmat bashkëpunuese në mes të Komunave dhe Qeverisë; Qeverisjes Vendore e Vetëqeverisjes Vendore (bashkësitë lokale e urbane); përcaktimi i gjuhëve zyrtare nëpër komuna dhe çështjet tjera të rëndësisë së Qeverisjes Vendore.

1.6.1. Veprimtaritë Komunale

Veprimtaritë për të cilat është kompetente, Komuna i kryen nëpërmjet organeve të veta, organeve të Qeverisjes Vendore dhe shërbyesve publik. Qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë marrin pjesë në përcaktimin e nevojave dhe interesave të veta nëpërmjet zgjedhjes së lirë të përfaqësuesve të organeve të Qeverisjes Vendore.

Në të gjitha këto shtete është paraparë që Komunat të kujdesen për pronën e tyre, të drejtat e minoriteteve si dhe ndërmarrjen e iniciativave dhe dhënien e mendimit për ato çështje që kanë të bëjnë me Komunat e që nuk janë në kompetenca të tyre. Me të drejtë, me rastin e ndërmarrjes së ndonjë iniciative, Komunat, kanë të drejtën e përgjigjes nga Pushteti Qendror, për çështjet në fjalë. Po ashtu Komunat janë të lira të veprojnë në kuadër të kompetencave që u takojnë. Atyre nuk mund t'u kufizohen veprimtaritë që u takojnë gjatë realizimit të Qeverisjes Vendore. Këtë e konstatoj duke marrë për bazë, dokumentet ligjore të të katër vendeve që janë objekte studimi. Në veçanti do të parafrazoj Ligjin që rregullon Qeverisjen Vendore në Mal të Zi ku thuhet që: "*Në kryerjen e veprimtarive të vetadministrimit lokal, Komuna është e pavarur dhe të drejtat e saja nuk mund të kufizohen me aktet e organeve shtetërore, përveç se në kushte të caktuara me ligj, në përputhshmëri me Kushtetutën*"[23].

Komuna ka pasurinë dhe të ardhurat e veta. Me pasurinë dhe të ardhurat e veta, Komuna mund të veprojë në mënyrë të

[23] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Crne Gore, neni 8

pavarur. Ky Organ Qeverisës ka për obligim të sigurojë kushtet e jetesës të gjithë banorëve të vet. Në këtë kontekst, ato kanë për obligim të mbrojnë dhe të synojnë edhe avancimin e të drejtave të minoriteteve. *"Komuna siguron kushtet për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të minoriteteve në përputhje me Kushtetutën, akteve ndërkombëtare juridike si dhe ligjit të veçantë".*[24] Në këtë mënyrë, Komunave u mundësohet e drejta për dhënien e mendimit dhe avancimit e të drejtave të minoriteteve por pa e kaluar përputhshmërinë me Kushtetutën e atij vendi.

Sa i përket kësaj problematike, në Kosovë është punuar mjaft. Kështu është duke u punuar edhe në Maqedoni e Mal të Zi. I vetmi vend ku do të duhej edhe më të punohet për këto të drejta, është Serbia.

Nëpërmjet Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale të Kosovës, Kosovës Lindore, Maqedonisë e Malit të Zi, Komunave u jepet edhe e drejta në dhënien e mendimit për ndonjë çështje që nuk bie në kompetencat e saj, por që është në interes të banorëve lokal, ose ka të bëjë me Qeverisjen Vendore. Kjo konstatohet duke marrë për bazë nenin ligjor ku thuhet: *"Komuna ka të drejtën që të shfaq mendim ose të ndërmarrë iniciativën për problemet të cilat nuk janë në kompetenca të saj por që janë në interes të vetadministrimit lokal".*[25]

Me këtë nuk mund të konkludohet që Pushteti Qendror, doemos duhet të veprojë sipas kërkesave të Komunave. Por, mbetet si mundësi. Edhe pse, për shumë çështje, Pushteti Qendror në të gjitha këto shtete (hiq ndonjë rast në Komunat e banuara me minoritetin serb në Kosovë, ku vërehet një diskriminim pozitiv) nuk do të diskutojë.

---

[24] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Crne Gore: neni 10

[25] Zakon o Lokalnoj Samouravi Crne Gore, dokument. i cituar: neni 11

1.6.2. Shërbimet Publike të Ndërmarrjeve Komunale

Ndërmarrjet Komunale janë ato organizata të themeluara nga Komunat që kryejnë shërbime publike në Komunë. Ato i kryejnë të gjitha shërbimet për të cilat janë të regjistruara ose të specializuara e që hyjnë në kompetenca dhe përgjegjësi të tyre. Këto ndërmarrje janë të detyruara t'i dorëzojnë Kuvendit të Komunës buxhetin e tyre për miratim. Është një afat kohor që i detyron ato për të bërë këtë punë (të dorëzojnë projektet e tyre për të hyrë në buxhetin vjetor), në mënyrë që të fitojnë të drejtën e pjesëmarrjes apo të ndarjes së mjeteve të duhura për veprimtaritë e veta që u përkasin shërbimeve publike. Ato ndërmarrje që kryejnë shërbimet publike në një e më tepër Komuna, Komunat merren vesh për mbikëqyrjen e përbashkët të veprimtarisë së asaj ndërmarrjeje.

1.7. Buxheti dhe financimi i Komunës

Gjatë përpilimit të Buxhetit të Komunës, në Kosovë, kihet parasysh që të sheshohet mirë, të planifikohet e të përgatitet në mënyrë të hapur dhe të bazohet në kritere objektive. Buxheti në vete përmban planin për aktivitete dhe udhëheqje ekonomike brenda një viti fiskal dhe përfshin të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimeve kapitale dhe të përditshme të Komunës. Brenda buxhetit, parashihet edhe ndarja e fondeve ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të Komunës.

Në Maqedoni, Komuna ka buxhetin e vet. Ky buxhet sigurohet nga të hyrat vetanake, siç janë: taksat Komunale, donacionet nga Buxheti i RM dhe nga buxhetet e fondeve si dhe nga burime të tjera të siguruara nga vetëkontributi, dhënia në shfrytëzim e pasurisë së Komunës etj. Buxheti i Komunës përmban bilancin e të hyrave dhe të shpenzimeve të buxhetit që i takon vitit fiskal prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, i cili fillon prej 1 janarit dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

Propozimin e Buxhetit të Komunës e përcakton Kryetari i Komunës dhe ia dërgon Këshillit të Komunës për miratim, jo më vonë se në gjysmën e muajit nëntor.

Këshilli i Komunës nuk mund ta shqyrtojë propozimin e buxhetit të Komunës para kalimit të 20 (njëzet) ditëve prej ditës kur u është dërguar anëtarëve të Këshillit të Komunës. Këshilli i Komunës merr vendim për çdo ndryshim të buxhetit të Komunës, për shpenzime të miratuara në mënyrë plotësuese të përcjella me masa që do t'i rrisin të hyrat e propozuara ose do t'i zvogëlojnë shpenzimet e tjera në shumë të përpjesëtueshme. Për të mbuluar kërkesat e paparapara të shpenzimeve që do të paraqiten gjatë vitit buxhetor, nga shpenzimet e përgjithshme rrjedhëse dhe kapitale ndahet një rezervë buxhetore. Se kur mund të shfrytëzohen këto mjete rezervë dhe si, është kompetencë e Kryetarit të Komunës. Autorizimi bëhet me vendim, nga Këshilli i Komunës.

Nëse buxheti nuk aprovohet deri në afat të caktuar, atëherë do të aplikohet financimi i përkohshëm deri në gjashtë muaj. Llogaria vjetore e buxhetit të Komunës, përpilohet në fund të çdo viti fiskal. Këtë duhet ta miratojë Këshilli i Kuvendit deri më 31 mars të vitit vijues, ndërsa zbatimin e buxhetit e bënë Kryetari i Komunës, me vendim të Këshillit të Komunës.

1.7.1. Të ardhurat e Komunës

Të ardhurat, Komuna i realizon nëpërmjet taksave komunale, vetëkontributit, nga të ardhurat e dhënies në shfrytëzim të tokës ndërtimore dhe asaj punuese që është pronë e Komunës si dhe nga të ardhurat tjera. Komuna, pos që financohet nga të hyrat e veta siç janë: taksat lokale, dëmshpërblimet, donacionet, nga tregu i brendshëm dhe i jashtëm, ajo financohet edhe nga Pushteti Qendror. Një gjë e tillë bëhet kur të hyrat nga këto veprimtari nuk mund t'i mbulojë shpenzimet e Komunës si dhe në rastet e punëve të deleguara nga Pushteti Qendror.

1.7.2. Të hyrat e Komunës.- Të hyrat e Komunave zakonisht vijnë nga licencat dhe pagesat e caktuara dhe të vendosura nga Komuna. Të hyrat nga të ardhurat dhe pasuria e Komunës dhe nga gjobat apo përqindja e gjobave që po ashtu i cakton Komuna.

1.7.3. Pasuria e Komunës

Pasurinë e Komunës në Kosovë, e përbëjnë toka ndërtimore, ajo punuese si dhe objektet afariste dhe të banimit që janë në territorin e asaj komune. Toka ose objektet e Komunës, mund të jepen në shfrytëzim dhe të shiten, por, në rast se ato do të jepeshin në shfrytëzim për një kohë më shumë se dhjetë vjet ose do të shiteshin, atëherë kërkohet edhe miratimi i Pushtetit Qendror.

Në Komunat e Kosovës Lindore nuk ka ndonjë dallim. Edhe aty pasurinë e përbëjnë patundshmëria, gjërat e luajtshme, gjërat monetare, letrat me vlerë si dhe të drejtat tjera pasurore në përputhje me ligjin. Komuna manipulon me pasurinë e vet, duke pasur parasysh mostejkalimin e kompetencave dhe duke praktikuar menaxhim të mirë ekonomik e financiar. Komuna dhe shërbimet publike ku themelues është Komuna duhet të mbajnë evidencë për pasurinë e tyre.

Pronën e Komunës në Maqedoni e përbëjnë sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet në para dhe objektet e ndryshme afariste që janë pronë e saj. Komuna ka të drejtën e pasurisë vetanake të gjërave, mjeteve monetare dhe objekteve tjera që janë pronë e saj. Pronën, Komuna e fiton nga burimet e të hyrave të veta, duke financuar qytetarët ose duke marrë pjesë në ndonjë formë tjetër, nëpërmjet dhuratave dhe mënyrave tjera.

Për blerjen, tjetërsimin dhe ngarkesën e pronës së Komunës vendos Këshilli i Komunës. Sendet që janë pronë e Komunës mund t'u jepen në shfrytëzim subjekteve juridike ose atyre fizik, me anë të ankandit publik. Ajo, po ashtu mund të tjetërsohet, por, vetëm me ankand publik. Komuna mban evidencë për pronën që disponon dhe vlerësimin e saj e paraqet në llogari vjetore. Çmimi shitës i gjërave nuk guxon të jetë më i vogël se vlera e tyre e tregut. Mjetet e fituara nga shitja e sendeve mund të përdoren vetëm për blerjen e sendeve të reja ose rikonstruimin e sendeve ekzistuese që janë pronë të Komunës.

1.8. Mbikëqyrja e ligjshmërisë e akteve të Komunës

Në të gjitha Komunat e këtyre katër shteteve, mbikëqyret ligjshmëria e akteve të nxjerra. Të gjitha aktet e nxjerra duhet të jenë në përputhje me Ligjin që përcakton Qeverisjen Vendore dhe në përputhje me Kushtetutën shtetit. Papërshtatshmëria dhe pa përputhshmëria e ndonjë dispozite me Kushtetutën dhe Ligjin, duhet të alarmohet me kohë nga Kryetari i Komunës, përndryshe, po s'u bë në kohë të caktuar, atëherë ai akt nuk mund të ndalohet. Akti mund të shpallet i pavlefshëm, vetëm nëse me kohë Kryetari ndërmerr masat e duhura duke njoftuar ministrinë përkatëse si dhe duke paraqitur atë akt kontestues në Gjykatën Kushtetuese të vendit.

1.8.1. Organet e mbikëqyrjes në Komuna

Në Kosovë, pos Kryetarit të Komunës, ligjshmërinë e çdo akti të nxjerrë nga Komuna, më parë e mbikëqyrte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në bazë të autorizimeve që kishte marrë nga Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara. Por, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, kjo e drejtë iu hoq PSSP të OKB-së, dhe tani e tutje këtë të drejtë e ka kryetari i Komunës dhe ministria gjegjëse.

Në Maqedoni këtë mbikëqyrje e kryen ministria përkatëse e cila është kompetente për punët e Qeverisjes Vendore. Sa i përket mbikëqyrjes së punëve të Organeve Komunale, këtë e bëjnë organet e Pushtetit Qendror. Kontrollin e veprimtarisë financiare dhe materiale e kryen ministria e financave. Revizionin material dhe financiar e kryen Instituti Shtetëror i Revizionit. Ndërkaq punët e deleguara i mbikëqyr organi që i ka deleguar ato veprimtari në organet komunale. Instituti Shtetëror i Revizionit kryen revizione të rregullta të llogarive financiare të Komunës. Ky institut kërkon nga Kryetari i Komunës për të paraqitur raportin për ekzekutimin e buxhetit dhe llogarisë vjetore, në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të buxhetit, përkatësisht llogarisë vjetore. Raporti duhet të jetë i kompletuar.

1.8.2. Format dhe mënyra e mbikëqyrjes së punës së Komunave

Kjo kompetencë ka të bëjë me ligjshmërinë, kontrollin dhe revizionin ndaj punës financiare dhe materiale, mbikëqyrjen e punëve të deleguara të Organeve Komunale nga ato shtetërore, për efikasitetin e tyre si dhe mbikëqyrjen paraprake të dispozitave të Komunës. Organet komunale janë të obliguara që të bashkëpunojnë me organet mbikëqyrëse të Komunës.

1.9. Mbrojtja e Komunës

Kur Komuna, në Maqedoni, pengohet të ushtrojë kompetencat e veta, nga aktet dhe aktivitetet e organeve të Pushtetit Qendror, ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore në gjykatat kompetente. Mbrojtja gjyqësore dhe siguria u garantohen para gjyqeve kompetente, në përputhje me aktet dhe aktivitetet e organeve të administratës shtetërore dhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Nismën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe të kushtetetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të ministrive dhe të organeve të tjera të Pushtetit Qendror me të cilat shkelet pozita kushtetuese dhe të drejtat e Komunës, mund të paraqesin Organet Komunale në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë. Në këtë mënyrë Komuna shfrytëzon të drejtën e mbrojtjes së pozitës Kushtetuese. Këtë të drejtë e kanë edhe Komunat në Kosovën Lindore si dhe në Malin e Zi. *"Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës kanë të drejtë që pranë Gjykatës kompetente të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave në rast se me akte të veçanta ose lëndët e organeve shtetërore është bërë shkelja e të drejtave të Komunës ose pengimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në realizimin e të drejtave në vetadministrimin lokal"*[26].

[26] Statuti i Komunës së Preshevës, ("Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë" Nr. 9/ 02),dok. i cituar, neni 96

1.9.1. Mbrojtja e Komunës në gjendje Lufte

Në gjendje lufte, organet e Komunës në Maqedoni, vazhdojnë t'i zbatojnë punët e veta dhe marrin masa për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale në territorin e tyre. Kjo mbrojtje bëhet nga shkatërrimet luftarake, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi tjera si dhe nga pasojat e shkaktuara nga këto veprime.

Komuna përgatitet për planifikimin dhe organizimin e masave për mbrojtje dhe shpëtim; formimin e njësive dhe shtabeve për mbrojtje civile; stërvitjen për mbrojtjen, respektivisht përfshirjen në aktivitete për aftësim të domosdoshëm ushtarako-profesioniste dhe njohuri të tjera për pjesëmarrje në mbrojtje; marrjen e masave, aktiviteteve dhe procedurave për mbrojtjen dhe ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave, informatave dhe dokumenteve nga sfera e mbrojtjes. Këto veprime Komuna mund t'i kryej në koordinim dhe bashkëpunim me Komunat tjera.

1.10. Bartja e pushtetit nëpër Komuna

Menjëherë pas zgjedhjeve të para të vitit 2000, Komunat në Kosovë, administroheshin në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/14 mbi emërimin e administratorëve rajonal dhe Komunal të datës 21 tetor 1999 dhe me nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/1 mbi Këshillin e Përbashkët të Përkohshëm Administrativ të Kosovës të datës 14 janar 2000. Me anë të Rregullore 2007/30 të UNMIK-ut, administratorët komunal zakonisht merreshin më tepër me të drejtat e minoriteteve. Kjo do të thotë që ata mbikëqyrnin punën e organeve të Komunës e sidomos aktet e nxjerra nga Komunat që kishin të bënin me të drejtat dhe liritë e minoriteteve. Ndërkaq, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës dhe me konfigurimin e UNMIK-ut, nuk është qartësuar ende në do të ketë më administratorë rajonal. Bazuar në Ligjin që rregullon Qeverisjen Vendore në Kosovë, mund të konstatohet që kompetencat bien në nivelin vendor

dhe s'përmend administratorë rajonal të emëruar nga EULEX, organizëm ky, ndërkombëtar që zëvendëson UNMIK-un.

1.10.1. Kompetencat e Komunës

Çdo Komunë në Kosovë, brenda territorit të vet dhe brenda ligjeve ekzistuese, që dolën nga Rregullorja 2007/30, rregullonte veprimtaritë dhe kishte kompetenca për disa nga aktivitetet vepruese. Po ato kompetenca, si duket vetëm janë përshkruar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kështu ato, ofrojnë kushte themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; planifikojnë zhvillimin e hapësirës urbane dhe rurale si dhe shfrytëzimin e tokës; japin leje për ndërtim dhe janë përgjegjëse për kryerjen e tyre; Kujdesen që të mbrojnë ambientin në territorin e tyre; qytetarëve u kryejnë shërbime publike, përfshirë atë të zjarrfikësve dhe të emergjencës; Merren me përpunimin e ujërave të zeza, me mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Kujdesen për transportin lokal dhe bëjnë plane për ngrohtoret lokale; Udhëheqin dhe menaxhojnë pronën e Komunës; Merren me mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shëndetit publik; "*Jep leje për shërbime dhe pajisje nga lëmi i argëtimit, ushqimit, tregjeve dhe shitjes në rrugë, transport publik-lokal, taksi, gjueti, peshkim, restaurante dhe shërbime hoteliere*"[27]. Kanë kompetenca që të organizojnë panaire dhe të mirëmbajnë tregjet. Në dispozicion kanë të drejtën e emërimit dhe riemërimit të rrugicave, rrugëve, shesheve dhe vendeve të tjera publike në territorin e Komunës. Përveç këtyre aktiviteteve, Komunat mund të ndërmarrin veprime në territorin e tyre edhe rreth çështjeve të tjera Komunale. Këtu mund të përfshihen edhe këto veprimtari si: Turizmi; Aktivitetet kulturore; Sportet dhe aktivitetet e lira; Aktivitetet e rinisë; Avancimi i ekonomisë; dhe Avancimi i vlerave qytetare.

Kompetencat e Komunës në Maqedoni janë përmbledhje e veprimtarisë dhe e punëve që janë të interesit të përbashkët dhe

[27] Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, Nr. Prt. 01/06-8/2 dt. 28. 02.02002, Mitrovicë, STATUT Nr. 05/2002 (Me ndryshimet dhe plotësimet në bazë të vendimeve të Kuvendit të Komunës, vendimit Nr. 01/112-25 të dt. 29. 07. 2003 dhe vendimit Nr. 01/06-32 të dt. 20. 01. 2004): neni 12, paragrafi 13

të përgjithshëm publik të banorëve lokal, të cilat Komuna, ka të drejtën e kryerjes në zonën e vet. "*Komunat në përputhje me ligjin, në territorin e vet kanë të drejtë t'i kryejnë punët që janë me interes të përgjithshëm lokal e që nuk përjashtohen nga kompetencat e veta ose nuk janë kompetencë të pushtetit qendror*"[28]. Ato në përputhje me parimin e subsidiaritetit, kanë të drejtën që në territorin e tyre të realizojnë iniciativa për të gjitha çështjet që janë me rëndësi për Komunën. Por, duhet pasur kujdes që të mos tejkalojnë kompetencat e veta dhe të ndërhyjnë në kompetencat e organeve të Pushtetit Qendror.

Ato janë kompetente për kryerjen e këtyre punëve: Planifikimet urbanistike (urbane dhe rurale), dhënien e lejeve për ndërtimin e objekteve të rëndësisë lokale; rregullimin e hapësirës dhe tokës ndërtimore; ruajtjen e mjedisit jetësor; zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin e zhvillimit ekonomik, udhëheqjen e politikës ekonomike, përmbajtjen e ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të atyre të nivelit lokal; partneritetin me institucionet dhe agjencitë e ndryshme; komunalitë: si furnizimi me ujë të pijshëm, ujit teknologjik, ndriçimin publik, tretmanin e ujërave atmosferik, mbajtjen e pastërtisë publike, mbledhjen dhe transportimin e bërllokut, rregullimin dhe organizimin e transportit publik, furnizimin me gaz natyral dhe ngrohjen, mirëmbajtjen e varrezave, krematoriumit dhe ofrimin e shërbimeve të varrimit. Ndërtimin, mirëmbajtjen dhe rekonstruimin e rrugëve lokale, rrugicat dhe objektet tjera të infrastrukturës lokale, rregullimin e komunikacionit, sinjalizimin, parkimin, mirëmbajtjen dhe ngritjen e parqeve, tregjet, parqet, pyjet, lumenjtë dhe rregullimin e shtretërve të tyre, emërtimin e rrugëve, shesheve, urave si dhe kryerjen e shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm..

Kompetencë e Komunave është edhe kultura institucionale. Kështu, Komunat financojnë dhe përmbajnë aktivitetet dhe projektet kulturore; organizojnë manifestime kulturore; ruajnë dhe përmbajnë: folklorin, zakonet, adetet, zejet dhe vlerat tjera kulturore dhe mirëmbajnë objektet që kanë të bëjnë me kulturën.

---

[28] Zakon za Lokalnata Samouprava ("Sl. Vesnik na Republika Makedonija, br. 5 od 29 januari 2002 god.), dok. i cituar: neni 20

Përpiqen të avancojnë dhe të zhvillojnë sportin. Angazhohen për mbajtjen e aktiviteteve sportive, mirëmbajnë dhe ndërtojnë objekte sportive dhe përmbajnë lidhjet e sportit.

Komuna nëpërmjet organeve të veta, në Kosovën Lindore ka kompetenca të nxjerr programe të zhvillimit. Të nxjerr planet urbanistike. Të nxjerr buxhetin dhe llogarinë përfundimtare vjetore. Nxjerr programe për rregullimin e tokës ndërtimore, rregullon dhe siguron kryerjen e punëve të rregullimit dhe shfrytëzimit të tokës ndërtimore dhe cakton lartësinë e kompensimit për rregullimin dhe shfrytëzimin e tokës ndërtimore. Nxjerr programe të shfrytëzimit dhe mbrojtjes së vlerave natyrore dhe programe për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në të vërtetë nxjerr planet mbrojtëse lokale në përputhje me dokumentet strategjike dhe interesave të veta specifike që kanë të bëjnë më interesin e përgjithshëm të banorëve lokal. Themelon rezervat materiale, shumën dhe strukturën i përcakton me pëlqimin e ministrisë përkatëse. Themelon institucione dhe organizata arsimore, kulturore, të mjekësisë primare, kulturës fizike, sportit, sigurimin social, mbrojtjen e fëmijëve, turizmit. Organizon kryerjen e punëve që kanë të bëjnë me të mirat kulturore të rëndësisë së Komunës. Bënë organizimin e shërbimeve për nevojat e Komunës dhe rregullon organizimin dhe punën e tyre. Emërton dhe riemërton rrugët, rrugicat e sheshet e Komunës si dhe kryen edhe punë tjera që kanë të bëjnë për të mirën e banorëve lokal.

Në bashkëpunim me Pushtetin Qendror, themelojnë, financojnë dhe administrojnë shkollat fillore dhe të mesme. Sigurojnë ushqimin e fëmijëve dhe vendosjen në konvikte. (Sa i përket konvikteve, në këto dy Komuna të Kosovës Lindore, ka kohë që nuk funksionojnë. Por është paraparë me ligj që nxënësit e ardhur nga Komunat e tjera të vendosen në to ose ata nxënës që nuk e kanë të siguruar transportin dhe vijnë nga anët më të largëta të Komunës). Drejtojnë rrjetin e organizatave publike shëndetësore të mjekësisë primare që hyjnë nën kompetencat e Qeverisjes Vendore. Kompetencë e Komunave është edhe mbrojtja nga puna (në punë), zhvillimi i shëndetit, mbikëqyrja shëndetësore, mjedisi jetësor, mbikëqyrja e sëmundjeve ngjitëse, ndihmon pacientët me nevoja të veçanta

(atyre të keqpërdorur dhe të atyre me sëmundje mentale). Përgatit dhe ndërmerr masat e duhura për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Mbikëqyr punët që kanë të bëjnë me kompetencat e veta si dhe zhvillon dhe planifikon infrastrukturën urbanistike. Komunat në mënyrë të pavarur i rregullojnë dhe i kryejnë punët që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm e që janë të rëndësisë lokale. Këto Kompetenca që Komunave u jepen, nuk mund t'u kufizohen e as t'u merren nga organet e pushtetit qendror.

Komunat në Mal të Zi, kryejnë punët e Qeverisjes Vendore që janë të interesit të përgjithshëm për banorët lokal. Ato kryejnë edhe veprimtari që i ngarkohen nga Qeveria. Veprimtaritë e veta që i takojnë Komunave, caktohen me ligj dhe me statut. Për kryerjen e këtyre punëve, Komunave u duhet të sigurojnë kushtet e duhura. Ato i kryejnë edhe veprimtaritë tjera që janë me interes të përbashkët për banorët lokale që nuk bien në kompetencat e organeve shtetërore si dhe organeve tjera.

Komuna në Mal të Zi, nxjerr plan-programet zhvillimore, programin për rregullimin e tokës ndërtimore, planet hapësinore dhe urbanistike, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare vjetore, planin për përmirësimin e politikës financiare, planet dhe programet në disa drejtori, (kjo bëhet me akte të veçanta) programin për zhvillimin dhe ruajtjen e hapësirës jetësore. Në kuadër të kompetencave të veta Komunat kryejnë edhe veprimtaritë vijuese si kujdesi për mbrojtjen dhe sigurinë e territorit nga erozioni; përcaktimi i interesit publik për eksproprijimin e patundshmërive për nevoja lokale. Udhëheq, disponon dhe mbron pronën lokale. Kryen dhe mbikëqyr punën e inspektimit. Rregullon kundërvajtjet për shkeljen e rregulloreve të veta si dhe udhëheq procedurat e kundërvajtjes. Themelon shpërblime dhe mirënjohje publike dhe kryen veprimtari tjera në kuadër të kompetencave që u jepen Komunave.

1.10.2. Punët e besuara Komunës

Komunave në Kosovë, mund t'u besohen edhe kompetenca plotësuese brenda suazave të autoritetit të Pushtetit Qendror, me kusht që t'u sigurohen burimet financiare për shpenzimet e kryerjes së këtyre punëve.

Në Kosovën Lindore, mund t'u besohet kryerja e disa punëve që janë nën kompetenca të pushtetit qendror si dhe disa nga ato që u përkasin kompetencave të formës së Autonomisë Territoriale. Këto punë mund t'u besohen të gjitha Komunave ose një pjese të tyre, ku mendohet që kryerja do të jetë më efikase dhe më efektive si dhe realizimi i të drejtave të qytetarëve të atij lokaliteti do të jetë më racional dhe plotësimi i këtyre nevojave është më se i domosdoshëm. Mjetet sigurohen nga varësia e punëve.

Kështu, mund t'u besohen kryerja e punëve të inspektimit të qarkullimit të mallit dhe shërbimeve, bujqësisë, ujit, pyjeve dhe inspektimet tjera që janë nën kompetenca të pushtetit qendror.

Në Mal të Zi, Komuna, pos kompetencave që i takojnë, kryen edhe punë tjera, të cilat i besohen nga organet e Pushtetit Qendror. Mirëpo, për këto punë të besuara Pushteti Qendror i siguron dhe përcakton edhe burimet e financimit për zbatimin e tyre. Me rregullore të qeverisë së Malit të Zi, Komunës mund t'u besohen disa veprimtari nga kompetencat e pushtetit qendror.

1.10.3. Kompetencat e deleguara

Delegimi i ekzekutimit (i kryerjes së punëve të caktuara) është bartja e punëve një organi nga kompetencat e organit tjetër, duke pasur parasysh që ato punë kryhen në emër dhe sipas udhëzimeve dhe përgjegjësisë të organit që transferon ekzekutimin. Këto kompetenca mund të merren nga i njëjti organ që delegon ato. Në Kosovë, kompetencat e tilla, kanë të bëjnë me licencimin e bizneseve, mbrojtjen e pyjeve, regjistrin e votuesve, atij të popullsisë etj. Disa nga këto kompetenca, nga

Pushteti Qendror, mund t'u delegohen edhe Komunave të Kosovës Lindore, përkatësisht Preshevës e Bujanocit. Në Maqedoni, Pushteti Qendror, delegon disa punë që janë nën kompetencat e veta për t'i kryer apo ekzekutuar Komuna. Kontrollin e kryerjes së kompetencës së deleguar e bënë organi i cili e ka deleguar kompetencën në mënyrë subsidiare. Punët dhe veprimtaritë që u delegohen Komunave, rregullohen me akte të Këshillit të Komunës në pajtim me procedurat dhe standardet e përcaktuara, duke pasur parasysh përshtatjen e kushteve të Qeverisjes Vendore.

Në Mal të Zi, veprimtaritë që janë në kompetencë të pushtetit qendror, mund të kalohen në pushtetin vendor, kur mendohet që ato do të kenë një kosto më të lirë dhe do të mund të kryheshin me një efikasitet më të madh.

Veprimtaritë e deleguara në sferën e arsimit, shëndetësisë parësore, sigurimit social dhe të fëmijëve, punësimit dhe sferat tjera në interes të banorëve lokal, Komuna i kryen në përputhje me kompetencat që i delegohen.

1.10.4. Përgjegjësitë e Komunës

Përgjegjësi e Komunave në Kosovë, është të zbatojnë rregullat e ndërtimit duke kontrolluar standardet e ndërtimit. Të kujdesen për infrastrukturën duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin. Të kujdesen për shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm; në përgjegjësi të tyre është edhe kujdesi parësor shëndetësor; shërbimet sociale dhe strehimi; ofrimi dhe sigurimi i shërbimeve publike për banorët e Komunës së tyre dhe të atyre qytetarëve që u kërkojnë shërbime. Gjithashtu janë përgjegjëse edhe për zbatimin e rregulloreve të Pushtetit Qendror duke përfshirë të dhënat kadastrale, regjistrat e popullsisë, regjistrimin e votuesve dhe regjistrimin e bizneseve.

Në Kosovën Lindore, përgjegjësi e Komunave është të rregullojnë e të kryejnë punët që kanë të bëjnë me Komunalitë. (furnizimin me ujë të pijshëm, ngrohtoren, prodhimin e gazit dhe furnizimi me të, komunikacionin urban dhe ndërurban, mbajtjen e pastërtisë, bartjen e udhëtarëve, mirëmbajtjen e

rrugëve, deponive, parqeve, varrezave, parkimit, varrimin, ndriçimin publik si dhe organizimin e kushteve materiale për kryerjen e këtyre punëve. *"Kujdeset për mirëmbajtjen e ndërtesave banesore dhe sigurisë, shfrytëzimit dhe vërtetimin e lartësisë së kompensimit për mirëmbajtjen e ndërtesave banesore"*[29].

Përkujdeset që të lirohen banesat e uzurpuara ose të largohen ata që me forcë kanë hy në pronën e huaj. Rregullon dhe siguron shfrytëzimin e hapësirës punuese me të cilën disponon. Cakton lartësinë e kompensimit për shfrytëzim të kësaj hapësire dhe mbikëqyr shfrytëzimin e hapësirës. Kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Cakton shumën e duhur të kompensimit për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor. Rregullon dhe siguron kryerjen e veprimtarive që kanë të bëjnë me ndërtimin, rehabilitimin, dhe rekonstruimin, mirëmbajtjen, mbrojtjen, shfrytëzimin, zhvillimin dhe administrimin e rrugëve të pa kategorizuara lokale dhe rrugëve në vendbanime. Rregullon dhe siguron kushtet dhe organizimin e auto-taksive për transportimin e udhëtarëve; Nxit zhvillimin kulturor-artistik të amatorizmit dhe krijon kushte për veprimtarinë e Muzeut dhe Bibliotekës si dhe të Organizatave që i ka themeluar vetë; Organizon mbrojtjen nga katastrofat eventuale nga zjarri duke evituar dëmet e mëdha ose duke parandaluar të mos vijë deri te ndonjë aksident, ose së paku për të zbutur pasojat. Siguron dhe rregullon shfrytëzimin e tokës bujqësore. Cakton zonat erozive. Kujdeset për shfrytëzimin e livadheve si dhe vendos për prishjen e tyre duke mbjellë diçka tjetër.

Rregullon dhe përcakton mënyrën e shfrytëzimit dhe të përdorimit të burimeve, çezmave e puseve publike. Jep pëlqimin për përdorimin e ujit si dhe jep leje për objekte të tyre. Kujdeset dhe krijon kushtet për ruajtjen, shfrytëzimin dhe përparimin e zonave ku ka barna me karakter natyral.

Për çështjet që kanë të bëjnë me turizmin në territorin e vet, rregullon hotelerinë, zejet dhe zhvillon tregtinë, orarin e punës si dhe vendet ku mund të kryhen veprimtaritë e caktuara. Shfrytëzon mjetet e pronës së Komunës, me pretekst

[29] Statuti i Komunës së Preshevës, ("Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë" Nr. 9/02), neni 15, alineja 5

të ruajtjes dhe rritjes së shumës. Mbron, organizon dhe rregullon ruajtjen e kafshëve shtëpiake. Organizon mbrojtjen juridike. Arsimon organet. Ndihmon kooperativat. Sipas nevojës, organizon shërbimin e ndihmës juridike qytetarëve. Kujdeset për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të minoriteteve dhe grupeve etnike. Përcakton gjuhët dhe alfabetet e pakicave, të cilat janë zyrtare në territorin e Komunës. Siguron informim publik të rëndësisë lokale. Përcakton kundërvajtjet për shkeljen e rregulloreve dhe akteve tjera të përgjithshme të Komunës. Arsimon shërbimet inspektuese dhe inspekton ekzekutimin e rregulloreve dhe akteve tjera të përgjithshme që bien në kompetencat e Komunës. Rregullon dhe organizon punën e këshillave pajtues. Rregullon dhe siguron përdorimin e emrit, stemës dhe simboleve tjera të Komunës.

Në Maqedoni Komunat janë përgjegjëse për ekzekutimin e të gjitha kompetencave dhe vendimeve të nxjerra nga organet e veta. Për të rregulluar dhe kryer punët që bien në kompetencat e Komunës, konsultohet statuti i Komunës si dhe dispozitat tjera. Është përgjegjëse për masat e ndërmarra për ruajtjen nga ndotja e ujit, ajrit, tokës, e natyrës, si dhe mbron qytetarët nga zhurma. Përgjegjësi e Komunës, është që të zgjidhin çështjet që kanë të bëjnë me dëmet e shkaktuara personit të tretë, gjatë ndërmarrjes apo lëshimeve të kryerjes së kompetencave të veta. Është në përgjegjësi të Komunës që t'u mundësojë pjesëmarrje të drejtpërdrejtë qytetarëve të vet. Nismat që ndërmerren nga qytetarët e asaj komune ose të një pjese të saj është e obliguar t'i respektojë dhe t'i heq të gjitha shpenzimet për ato iniciativa.

Përgjegjësi e Komunave në Mal të Zi është të sigurojë kushtet për kryerjen dhe zhvillimin e veprimtarive Komunale. Ofron kushtet e duhura dhe të nevojshme për të zhvilluar ndërmarrjet. Merr për sipër rregullimin, shfrytëzimin dhe ruajtjen e tokës ndërtimore; shfrytëzimin e hapësirës punuese; kushtet për ruajtjen dhe sigurinë e vlerave natyrore; sigurimin social që ka të bëjë me kujdesin dhe ndihmën shtëpiake pleqve dhe invalidëve. Merret me rregullimin e banimit për personat me nevoja sociale si dhe formave të tjera plotësuese të sigurimit social. Organizon pushime dhe rekreacione për fëmijët, duke u

përkujdesur për vendosjen, ushqimin dhe format tjera të mbrojtjes së fëmijëve. Ofron kushtet për të ruajtur, shfrytëzuar, udhëhequr dhe përparuar zonën me pasuri mjekësore bimore. Organizon komunikacionin dhe transportin e udhëtarëve lokal. Në përgjegjësi ka veprimtaritë përcaktuese, pagesat dhe kontrollin e të ardhurave publike lokale. Krijon kushtet për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e ndërtesave banesore dhe mbrojtjen e të drejtave të pronarëve të kateve; kushtet për informimin e banorëve. Përkujdeset për mbrojtjen nga fatkeqësitë dhe aksidentet e ndryshme duke krijuar kushte për eliminimin e tyre. Përgjegjësi e Komunës është të krijojë kushte që sporti dhe kultura fizike të përparojnë, duke ndërtuar dhe mirëmbajtur objektet e tyre. Angazhohet për sigurimin e lojërave të fëmijëve, të rinjve si dhe të rriturve, ndërtimin dhe vendosjen e objekteve të përkohshme. Mbron përmendoret dhe shenjat që janë të rëndësisë lokale. Krijon kushtet për zhvillimin bibliotekar dhe veprimtarive arkivore të rëndësisë lokale. Zhvillon veprimtaritë botuese. Përkujdeset për kushtet e lundrimit në territorin e vet. Përshtat kohën dhe kushtet për punë objekteve që ofrojnë shërbime qytetarëve. Auto taksive u siguron kushte për kryerjen e veprimtarisë gjegjëse. Përkujdeset pë kushtet e organizimit të panaireve të rëndësisë lokale. Organizon dhe ofron ndihmën juridike qytetarëve si dhe mban evidencën e listave zgjedhore të qytetarëve dhe evidencat tjera. Ofron kushte për ujë industrial dhe jep leje për përdorimin e tyre. Mban evidencën e ujërave të zeza, si dhe evidencën e ndotjes së objekteve të ujërave industrial.

Vendos për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve për veprimtaritë e kompetencave që i takojnë si dhe kujdeset për përmbushjen e nevojave të caktuara për qytetarët edhe në fushat tjera të interesit për qytetarët.

PJESA E DYTË

UDHËHEQJA DHE ADMINISTRATA KOMUNALE

I. Organet udhëheqëse nëpër Komuna

Komuna ka organet e veta. Ato janë Kuvendi (Këshilli Komunal në Maqedoni) dhe Kryetari i Komunës në Maqedoni e Mal të Zi, (Në Kosovë që nga zgjedhjet e para të vitit 2000, ishte paraparë vetëm Kuvendi i Komunës. Nga nëntori i vitit 2007, nga zgjedhjet e treta Vendore, doli edhe organi tjetër: Kryetari i Komunës). Tani më, kur Kosova shpalli pavarësinë dhe akti më i lartë juridik është Kushtetuta, një organ ekzekutiv i dalë nga vota e drejtpërdrejtë e popullit parashihet edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Ndërkaq në Kosovë Lindore pos këtyre dy organeve paraqitet edhe Këshilli Komunal si organ i tretë i Komunës. Organet e administratës lokale janë ato organe lokale që kryejnë pikësëpari veprimtari administrative (sekretariatet, drejtoritë, etj). Komunat kanë shërbimet publike. Ato janë Organizata ekonomike dhe Organizatat tjera që i themelon Komuna me qëllim të kryerjes së shërbimeve publike. Nëpër këto organe janë të punësuar zyrtarët dhe nëpunësit lokal.

Në Mal të Zi, për të siguruar kryerjen e veprimtarive të interesave të banorëve lokal, Komuna themelon organet e administratës lokale si dhe shërbimet publike që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të banorëve lokal e ku bëjnë pjesë: turizmi, arsimi, kultura, edukata fizike dhe sporti etj.

1. Kryetari i Komunës

Në Kosovë, nëpër Komuna, që nga Qershori i vitit 1999 deri në nëntor të vitit 2007, nuk ka pasur prefekt. Funksionin e ka kryer Kryetari i Kuvendit të Komunës. Por, duke filluar nga nëntori i vitit 2007, nga zgjedhjet e treta Vendore, doli edhe prefekti si organ i dytë i Komunës, i zgjedhur drejtpërdrejt nga

elektorati. Deri më tani që nga viti 2000, do të thotë që nga zgjedhjet e para vendore në Kosovë, Kuvendi i Komunës, nga këshilltarët e tij ka zgjedhur Kryetarin e Komunës. Ai zgjidhej me vota të fshehta, për mandat dy vjeçar sa edhe këshilltarët e tjerë të Kuvendit të Komunës. Procedura e zgjedhjes së Kryetarit ishte që për të duhej të votonin shumica e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës (dy të tretat e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve). Nëse në dy raundet e para nuk i fitonte këto vota, atëherë në raundin e tretë, zgjedhej kandidati që fitonte më shumë vota se kandidati tjetër. Kryetari i zgjedhur, kishte të drejtën për rizgjedhje edhe për një mandat tjetër. Kryetari i Komunës nuk e kishte funksionin e ekzekutivit, por të përfaqësuesit dhe të drejtuesit të mbledhjeve të Kuvendit. Nga Kuvendi i Komunës dilte edhe Kryetari i Ekzekutivit i cili e ndante pushtetin me Kryetarin e Komunës. Kryeshefi ekzekutiv i Komunës në Kosovë, kishte kompetenca të ekzekutonte të gjitha vendimet që merreshin nga Kuvendi Komunal, Kryetari i Komunës apo vendimet që vinin nga Komitetet e që miratoheshin nga Kuvendi Komunal. Çdo konflikt në mes tij dhe Kryetarit të Komunës e zgjidhte Kuvendi Komunal. Ai mund të shkarkohej vetëm nga Kuvendi Komunal në rast se nuk i kryente obligimet e tij e që kishin të bënin me interesin e përgjithshëm. Mirëpo, tani e tutje, Kryetari i Komunës, zgjedhet me votë të drejtpërdrejtë të qytetarëve, ka mandat prej katër vitesh dhe ka funksionin e ekzekutivit. Risi tjetër është që, më nuk udhëheq me seancat e Kuvendit Komunal, siç ishte paraparë me Rregulloren 2007/30, të UNMIK-ut. Nuk është më kryesues i mbledhjeve të Kuvendit, e as kryesues i Komitetit për politikë dhe financa dhe nuk kryeson mbledhjet e komiteteve tjera që i themelon Komuna. Sipas Ligjit që rregullon Qeverisjen Vendore në Republikën e Kosovës, nëpër Komuna të këtij shteti të ri, nuk do të ketë më kryetar të Këshillit Ekzekutiv, ngase ky funksion kryhet nga Kryetari i Komunës.

Në Kosovën Lindore, Prefekti është organ që përfaqëson Komunën si dhe ka funksionin e ekzekutivit. Zgjedhet në mandat prej katër vjetësh dhe mund të rizgjedhet. Detyrën e merr nga prefekti i mëparshëm dhe bën punë profesionale.

"Drejtpërdrejt kryen dhe kujdeset për kryerjen e vendimeve dhe akteve tjera të Kuvendit të Komunës"[30]. Me ndryshimet që janë bërë në Ligjin për vetadministrim lokal, këto dy komuna, nuk do ta zgjedhin më kryetarin (prefektin) në zgjedhje të drejtpërdrejta, por ky funksion do të hyjë në pazar politik, ndërmjet partive politike, pastaj votohet nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Në Maqedoni, Kryetari i sapo zgjedhur merr detyrën nga Kryetari i mëparshëm në një afat prej shtatë ditësh nga dita kur ky është zgjedhur kryetar. Funksioni i Kryetarit ia kufizon të drejtën për t'u marrë me punë tjera profesionale. Ka të drejtën e propozimit për organizimin e veprimtarisë dhe mënyrën e kryerjes së punëve të administratës komunale. Ai nuk mund të merret në përgjegjësi penale, të arrestohet ose të paraburgoset për mendimin e dhënë në Këshill. Kjo do të thotë që ka të drejtën e mendimit të lirë gjatë ushtrimit të funksionit të Kryetarit të Komunës. Pagesa dhe kompensimi për Kryetarin caktohet me statut të Komunës.

Në Mal të Zi, si edhe në shtetet tjera, *"kryetari i Komunës është organ ekzekutiv i Komunës"*.[31] Funksioni i ekzekutivit, del nga vota e lirë dhe demokratike e qytetarëve, por, për dallim nga vendet e tjera, mandati i tij zgjat pesë vjet.

1.1. Zgjedhja, të drejtat dhe detyrat e Prefektit

Në Komunat e Kosovës për të parën herë në nëntor të vitit 2007, me votë të lirë të qytetarëve u zgjodhën Kryetarët e Komunave. Sipas funksionit, (si me Rregulloren 2007/30, ashtu edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale) ai prezanton dhe ka funksionin e ekzekutuesit të akteve që miratohen nga Kuvendi i Komunës. Ai mund të zgjedh zëvendësuesit dhe këshilltarët e vet. Çdo Komunë ka edhe nënkryetarin e Komunës i cili i ndihmon Kryetarit në punët e tij. Në Komunat ku jetojnë së paku 10% e komuniteteve të tjera, emërohet një nënkryetar për Komunitete që ndihmon Kryetarin në çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë në atë Komunë dhe do të ketë një

---

[30] Statuti i Komunës së Preshevës, dokument. i cituar, neni: 52, alineja 2

[31] Zakon o Samoupravi Crne Gore, dokument i cituar, neni 41, paragrafi 3

mandat kohor sa të Kryetarit të Komunës. Mandati i parë i Kryetarit të Komunës në Kosovë zgjat dy vjet, (meqë zgjedhjet e nëntorit të vitit 2007, u mbajtën bazuar në Rregulloren 2007/30 të UNMIK-ut) ndërkaq mandatet tjera do të zgjasin katër vjet dhe do të bazohen në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës.

Funksionin ekzekutues në Komunë, në Kosovën Lindore e ka kryetari që zgjedhet nga anëtarët e Kuvendit (më parë, zgjedhej drejtpërdrejt nga populli). Në Maqedoni edhe më tutje prefekti zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ai zgjedhet për katër vjet në zgjedhjet e drejtpërdrejta me votim të fshehtë. Prefekti nuk mund të jetë njëkohësisht edhe këshilltar i Kuvendit Komunal. Ai ka zëvendësin i cili e zëvendëson në mungesë ose për shkak të ndonjë arsyeje kur do të pengohej për të kryer punët që i takojnë atij. Ka të drejtën të emërojë dhe shkarkojë zëvendësin e tij. Meqë në Komunat e Kosovës Lindore ekziston edhe organi i tretë: Këshilli Komunal, sipas funksionit, kryetari i Komunës në këto Komuna, kryeson punën e tyre. Në Mal të Zi, prefekti zgjedhet në mandat prej pesë vjetësh. Këtë funksion, një qytetar i Malit të Zi mund ta ushtrojë më së shumti në dy mandate.

Siç u pa, në Kosovë, Kosovë Lindore dhe Maqedoni, Kryetari i Komunës, zgjedhet çdo katër vjet, në Mal të Zi ka mandat pesë vjeçar. Ky është dallimi sa i përket kohëzgjatjes së mandatit, ndërsa sa i përket zgjedhjes, së tij, derisa në Kosovë, Maqedoni, e Mal të Zi, përcaktohet nga zgjedhjet e përgjithshme vendore, me votim të fshehtë, të cilat janë të drejta, të lira dhe demokratike, në Kosovë Lindore, atë e zgjedhin anëtarët e Kuvendit Komunal. Mirëpo, në të katër vendet, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive që ka, prefekti, përkatësisht Kryetari i Komunës përfaqëson dhe prezanton Komunën. Kompetencat e tij i kryen në bazë të kornizës së përcaktuar me ligj dhe me Statut të Komunës. Funksionin e tij prej Kryetari e ushtron profesionalisht. *"Kryetari i Komunës konvokon dhe kryeson mbledhjet e Këshillit komunal"*[32]. Ka të drejtë të jetë i pranishëm dhe të marrë pjesë në

[32] Statuti i Komunës së Preshevës, dokument i cituar, neni 49, paragrafi 3

punën e seancave të Këshillit (Kuvendit), e sipas nevojës edhe në seancat e Komisioneve të Këshillit, por nuk ka të drejtë vendosjeje. Obligim i tij është që të merr pjesë në seancat e Këshillit, (Kuvendit) atëherë kur në rend të ditës parashihet parashtrimi i pyetjeve të këshilltarëve, për të cilat, po ashtu është i obliguar të jep përgjigje gojarisht ose me shkrim. Ka të drejtën të autorizojë përfaqësuesit e tij për të qenë të pranishëm në punën e seancave të Këshillit dhe mbledhjet e komisioneve. Me vetiniciativë ose me kërkesë të Këshillit, përkatësisht Kuvendit, e njofton atë, për realizimin e punëve të caktuara nga kompetenca e tij. Ka të drejtën e thirrjes së tubimit të qytetarëve të asaj komune ose të një pjese të saj me vetiniciativë. Mund të organizojë tribuna publike për të informuar qytetarët rreth nxjerrjes së ndonjë dispozite ose marrjes së ndonjë vendimi për planifikimin hapësinor ose urbanistik dhe të marrë propozime ose të anketojë të pranishmit për ndonjë çështje që ka të bëjë me këto punë.

Ka të drejtën e marrjes së vendimeve për zgjidhjen e të drejtave, obligimeve dhe interesave të veçanta të personave fizik dhe juridik. Obligim i tij është që në afat prej shtatë ditësh nga dita e nxjerrjes së akteve, t'i shpall në Fletoren zyrtare të Komunës. Konform funksionit, vendos për shfrytëzimin e mjeteve të rezervës buxhetore të Komunës.

1.2. Kompetencat e Kryetarit të Komunës

Kryetari nëpër Komunat e Kosovës, ka kompetenca të udhëheq me Komunën dhe të prezantojë atë. Udhëheq ekzekutivin e administratën dhe mbikëqyr administrimin financiar të saj. Emëron ose shkarkon zëvendësit ose nënkryetarët. Emëron dhe shkarkon këshilltarët që i zgjedh për ta ndihmuar a këshilluar gjatë kryerjes së funksionit të Kryetarit. Në cilësinë e funksionit të tij, emëron drejtorët e drejtorive që e ndihmojnë për të kryer e detyra që i ngarkohen. Kompetencë e tij është propozimi i buxhetit të Komunës, si dhe ekzekutimi i të gjitha vendimeve që merren në Kuvend të Komunës e që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të banorëve lokal.

Në Kosovën Lindore, kryetari i Komunës, ka kompetencë të përfaqësojë Komunën. Propozon vendimet dhe aktet tjera të cilat i nxjerr Kuvendi, si dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjeve për të cilat vendos Kuvendi Komunal. Drejton dhe përshtat punën në administratën Komunale. Propozon kryeshefin e administratës Komunale si dhe shkarkimin e tij, përkatësisht kryeshefin e ndonjë njësie punuese. Është urdhërdhënës për ekzekutimin e buxhetit. Nxjerr akte konkrete për të cilat është i autorizuar me ligj, statut apo vendim të Kuvendit. Propozon dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Komunal. Kompetencë e kryetarit të Komunës është të zgjedhë Arkitektin kryesor të Komunës. Kryetari i Komunës themelon shërbimin lokal për inspektim dhe revizion. Ka të drejtë që, Qeverisë ose Autonomisë Territoriale, t'i bëjë kërkesë për rishikimin e të drejtave për vendim marrje, kur vlerëson që organi i Republikës ose forma e Autonomisë Territoriale, ka vendosur diçka që është në kompetencë të Organit të Komunës.

Në Maqedoni, Kryetari i Komunës, po ashtu, përfaqëson Komunën, kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të Këshillit të Komunës. Publikon dispozitat e Këshillit në fletoren zyrtare të Komunës. Ekzekuton vendimet e Këshillit. Bënë ekzekutimin dhe kryerjen e punëve që i janë deleguar Komunës. Nën kompetencë të tij është të iniciojë dhe të propozojë nxjerrjen e dispozitave që janë në kompetencë të Këshillit. Propozon buxhetin vjetor dhe llogarinë vjetore të buxhetit të Komunës. Ekzekuton buxhetin e Komunës. Zgjedh drejtorët e shërbimeve publike që i themelon Komuna, me konkurs të hapur. Rregullisht informon Këshillin për kryerjen e punëve që bien në kompetencat e tij. "*Vendos për punët e administratës për të drejtat obligimet dhe interesat e personave si fizik ashtu edhe ata juridik, në përputhje me ligjin*"[33]. Nxjerr rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale. Udhëheq me administratën komunale. Vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën komunale.

[33] Zakon za Lokalnata Samouprava (Sluzben vesnik na Republika Makedonija" br.5 od 29 januari 2002 god.) dok. i cituar, neni: 50, alineja 11

Në Komunat e Malit të Zi, prefekti, propozon rregulloret dhe aktet tjera që nxjerr Kuvendi, si dhe mënyrën e zgjidhjes së disa çështjeve nga kompetencat e Kuvendit. Përcakton Organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale, me propozim të administratorit kryesor. Emëron dhe shkarkon nënkryetarin e Komunës. Me pëlqim të Kuvendit emëron ose shkarkon administratorin kryesor, drejtorin e agjencisë e menaxherin. Jep pëlqim për emërimin dhe shkarkimin e shefave të organeve të vetadministrimit lokal. Drejton dhe harmonizon punën e organeve të administrimit lokal, shërbimeve publike dhe agjencive që i ka themeluar Komuna. Angazhohet për një realizim sa më të mirë të funksionimit të tyre si dhe për një shërbim sa më kualitativ, për të cilat nxjerr aktet e duhura. Nxjerr aktet nga kompetencat e veta si dhe ekzekuton ato veprimtari që i janë deleguar ose besuar, nëse nuk janë të rregulluara ndryshe me ndonjë rregullore të veçantë. Nxjerr akte me të cilat siguron zbatimin e buxhetit të Komunës. Thërret mbledhjen konstituive të Kuvendit. Prefekti i Komunës nxjerr përkohësisht akte që i takojnë kompetencave të Kuvendit, nëse Kuvendi nuk ka mundësinë që të mblidhet ose për arsye të tjera kur puna e Kuvendit është e pamundur, ndërkaq mosnxjerrja e akteve të tilla do të dëmtonte jetën, pasurinë ose vlerat tjera njerëzore.

1.3. Kompetencat e deleguara Kryetarit të Komunës në Republikën e Maqedonisë

Organi i Pushtetit Qendror, nga kuadri i kompetencave të veta, mund t'i delegojë kryerjen e disa punëve të caktuara, Kryetarit të Komunës. Kur bëhet kjo, atëherë edhe mjetet sigurohen nga organi i Pushtetit Qendror. Por, përgjegjësia e kryerjes së punëve të deleguara mbetet te organi i Pushtetit Qendror, andaj ky organ ka për obligim të mbikëqyr kryerjen e atyre punëve.

1.4. Përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës, përkatësisht të Prefektit

Në përgjegjësi të Kryetarit të Komunës në Kosovë, hyn jo vetëm propozimi i buxhetit vjetor, por edhe mënyra se si do të përdoret apo shpërndahet dhe si do të shpenzohet. Përgjegjësi tjetër është edhe zbatimi ose anulimi i rregulloreve të miratuara dhe vendimeve të marra nga Kuvendi Komunal; Administrimi financiar i Komunës; Shqyrtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat ose interesat e Komuniteteve si dhe çdo përgjegjësi tjetër që do t'i ngarkohet me statut dhe rregullore të punës, të miratuar nga Kuvendi Komunal.

Në Kosovën Lindore, Kryetari i Komunës, drejtpërdrejt kryen dhe kujdeset për ekzekutimin e vendimeve dhe akteve të tjera të Kuvendit Komunal. Kujdeset për kryerjen e detyrave të besuara të cilat janë në kuadër të obligimeve të Pushtetit Qendror. Vendos në dhënien e kompetencave shtesë, kryeshefit të organit si dhe mbikëqyr punën e Këshillit Komunal. Në përgjegjësi të tij është miratimi i akteve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës.

Kryetari i Komunës, në Maqedoni, në suaza të përgjegjësive, nxjerr akte të veçanta. Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit. Realizon procedurën për shpalljen e konkursit publik dhe bënë zgjedhjen e drejtorit në shërbimet publike dhe institucione komunale. Detyrohet që në afat prej shtatë ditësh prej ditës së dërgimit të aktit të Këshillit me aktvendim, ta ndal shpalljen, nëse mendon që nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Nëse aktvendimi i tij nuk miratohet nga Këshilli i Komunës, detyrohet të shpall aktin e pastaj të iniciojë procedurën e vlerësimit të Kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të atij akti të kontestuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë. Për një nismë të tillë, është i detyruar të informojë ministrinë kompetente për kryerjen e punëve që i përkasin Qeverisjes Vendore. Dy herë në vit, Kryetari i Komunës është i obliguar të paraqes raport për zbatimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli i Komunës. Rreth ushtrimit të kompetencave të veta e informon Këshillin e

Komunës, sipas nevojës, së paku njëherë në vit. Sa i përket administrimit me pronësinë e Komunës, është i detyruar të merr masa dhe të sigurojë shfrytëzim të drejtë të asaj pronësie. Kryetari mund të autorizojë zyrtarin udhëheqës të Komunës që të udhëheq procedurë dhe të vendos për punët e administratës si dhe të nënshkruaj akte.

Prefekti në Komunat e Malit të Zi, është përgjegjës për të gjitha kompetencat që i bien sipas funksionit që kryen. Ai kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjit, rregulloreve të tjera si dhe akteve të përgjithshme. Kujdeset dhe është përgjegjës për ekzekutimin dhe transferimin e punëve të besuara. Qytetarëve dhe Kuvendit u raporton për punën e tij dhe për realizimin e funksionimit të Qeverisjes Vendore, më së paku një herë në vit. Kujdeset për realizimin sa më funksional të shërbimeve publike dhe që ato të jenë sa më kualitative. Mbikëqyr punën e administratës lokale. Është përgjegjës për zbatimin e vendimeve dhe akteve të tjera që nxjerr Kuvendi dhe nxjerr akte për zbatimin e tyre. Është i obliguar që këto vendime dhe akte t'i paraqes për t'u miratuar nga Kuvendi në seancën e radhës. *"Për punët që janë nën kompetencë të vetadministrimit lokal, Kryetari, i përgjigjet qytetarëve dhe Kuvendit„*[34]. Kjo do të thotë që ai i përgjigjet qytetarëve dhe Kuvendit të Komunës për të gjitha veprimtaritë që kanë të bëjnë me kompetencat e Qeverisjes Vendore. Është përgjegjës dhe jep llogari për veprimet e veta që kanë të bëjnë me veprimtaritë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive që i takojnë.

1.5. Mungesa e përkohshme e Kryetarit

Në mungesë të Kryetarit të Komunës në Kosovë, ose në rast të pamundësisë së kryerjes së funksionit, atë do ta zëvendësojë nënkryetari i Komunës, ose zëvendësi i Kryetarit të Komunës, që e emëron vetë ai, në një mandat kohor prej katër vjetësh.

Në Komunat e Kosovës Lindore, përkohësisht kryetarin e zëvendëson zëvendës-kryetari. Në Maqedoni, gjatë kohës së

[34] Zakon o Lokalnoj samoupravi Crne Gore, dokument i cituar: neni 59, paragrafi 1

pengesës ose të mungesës deri në gjashtë muaj Kryetarin e Komunës e zëvendëson anëtari i Këshillit të Komunës të cilin e cakton Kryetari. Në afat prej 30 tridhjetë ditësh prej ditës së marrjes së funksionit është i detyruar me aktvendim të caktojë anëtarin e Këshillit që do ta zëvendësonte në rast mungese. Obligim i tij është që me kohë, të informojë Kryetarin e Këshillit nëse është i penguar për të kryer punët që bien në kompetencat e tij ose nëse për ndonjë arsye mungon.

1.6. Ndërprerja e mandatit të Kryetarit, përkatësisht e Prefektit të Komunës

Në Komunat e Kosovës, Kryetari (sipas Rregullores 2007/30) kishte mandat dy vjeçar dhe ai mund të shkarkohej nga detyra vetëm nëse humbiste të drejtën e kandidatit për të qenë kryetar i asaj Komune, nuk shkonte në punë 60 ditë, dënohej për ndonjë vepër penale deri në gjashtë muaj burgim, humbiste mendjen, vdiste ose humbiste aftësitë punuese dhe në rast dorëheqjeje. Kryetari që do të zgjedhej në zgjedhjet e jashtëzakonshme do të kishte mandatin deri në ditën kur është dashur të përfundonte mandati i ish Kryetarit të Komunës. Mirëpo me miratimin e Ligjit që përcakton Qeverisjen Vendore në Republikën e Kosovës, Kryetari i Komunës mund të shkarkohet nëse nuk e jep betimin brenda një muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve dhe nëse cenon Kushtetutën e kjo vërtetohet nga Gjykata Kushtetuese[35] e Republikës së Kosovës.

Kryetarit të Komunës në Kosovën Lindore i ndërpritet mandati para kohe, kur jep dorëheqje nga posti që mban. Nëse gjykohet për vepër penale dhe dënohet me së paku gjashtë muaj burgim. Ai mund të hiqet nga posti edhe nëse me vendim të prerë të gjyqit është privuar nga aftësitë vepruese. Po ashtu do të largohet nga kryerja e detyrës së Kryetarit të Komunës, nëse i ndërpritet shtetësia e shtetit ku jeton dhe kryen funksionin e Kryetarit të Komunës si dhe nëse kryen ndonjë punë që është në kundërshtim me funksionin e kryetarit të

[35] Shih: Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës, neni 60, alinea.3

Komunës. Shkak tjetër për të lënë funksionin e Kryetarit të Komunës merret edhe shpërngulja nga ajo Komunë dhe kur s'është më banor komunës ku e kryen funksionin e prefektit. Kryetari mund të shkarkohet edhe para kohe, kur këtë e kërkojnë së paku 10% e zgjedhësve, me shumicë votash në Kuvend të Komunës, përkatësisht Qeveria, kur vërtetohet që punët e besuara nuk kryen në përputhje me ligjin. Për këtë propozim, zgjedhësit, vendosin me vota të fshehta në zgjedhje të drejtpërdrejta.

Ndërprerja e mandatit e kryetarit do të thotë edhe ndërprerje e mandatit e zëvendësit të tij. Kur kryetarit i ndërpritet mandati para kohe, funksionin e kryetarit të Komunës e kryen Kryetari i Kuvendit të Komunës deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

Në Maqedoni, Kryetarit i ndërpritet mandati nëse jep dorëheqje, nëse vdes, nëse gjykohet me vendim të prerë për vepër penale dhe dënohet me më shumë se gjashtë muaj burg. Atij i ndërpritet mandati, po ashtu edhe nëse privohet nga aftësitë vepruese; nëse vepron në papërputhshmëri të funksionit dhe veprat e tilla janë në kundërshtim me ligjin zgjedhor vendor; si dhe në rast të mungesës së paarsyeshme që do të ishte më e gjatë se gjashtë muaj. Në këto raste, personi që do të zëvendësojë Kryetarin, në afat prej 15 ditësh, është i obliguar të informojë ministrinë përkatëse për dorëheqjen e Kryetarit, vdekjen, paaftësinë vepruese apo mungesën e paarsyeshme të tij.

Në Malin e Zi, Kryetarit të Komunës i pushon mandati para kohe, kur, revokohet, mbivotohet për mosbesim, humb aftësitë vepruese dhe jep dorëheqje. Qytetarët mund të ndërmarrin procedimin për revokimin e prefektit të Komunës. *"Procedimi i revokimit mund të ndërmerret me më së paku 20% të zgjedhësve në Komunë"*[36]. Kjo do të thotë që, qytetarët e Komunave të Malit të Zi, mund të nisin procedurën e ndërrimit a shkarkimit të Kryetarit të Komunës, nëse për atë iniciativë, nënshkruajnë 20% e elektoratit të asaj Komune. Me iniciativën e

[36] Po aty: neni 61, paragrafi 2

qytetarëve dhe pas votimit për atë iniciativë të së paku 20% të elektoratit, mund të vijë deri te revokimi i Prefektit të Komunës.

Nëse kjo nismë nuk kalon, qytetarët nuk kanë të drejtë të përsërisin procedurën për revokim pa kaluar së paku gjashtë muaj nga votimi i mëparshëm. Kjo procedurë, do të thotë iniciativa për shkarkimin e prefektit, merret kur shkelen të drejtat e qytetarëve apo prefekti nuk i kryen punët me korrektësi; kur nuk i realizon planet zhvillimore dhe aktet që nxjerr sjellin dëme të konsiderueshme për territorin e komunës.

Kryetari i Komunës e ka të drejtën dhe mund të shtrojë çështjen e besimit të tij para qytetarëve. Çështjen e besimit të Kryetarit të Komunës mund ta shtrojë edhe Kuvendi, në rastet kur shkelen të drejtat dhe liritë e qytetarëve, kur punët nuk i kryen me korrektësi, kur nuk realizon planet zhvillimore dhe kur nxjerr akte që i sjellin dëme materiale të konsiderueshme Komunës. Dorëheqja nga Kryetari kërkohet edhe kur nuk i paraqet raportin e punës Kuvendit ose kur nuk i paraqet aktet që nxjerr (akte këto që janë në kompetenca të Kuvendit dhe që duhet të miratohen prej tij) para Kuvendit në miratim, në seancën vijuese. Iniciativën për mosbesim ndaj punës së Kryetarit, mund ta ndërmarrin edhe një e treta e këshilltarëve të Kuvendit dhe Qeveria. Nëse Kuvendi e miraton iniciativën e tillë, atëherë fillon procedura e mosbesimit e prefektit të Komunës. Për dhënien e (mos)besimit, Kryetarit të Komunës, vendosin qytetarët, duke votuar me vota të fshehta.

1.7. Kryetari - nënkryetari, Konflikti i Interesave

Kryetari i Komunës në Kosovë, pas zgjedhjes, duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur çdo kontratë ose lidhje tjetër për të mos u vënë në dyshim mundësia e kryerjes së obligimeve të tij në formë të drejtë dhe të pa anshme. Privohet nga e drejta për vendimmarrje për ndonjë çështje ku ai ose ndonjë anëtar i familjes së ngushtë ka ndonjë interes. Ka të drejtën edhe të heqjes dorë vullnetarisht nga vendimmarrja ose votimi kur për një çështje të tillë diskutohet në Kuvend.

Punët e Prefektit dhe zëvendës-prefektit të Komunës në Kosovë Lindore ishin të papajtueshme me funksionin e

këshilltarit. (Ndërsa tani, nuk mund të zgjedhet kryetar apo zëvendës kryetar nëse së pari nuk është këshilltar). Në Mal të Zi, këto funksione janë të papajtueshme me funksionin e këshilltarit. Me të marrë funksionin e Kryetarit a nënkryetarit, personat në fjalë janë të obliguar që të ndërpresin marrëdhënien e punës, nëse janë të punësuar.

Në Maqedoni, Kryetari nuk mund të emërohet anëtar i mbikëqyrjes së organeve drejtuese dhe kontrolluese të organizatave tregtare dhe shërbimeve publike. Ai nuk mund të merr pjesë në procesin e vendosjes ku ka përfitime personale financiare a materiale, as në rastet kur për to (përfitime materiale e financiare) synon ndonjë i afërm i tij duke filluar nga gruaja, fëmijët, vëllezërit apo të afërmit e shkallës së dytë. Në raste të tilla, është i obliguar të informojë Këshillin.

1.8. Nënkryetari i Komunës

Në Kosovë, në Komunat ku jetojnë një apo më shumë komunitete, të cilët nuk janë shumicë por që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të popullatës, emërohet një nënkryetar për komunitete. Ky zgjidhet me propozim të Kryetarit të Komunës e me miratim të Kuvendit të Komunës. Mënyra e zgjedhjes së tij është të votojë shumica e këshilltarëve prezent si dhe shumica e këshilltarëve jo-shumicë. Nënkryetari i komuniteteve do t'i ndihmojë Kryetarit të Komunës në punët që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë në Komunë.

Në Kosovën Lindore, kryetari mund të emërojë një zëvendës-kryetar i cili do të caktohet me pëlqim të Kuvendit. Zëvendës-kryetari i kryen të gjitha punët që ia cakton kryetari si dhe i kryen punët e kryetarit kur ky i dyti, mungon. Zëvendës-kryetari mund të jetë edhe nga pakicat, por kjo nuk është e domosdoshme.

Nëpër Komunat e Maqedonisë, sipas Ligjit që rregullon Qeverisjen Vendore nuk është paraparë posti i nënkryetarit të Komunës por, në raste të jashtëzakonshme, Kryetarin do ta zëvendësojë njëri nga këshilltarët e Këshillit të Komunës të cilin e cakton Kryetari i Komunës.

Komuna në Mal të Zi, mund të ketë një ose më tepër nënkryetarë. Nënkryetarin e emëron dhe e shkarkon Kryetari i Komunës me pëlqim të Kuvendit. Mandati i nënprefektit zgjat aq sa edhe mandati i Kryetarit të Komunës. Ai mund ta zëvendësojë Kryetarin, në rastet kur mungon ose kur nuk është i aftë për të kryer punën e Kryetarit si dhe i kryen punët që ia beson Kryetari.

II. Kuvendi Komunal

Organi më i lartë përfaqësues i Komunës në Kosovë, sipas Rregullores 2007/30, ishte Kuvendi Komunal. Ky organ zgjedhej në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga zgjedhjet e lira dhe demokratike. Pushteti dhe detyrat e Komunës ushtroheshin nga Kuvendi Komunal dhe Organet e tij, përveç rasteve kur me këtë rregullore, përcaktohej ndryshe. *"Mandati i parë për këshilltarët e Kuvendeve Komunale pas shpalljes së kësaj Rregulloreje dhe mandati i parë për kryetarët është dy (2) vjet. Më pastaj mandati për këshilltarët e Kuvendeve Komunale dhe për kryetarët është katër (4) vjet"*[37]. Pas pavarësisë së Republikës së Kosovës, me miratimin e Ligjit që rregullon Qeverisjen Vendore, është paraparë po ashtu që mandati i këshilltarëve që do të përbënin Kuvendin Komunal të jetë në një afat kohor prej katër vitesh, por që aktet që do të miratoheshin nga Kuvendi i Komunës nuk duhet të ratifikohen më prej PSSP-së për të fituar validitetin e vet.

Kuvendi i Komunës, kujdeset që këto të drejta dhe mundësi të përfshihen në statutin dhe rregullat procedurale të tij. Mban mbledhjen e parë inauguruese brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e verifikimit të rezultateve të zgjedhjeve[38] me ç'rast, përfaqësuesi më i vjetër i Kuvendit kryeson çdo mbledhje derisa të zgjedhet Kryetari i Komunës.

Kuvendi Komunal në Kosovën Lindore, është organ përfaqësues dhe kryen funksionet themelore të Qeverisjes Vendore të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe Statut.

Kuvendin e Komunës e përbëjnë këshilltarët e zgjedhur nga qytetarët lokal, në zgjedhjet e drejtpërdrejta, me votën e tyre të lirë dhe të fshehtë. Numri i këshilltarëve të Kuvendit Komunal përcaktohet me statut të Komunës. Por, numri i

---

[37] UNMIK REG: 2007/27 Rregullore Nr. 2007/27, Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë, 27 gusht 2007, neni 4 alineja 1

[38] Shih: Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës, neni 42, alinea 2

këshilltarëve nuk është më i vogël se 19 në Komunat e vogla e as më i madh se 75 në ato më të mëdha. Kuvendi Komunal dhe Këshilltarët zgjedhen për afatin kohor katër vjeçar. Kuvendi Komunal ka Kryetarin e vet i cili i kryeson mbledhjet e Kuvendit.

Organi tjetër i Komunës në Republikën e Maqedonisë është Këshilli i Komunës, i cili është organ përfaqësues i qytetarëve. Këshillin e Komunës në këtë shtet e përbëjnë përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira, me votim të fshehtë. Këshilli i Komunës, ka mandat po ashtu, katër vjeçar.

Konstituimi i Këshillit të Komunës në Maqedoni bëhet duke respektuar procedurën e verifikimit të mandatit të anëtarëve të zgjedhur të Këshillit dhe me dhënien e deklaratës solemne, të cilën e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e zgjedhur të Këshillit të Komunës.

Këshilli i Komunës, nga radhët e veta zgjedh Kryetarin i cili kryeson mbledhjet e Këshillit të Komunës si dhe cakton komisionet punuese. Këshilli, miraton Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Këshillit, merr vendime, planifikon dhe projekton plane e programe, nxjerr aktvendime, nxjerr përfundime e akte të tjera. Në kuadër të veprimtarisë së vet, jep mendime dhe përcakton kahet e veprimeve. Krejt këto i realizon me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Komunës. Nëse për ndonjë arsye, Kryetarit të Komunës i pushon mandati, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, Këshilli i Komunës do të zgjedh një anëtar i cili do t'i kryej punët e Kryetarit të Komunës, deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Mali i Zi, nuk bën përjashtim. Pos, Kryetarit të Komunës, për të cilin bëmë fjalë më herët, Organ tjetër i Komunës është Kuvendi Komunal. Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve të Komunës. Qytetarët zgjedhin këshilltarët që do ta përbënin Kuvendin e Komunës në bazë të zgjedhjeve të lira e në përputhje me ligjin. Kur flasim për zgjedhje, mund të thuhet që, *"Zgjedhjet për kryetar të Komunës i shpall Kuvendi*[39]*"*. Mandati i

[39] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Crne Gore, neni 42, paragrafi 2

Kuvendit zgjat katër vjet. Edhe në Komunat e Malit të Zi, këshilltarët i kanë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e njëjta me tre vendet tjera. Po ashtu mandati i këshilltarëve Komunal është katër vjet.

1. Funksioni i Kuvendit të Komunës

Kuvendi Komunal në Kosovë, miraton statutin dhe e ndryshon, nëse konsideron që një gjë e tillë është e nevojshme. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e statutit miratohet me më shumë se dy të tretat e anëtarëve të pranishëm në mbledhjen kur shqyrtohet propozimi i tillë. Miraton rregullat e procedurës dhe mund t'i ndryshojë ato nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Rregullat e procedurës duhet të sigurojnë udhëheqjen dhe kontrollin, duke përfshirë kontrollin efikas financiar të administratës së Komunës. Kur më tepër se gjysma e këshilltarëve të Kuvendit, votojnë për miratimin apo ndryshimin e Rregullores së punës të Kuvendit, atëherë, në rastin e parë vazhdohet të punohet me atë Rregullore, ndërsa në rastin e dytë, ajo ndryshohet. Krejt varet sesi përcaktohen këshilltarët: për ndryshimin apo për miratimin e asaj Rregulloreje. Me rëndësi është që ai vendim të mbështetet nga më se gjysma e këshilltarëve të pranishëm në votim.

Në Komunat e Kosovës Lindore, Kuvendi i Komunës ka po atë funksion si edhe në Kosovë. Mund të theksojmë që në këto Komuna, pasi ekziston Këshilli për marrëdhënie ndërnacionale, Kuvendi i Komunës ka për obligim të merr ndonjë vendim më së voni tridhjetë ditë nga dita kur është marrë ndonjë sugjerim ose propozimvendim nga Këshilli për marrëdhënie ndërnacionale. Këtë vendim do të duhej t'i dërgonte këtij Këshilli në këtë afat kohor.

Këshilli i Komunës në Maqedoni, del nga zgjedhjet e lira dhe kryen funksionin e legjislativit në Komunë. Është obligim i Këshillit të Komunës që në afat prej 15 ditësh, të ndërmerr masat e duhura, nëse një akt ose dispozitë e nxjerrë nga ky subjekt, është ndalë nga Kryetari i Komunës për shkak të jo përputhshmërisë me Kushtetutën dhe ligjin. Nëse paraqitet një rast i tillë, Këshilli i Komunës është i obliguar të rishikojë atë akt edhe një herë, në mos

është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin që rregullon Qeverisjen Vendore në Republikën e Maqedonisë. Nëse qytetarët kërkojnë tubim të qytetarëve ose kanë ndonjë iniciativë apo referendum, obligim i Këshillit të Komunës është të informojë qytetarët për vendimin që merr. Pasi të jetë mbajtur referendumi, vendimi që merret aty, është i detyrueshëm për Këshillin. Këshilli i Komunës është i obliguar po ashtu, t'i shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komisionit për çështje mandatore dhe të vendos për to. Me anë të Rregullores të punës së Këshillit, rregullohet mënyra e punës së Këshillit dhe e Komisioneve të tij; procedurat e vendimmarrjes dhe ndërtimi i marrëdhënieve ose sjellja me organet e tjera. Këshilli i Komunës me vendim rregullon punët që janë me rëndësi lokale e që i takojnë kompetencave të Komunës. Këshilli i Komunës me vendim formon administratën komunale, rregullon mënyrën e punës së saj dhe themelon shërbime publike. Këshilli i Komunës, është organ që po ashtu me vendim rregullon edhe çështje të tjera që janë në kompetencë të tij. Në përgjegjësi të tij është nxjerrja e përfundimeve kur shqyrton raportet, informatat dhe analizat. Këshilli bën plane dhe programe për punën e shërbimeve publike që i ka themeluar, për punën e shkollave fillore dhe të mesme, enteve komunale për mbrojtje të fëmijëve dhe institucioneve të tjera publike.

Në kryerjen e punëve të kësaj natyre, Kuvendi i Komunës në Malin e Zi, nxjerr statutin, vendimet dhe aktet e tjera. Statuti është akti themelor me të cilin rregullohet Organizimi, puna, mënyra dhe realizimi i Qeverisjes Vendore. Me vendim, vendoset për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve. Themelohen shërbimet publike si dhe vendoset për të gjitha çështjet e tjera, në përputhje me të drejtat, detyrimet dhe kompetencat.

1.1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit (Kuvendit) të Komunës

Kuvendin e Komunës në Kosovë, Kosovë Lindore e Mal të Zi apo Këshillin e Komunës në Maqedoni e përbëjnë përfaqësuesit e qytetarëve të zgjedhur drejtpërdrejtë në zgjedhjet e përgjithshme dhe të lira me votim të fshehtë. Ligjet që rregullojnë Qeverisjen Vendore në këto vende, përcaktojnë numrin e anëtarëve të Kuvendit (Këshillit) të Komunës në bazë

të numrit të banorëve dhe ata mund të sillen nga 15 deri 51 në Kosovë; 19 deri 75 këshilltarë (varësisht nga numri i banorëve) në Komunat e Kosovës Lindore; 9 deri në 33, në Maqedoni; dhe në Mal të Zi 30 këshilltarë dhe nga një anëtar për pesë mijë banorë. Anëtarët e Këshillit zgjidhen për katër vjet, dhe përfaqësojnë qytetarët. Ata kanë të drejtën të vendosin sipas mendimit të tyre dhe nuk mund të arrestohen ose burgosen për mendimin e shprehur në Këshill.

1.2. Të drejtat e Këshillit të Komunës në Maqedoni

Në Maqedoni, e drejtë e Këshillit të Komunës është të vendos për bashkimin e njësive të administratës për të marrë një pjesë të kompetencave. Njësitë e bashkuara të administratës për kryerjen e një pjese të kompetencave mund të themelohen dhe shpërbëhen në bazë të vendimit të marrë me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Komunal. Me këtë rast, duke u thirrur në vendimin e marrë nga Këshilli Komunal, përcaktohen edhe Komunat që do ta përbënin këtë bashkësi administrative. E drejtë e Këshillit të Komunës është të përcaktojë edhe mënyrën e kryerjes së punëve, format dhe subjektin që do të merret me kryerjen e detyrave nga kompetencat që i takojnë. Në këtë kuadër hyn edhe shfrytëzimi i objekteve dhe i mjeteve, aktivitetet, financimi, mënyra e shpërbërjes dhe kontrolli i të të punësuarve në atë njësi administrative. E drejtë e Këshillit të Komunës është të organizojë tribunë publike për t'u informuar qytetarët lidhur me nxjerrjen e dispozitave të reja apo për ndonjë plan urbanistik të atij territori.

1.3. Obligimet dhe të drejtat e këshilltarëve të Kuvendit Komunal

Këshilltarët e Kuvendit Komunal nëpër Komunat e Kosovës, janë të obliguar që para mbledhjes së parë të Kuvendit Komunal, t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare. Ata, po ashtu kanë për obligim të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa të bëhet ky ndryshim.

E drejtë e Këshilltarit të Kuvendit Komunal në Komunat e Kosovës, është të kërkojë informacione nga Kryetari, zëvendëskryetari, apo Kryesuesi i Komitetit, për çështjet që diskutohen ose vendoset. Ai mban të drejtën e dorëzimit të vërejtjeve me shkrim. Këto vërejtje duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit.

E drejtë e tij është që të diskutojë, por nuk mund të votojë në mbledhjet e Komitetit të Kuvendit në të cilin ai ose ajo nuk është anëtar. Në këto raste, mundet t'i propozojë kryesuesit të komitetit për të diskutuar rreth ndonjë çështjeje që është në përgjegjësi të Komitetit.

Kërkon informata të nevojshme dhe ndihmë të arsyeshme administrative nga bordi i drejtorëve, për të kryer punën e tij me nder. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigje, mund ta ngre çështjen në Kuvendin e Komunës. Ka të drejtën e mungesës në vendin e tij të përhershëm të punës në kohën derisa mbahet mbledhja e Kuvendit Komunal ose e Komitetit ku është anëtar. Ka po ashtu të drejtën e kompensimit apo shpërblimit për shpenzimet e bëra për kohën sa merr pjesë në mbledhje. E drejtë e këshilltarit është të tërhiqet vullnetarisht nga procesi i marrjes së vendimeve dhe procedurave administrative nëse konsideron që ato mund të çojnë deri te konflikti i interesave.

Këshilltari në Kuvendin Komunal të Kosovës Lindore, ka të drejtën e debatit për temat e caktuara në rend dite në mbledhjet e Kuvendit Komunal. Ka të drejtë të votojë sipas bindjeve të veta dhe për këto si për debat ashtu edhe për votim nuk mund të merret në përgjegjësi e as të arrestohet apo të burgoset.

Anëtari i Këshillit Komunal në Maqedoni, ka të drejta dhe obligime, të cilat i merr pasi t'i verifikohet mandati. Të drejtat dhe obligimet e tyre janë që të propozojnë shqyrtimin e çështjeve, dukurive dhe situatave që janë me rëndësi lokale për qytetarët e Komunës; të ndërmarrin iniciativa për sjellje të vendimeve dhe akteve të tjera në kompetencë të Këshillit si dhe të propozojnë amendamente. Të kërkojnë nga administrata Komunale, shërbimet publike dhe institucionet e themeluara nga Komuna, të dhëna dhe informata të tjera për çështje që janë në kompetencë të Këshillit. Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë

dhe obligim të marrin pjesë në çdo mbledhje të Këshillit dhe në punën e Komisioneve të përhershme dhe atyre të përkohshme. Ata kanë të drejtë të marrin iniciativë ose të propozojnë dhe t'i shtrojnë pyetje Kryetarit të Komunës. Kanë të drejtën e shprehjes dhe votimit të lirë në Këshill, pa pasur ndonjë pengesë ose pasoja për ato që thonë ose veprojnë në mbledhjet e Këshillit e që ka të bëjë me interesin e përbashkët dhe të përgjithshëm të qytetarëve të asaj Komune. Anëtari i Këshillit të Komunës është i obliguar të informojë Këshillin, kur shqyrtohet ndonjë çështje, ku, ai ose familja e tij kanë interesa financiare a materiale. Nëse anëtari i Këshillit të Komunës është i punësuar dhe duhet që gjatë orarit të punës të marrë pjesë në mbledhje të Këshillit ose Komisioneve të Këshillit, ka të drejtë të mungojë në punë ose ta lëshojë vendin e punës për aq kohë sa merr pjesë në punët e Këshillit të Komunës. E drejtë e anëtarëve të Këshillit, është të thërrasin mbledhjen e parë konstituive ose ndonjë mbledhje tjetër që ka të bëjë me rëndësinë lokale. Në rastin e parë, nëse këtë nuk e bën Kryetari i mëparshëm i Këshillit në afat të caktuar kohor, ndërsa në rastin e dytë, nëse Kryetari aktual i Këshillit të Komunës, nuk e thërret mbledhjen e paraparë ose të iniciuar nga anëtarët e Këshillit të Komunës.. Anëtari më i vjetër i Këshillit të Komunës ka të drejtën e kryesimit të mbledhjes së parë konstituive të Këshillit të Komunës. Kurse mbledhjen e ftuar nga anëtarët e Këshillit, do ta kryesojë anëtari që do të caktohet nga Këshilli i Komunës. Anëtarët e Këshillit të Komunës, kanë të drejtën e kompensimit të rrugës dhe shpenzimeve ditore, për ditën kur marrin pjesë në mbledhje të Këshillit apo të Komisioneve të tij.

1.4. Ndërprerja e mandatit e Këshilltarit të Kuvendit Komunal

Në Kosovë, këshilltarit të Kuvendit Komunal i pushon mandati në rastet kur: nuk e nënshkruan betimin ose deklaratën e detyrës brenda një muaji pas zgjedhjes; jep dorëheqje; përfundon mandatin; është dënuar për kundërvajtje penale të dënueshme me tre muaj burgim dhe është lëshuar urdhri për burgim; nuk merr pjesë në mbledhje të Kuvendit ose të Komitetit ku është anëtar për tre muaj rresht pa ndonjë arsye;

dhe nëse e humb të drejtën për t'u zgjedhur Këshilltar i Kuvendit në atë Komunë.

Anëtarit të Këshillit Komunal në Maqedoni, i ndërpritet mandati para kohe kur jep dorëheqje, nëse vdes, nëse gjykohet me vendim të prerë për vepër penale dhe dënimi i tij me burg është më shumë se gjashtë muaj; nëse funksioni i anëtarit nuk është në përputhje me detyrën që kryen (vendi i punës), nëse me vendim të prerë është vendosur që është privuar nga aftësitë vepruese; nëse ndërron vendbanimin nga Komuna ku është zgjedhur anëtar dhe s'është më banor i asaj Komune; Këshilli në seancën e radhës do të arsyetojë shkakun e ndërprerjes së mandatit të ndonjë anëtari që nuk i plotëson kushtet e parapara për të kryer punën e anëtarit të Këshillit. Në rastin e dorëheqjes, Këshilli konstaton menjëherë në atë mbledhje, ndërsa për rastet kur anëtari është sëmurë, është dënuar, apo ka ndërruar vendbanim, mandati i merret për aq kohë sa nuk plotësohen sërish kushtet e duhura. Anëtarit, po ashtu i merret mandati nëse nuk merr pjese tri herë radhazi pa arsye në mbledhjet e Këshillit. Funksioni i anëtarit i pushon edhe për kohën derisa kryen funksionin e Kryetarit të Komunës.

1.5. Kushtet e shpërndarjes së Kuvendit (Këshillit) Komunal

Kuvendi i Komunës përkatësisht Këshilli i Komunës, shpërndahet nëse: përsëri nxjerr një akt që është anuluar e është ndaluar një herë me vendim të Gjyqit Kushtetues të shtetit në fjalë; sjell vendim me të cilin rrezikohet integriteti dhe sovraniteti i atij shteti; nuk mban mbledhje për një afat kohor sa është përcaktuar me Ligjin që rregullon Qeverisjen Vendore në atë vend (6 muaj); nuk miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare vjetore deri më 31 mars të vitit vijues; Me të kuptuar një gjë të tillë Ministria përkatëse merr qëndrim për shpërndarjen e Kuvendit të Komunës. Kuvendi a Këshilli mund të shpërndahet edhe me vetiniciativë të anëtarëve të Kuvendit (Këshillit) kur për atë iniciativë votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit si dhe me iniciativë të Kryetarit të Komunës kur Kuvendi (Këshilli) i Komunës, inicion shkarkimin e tij e një gjë e tillë nuk kalon. Atëherë e drejtë e Kryetarit të Komunës është

të shpërndajë Kuvendin (Këshillin) e Komunës dhe të shpall zgjedhje të reja për anëtarë të Kuvendit (Këshillit) të Komunës.

1.6. Procedura e shpërndarjes së Këshillit

Në Komunat e Republikës së Kosovës, kur Kuvendi Komunal nuk është jo-funksionues, ministria e Pushtetit Lokal do ta njoftojë Qeverinë për situatën e krijuar. Qeveria ka të drejtën për shpërndarjen e Kuvendit të asaj Komune. Në Kosovën Lindore, po ashtu nëse Kuvendi i Komunës nuk funksionon sipas Ligjit, Kushtetutës dhe Statutit të Komunës do të shpërndahet me vetë iniciativë, me propozim të Kryetarit të Komunës dhe me iniciativë të ministrisë përkatëse. Në Komunat e Republikës së Maqedonisë, ministria kompetente për të kryer veprimtaritë e sferës së Qeverisjes Vendore, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të raportit për rrezikimin e integritetit dhe sovranitetit të Maqedonisë, do të paraqes propozimin para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për shpërndarjen e Këshillit të Komunës. Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej një muaji nga pranimi i propozimit do të sjell vendim për shpërndarjen e Këshillit. Edhe në Komunat e Malit të Zi procedohet njëjtë.

1.7. Konflikti i interesave të Këshilltarëve të Kuvendit Komunal

Këshilltarët e Kuvendit Komunal kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe mundësi për të marrë pjesë në proceset e Kuvendit. Ata në të njëjtën kohë nuk mund të kryejnë ndonjë funksion në Komunë apo të jenë të punësuar në Kuvendin e Komunës ku janë këshilltarë. Në Komunat e Republikës së Kosovës, janë precizuar edhe disa konflikte të interesave të mandatit të këshilltarëve Komunal. Sipas Ligjit që rregullon Qeverisjen Vendore, anëtarët e Kuvendit Komunal, nuk mund të jenë drejtor shkolle apo të Qendrave të Mjekësisë Familjare. Ose nëse janë emëruar a caktuar në ato poste, menjëherë pas nënshkrimit të deklaratës me të cilin pranon të jetë anëtar Kuvendi, duhet ta lëshojë atë vend të punës. Për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të ose për anëtarët e familjes së tij,

këshilltari i Kuvendit Komunal në Kosovë, nuk mund të marrë pjesë në vendimmarrje. Këshilltari është i obliguar të paraqes të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me konfliktin e interesave, nëse për to flitet në mbledhje. Është i obliguar të jep edhe informacione për këto raste që kanë të bëjnë me ndonjërin nga këshilltarët e Kuvendit. Në rast të ndonjë konflikti të interesave, statuti dhe rregullat e procedurës përcaktojnë masat për përjashtimin e këshilltarëve ose anëtarëve të Komiteteve nga procesi i vendimmarrjes dhe nga procedurat administrative.

Këshilltari i Kuvendit Komunal në Komunat e Kosovës Lindore, nuk mund të punësohet apo të jetë punëtor në administratën Komunale e as të ketë ndonjë post ku mund të emërojë apo caktojë emërimin e dikujt në ndonjë post. Nëse i punësuari në administratën Komunale zgjedhet këshilltar, atëherë i pushon marrëdhënia e punës deri në skadimin e mandatit të këshilltarit. Personat që emëron apo cakton administrata Komunale, po ashtu i pushon vendi i punës deri në skadimin e mandatit të këshilltarit.

Anëtari i Këshillit Komunal në Maqedoni, nuk mund të marrë pjesë në procesin e vendosjes për çështjet në të cilat ai ose bashkëshorti (bashkëshortja), fëmija ose të afërmit e shkallës së dytë kanë interes financiar a material. Anëtari i Këshillit nuk mund të jetë i punësuar në administratën Komunale të asaj Komune ku është zgjedhur anëtar. Nga dita e punësimit në këtë organ, do të kuptohet se i njejti ka dhënë dorëheqje nga funksioni i anëtarit. Anëtari i Këshillit që është i punësuar në organizatën shërbyese ku themelues është Komuna, nuk mund të merr pjesë në vendimmarrje për çështjet që kanë të bëjnë me atë organizatë ku ai punon.

1.8. Mbledhjet dhe Dokumentacioni i Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal në Kosovë, mban mbledhjet sa herë të paraqitet nevoja, por duhet të mbaj së paku dhjetë mbledhje brenda vitit fiskal. Atë e thirr dhe e kryeson Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, por nëse Këshilltarët e shohin të arsyeshme, kanë të drejtë të thirrin mbledhjen edhe nëse Kryesuesi i Kuvendit të Komunës nuk e thërret. Për mbledhjen

e Kuvendit Komunal, Këshilltarët e Kuvendit duhet të njoftohen së paku shtatë ditë pune para mbajtjes ose ekskluzivisht tri ditë pune më herët në raste urgjente, duke caktuar datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe rendin e ditës të asaj mbledhjeje. Në të njëjtën kohë bëhen edhe njoftimet publike. Pesë nga seancat e Kuvendit të Komunës në Republikën e Kosovës duhet të mbahen në gjashtë muajt e parë të vitit. Në të gjitha këto mbledhje, lejohet pjesëmarrja e publikut, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shtypit. Çdo personi i lejohet të ketë qasje në dokumentet e Komunës që janë në dispozicion.

Kuvendi Komunal dhe Komitetet e tij e kanë të drejtën të vendosin për punën e tyre të jetë publike apo e mbyllur. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe Komiteteve të tij përbëhet nga gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje me të drejtë pjesëmarrje e votimi. Këshilltarët e Kuvendit Komunal dhe anëtarët e komiteteve, kanë vetëm një votë, por kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi. Kuvendi Komunal dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç ndonjë rasti kur është paraparë ndryshe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës.

Mbledhjen e Kuvendit, në Komunat e Kosovës Lindore e thërret Kryetari i Kuvendit, sipas nevojës më së paku një herë në tre muaj. Por, nëse këtë nuk e bënë ai, atëherë, mbledhja mund të thirret edhe nga personi i autorizuar, sipas rregullave që parasheh Statuti i Komunës. Ato janë publike dhe në to mund të marrin pjesë si qytetarët ashtu edhe mediet informative. Kuvendi e ka të drejtën për të vendosur për karakterin mbledhjes. Do të thotë ata vendosin si të punohet: në mënyrë të hapur apo të mbyllur. Mirëpo, gjithnjë duhet të kenë kujdes, ngase puna e tyre duhet të jetë transparente, andaj, mbledhjet do të ishin të mbyllura për publikun, nëse për to ekzistojnë arsyet e sigurisë.

Në Maqedoni, Mbledhjen e parë të Këshillit e thërret Kryetari i mëparshëm i Këshillit të Komunës që i ka skaduar mandati, më së voni 20 ditë nga dita e zgjedhjeve. Nëse këtë nuk e bën Kryetari i mëparshëm në këtë afat kohor, atëherë,

anëtarët e posazgjedhur me vetiniciativë, mund ta thërrasin këtë mbledhje dhe atë, ta kryesojë anëtari më i moshuar.

Mbledhja konstituive, mund të mbahet në afat prej dhjetë ditësh nga kalimi i afatit të paraparë prej njëzet ditëve. Nëse nuk mbahet mbledhja e parë e Këshillit edhe në këtë afat, atëherë shpallen zgjedhje të reja. Mbledhjet e Këshillit, janë publike. Për përjashtimin e pjesëmarrjes së publikut në mbledhje vendoset me shumicë votash të anëtarëve të Këshillit të Komunës. Në shqyrtimin e buxhetit të Komunës dhe llogarisë përfundimtare vjetore, publiku nuk mund të përjashtohet nga mbledhja. Dita e mbajtjes së mbledhjeve të Këshillit të Komunës është e obliguar të publikohet së paku shtatë ditë para mbajtjes. Mbledhjet e Këshillit thirren sipas nevojës një herë në tre muaj. Ato i thirr Kryetari i Këshillit. Thirrjet e mbledhjeve bëhen me vetiniciativë të Kryetarit të Këshillit, me kërkesë të Kryetarit të Komunës ose me kërkesë të një të katërtës të anëtarëve të Këshillit. Nëse Kryetari i Këshillit, nuk e thërret mbledhjen e Këshillit pasi atë ta kërkojë numri i caktuar i anëtarëve të Këshillit, atëherë ata (anëtarët e Këshillit të Komunës) do ta thirrin mbledhjen dhe për atë ditë do ta caktojnë kryesuesin. Këshilli i Komunës i kryen punët e përcaktuara në kompetencë të tij, bazuar në Ligjin që rregullon Qeverisjen Vendore si dhe punët tjera të përcaktuara si kompetencë e Këshillit me ligje të veçanta, të cilët më për së afërmi i rregullojnë sferat në të cilat komuna ka kompetenca. Këshilli i Komunës vendos me shumicë votash. Votimi në seanca të Këshillit është publik. Mirëpo, Këshilli e ka të drejtën për të vendosur që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë. Kjo mund të bëhet për çështje të caktuara. Kur është fjala për Dispozitat që i përkasin kulturës, përdorimit të gjuhëve dhe të shkrimeve nëpër komuna, kur atë gjuhë e flasin më pak se 20% e qytetarëve në Komunë; për përcaktimin dhe përdorimin e stemës dhe flamurit të Komunës, vendimet miratohen me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit. Në këtë votim, patjetër duhet të ketë shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit të cilët i përkasin bashkësisë që nuk është shumicë e popullatës në komunë. Këshilli mund të fillojë me punë nëse në të janë të pranishëm shumica e anëtarëve të

përgjithshëm. Edhe në Komunat e Republikës së Maqedonisë, është paraparë të mbahen së paku katër seanca brenda vitit. Vendimet merren me vota të shumicës. Në mbledhjet e Këshillit mbahet procesverbal.

Në Mal të Zi, Kuvendin e thërret Kryetari i Kuvendit sipas nevojës, së paku një herë në tre muaj. Mbledhjen mund ta thërras me vetiniciativë, me kërkesë të Kryetarit, të një të tretës së këshilltarëve dhe me iniciativë të qytetarëve. Nëse Kuvendin nuk e thërret Kryetari pasi të jetë ngritur iniciativa, atëherë atë e thirr kërkuesi, përkatësisht iniciativa. Në këtë rast, me Kuvendin do të udhëheq ai këshilltar që do të caktohet nga kërkuesit apo iniciativa.

1.9. Thirrja e mbledhjes së jashtëzakonshme e Këshillit

Seancën e jashtëzakonshme e thërret Kryetari (kryesuesi) i Këshillit me nismë të vet, me propozim të së paku një të tretës e anëtarëve ose me propozim të Kryetarit të Komunës. Thirrja e seancës ka ditën e caktuar si dhe orën dhe vendin e mbajtjes. Po ashtu ka rendin e ditës të propozuar. Me këtë përmbajtje, thirrja u dërgohet anëtarëve të Këshillit në mënyrën më të shpejtë. Para fillimit të punës anëtarët e Kuvendit (Këshillit) votojnë për arsyeshmërinë e shkaqeve për thirrjen e seancës pa diskutim material. Kuvendi (Këshilli) nuk mund ta ndërrojë rendin e ditës të mbledhjes së jashtëzakonshme. Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit (Këshillit) thirret për çështje të rëndësishme për sigurimin dhe mbrojtjen e qytetarëve, për çështje që janë krijuar nga rrethanat e jashtëzakonshme (zjarri, vërshimet, tërmetet etj.) dhe gjatë vizitës së delegacioneve të vendeve të tjera kur ai delegacion duhet t'u drejtohet anëtarëve të Kuvendit (Këshillit).

1.10. Procesverbali për mbledhjet e Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal (në të katër vendet) dhe komitetet e tij në të gjitha mbledhjet mbajnë procesverbal. "*Procesverbali duhet të përmbajë emrat e këshilltarëve të pranishëm dhe anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit, dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara*"[40]. Vlen të theksohet që në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, vetëm përmendet që procesverbali duhet të mbahet në përputhje me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve. Por, bazuar në Ligjet që rregullojnë Qeverisjen Vendore në Maqedoni, Mal të Zi e në Kosovën Lindore, si dhe me Rregulloren e mëparshme të UNMIK-ut, është e obligueshme që në procesverbal të shënohet edhe mënyra e votimit e çdo anëtari, nëse thirren me emra për të votuar. Procesverbalin e mban një shërbyes civil komunal që e cakton shefi i departamentit të administratës dhe personelit dhe ai procesverbal, miratohet në mbledhjen e ardhshme. Çdokush ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe të marrë një kopje. Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi i Kuvendit.

1.11. Vendimmarrja e Kuvendit (Këshillit) të Komunës

Komunat e Kosovës, për çështje të caktuara të interesit të përgjithshëm të banorëve lokal kanë të drejtën e vendimmarrjes. Në suaza të kompetencave të dhëna me Ligjin për vetëqeverisje Lokale, në momente konkrete vendosin për çështjet më të rëndësishme të Komunës. Vendimmarrja është njëra nga përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës e që ka të bëjë me definimin dhe përcaktimin e çështjeve që duhet zgjidhur, propozimet dhe vendimet si dhe shqyrtimin dhe nxjerrjen e dispozitave dhe masave. Në çdo kohë Kuvendi i Komunës në Kosovë mund të autorizojë Kryetarin e Komunës ose ndonjë komitet të Kuvendit Komunal që të marrin vendime, por në të njëjtën kohë mban të drejtën e revokimit të autorizimit në çdo kohë.

---

[40] UNMIK/ REG/2007/30, Rregullore Nr. 2007/30, 16 Tetor 2007, Për Ndryshimin e Rregullores 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, neni 16, alineja 1, paragrafi 2

Në Maqedoni, meqë, Këshilli (Kuvendi) është organ përfaqësuesish i qytetarëve, vendos në bazë të kompetencave të Këshillit të Komunës. Ndër vendimet që merr Këshilli Komunal në Maqedoni janë edhe:Vendimi për dhënien e lejeve për veprimtaritë që janë të interesit lokal; vendimi për mënyrën e shfrytëzimit të pasurisë së Komunës si dhe vendimi për mënyrën e kontrollit financiar të buxhetit komunal. Për shqyrtimin e çështjeve të sferave të caktuara, Këshilli mund të formojë komisione të përhershme dhe të përkohshme. *"Përbërja e komisioneve të tilla formohet nga një proporcionalitet i partive që marrin pjesë në Këshill dhe mund të rregullohet sipas statutit të Komunës*[41]*"*.

Në Malin e Zi, dhe në Kosovë Lindore, Kuvendi i Komunës, vendos për iniciativat qytetare. Vendos për shpalljen e vetëkontributit për territorin e Komunës. Vendos për dhënie me qira ose për dhënie të garancisë të pasurisë së Komunës. Vendos edhe për të drejtat e këshilltarëve.

1.12. Kompetencat e Kuvendit të Komunës

Kompetencë e Kuvendit Komunal në Kosovë, ndër të tjera është: të miratojë statutin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit. Merr vendime si dhe nxjerr rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme. Miraton buxhetin. Krijon komitetet e duhura. Miraton çështjet e tjera financiare; zgjedh kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe nënkryetarët; merret me kompensimet për këshilltarët e Kuvendit Komunal; emëron shefin e departamentit të administratës dhe personelit; cakton lartësinë e tarifave dhe ngarkesave. Me miratimin e dy të tretave të votave të Këshilltarëve të Kuvendit bën emërtimin apo riemërtimin e çfarëdo rrugice, rruge apo vendi tjetër publik në territorin e Komunës.

Në Komunat e Kosovës Lindore, Kuvendi nxjerr: statutin e Komunës dhe rregulloren e punës së Kuvendit. Miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare vjetore. Nxjerr programe

---

[41] Zakon Za Lokalnata Samouprava ("Sluzben Vesnik na Republika Makedonija" br. 5 od 29 januari 2002 god.) neni 32, alineja 4

zhvillimore të Komunës, planin urbanistik dhe rregullon shfrytëzimin e tokës ndërtimore; nxjerr rregulloret dhe aktet tjera të përgjithshme. Shpall referendumin për tërë territorin e Komunës ose të një pjese të saj. U përgjigjet iniciativës qytetare dhe përcakton propozimvendimin mbi vetëkontributin. Themelon shërbime, Organizata publike për Komunali, institucione dhe Organizata tjera si dhe mbikëqyr punën e tyre. Emëron dhe shkarkon Këshillin Drejtues dhe mbikëqyrës, cakton dhe largon drejtorët e Organizatave publike për Komunali ku është themelues. Zgjedh Kryetarin dhe nënkryetarin e Kuvendit si dhe me propozim të Prefektit, zgjedh Këshillin Komunal. Emëron dhe shkarkon sekretarin e Kuvendit. Emëron dhe shkarkon kryeshefin e administratës Komunale, përkatësisht kryeshefat e administratës, me propozim të prefektit. Përcakton taksat Komunale dhe të ardhurat tjera lokale. Përcakton lartësinë e kompensimit për shfrytëzimin e tokës ndërtimore. Nxjerr aktin e borxhit publik të Komunës. Rregullon orarin e punës veprimtarive hotelierike, tregtare dhe zejtare. "*Jep mendim për planin hapësinor të Republikës, Krahinës dhe Regjionit*"[42]. Jep mendim për ligjet që kanë të bëjnë për Qeverisjen Vendore. Nis procedurën për të mbrojtur të drejtat e Qeverisjes Vendore në Gjyqin Kushtetues. Jep pëlqimin për përdorimin e emrit, stemës dhe simboleve tjera të Komunës. Mund të shpall referendum për ndonjë çështje që ka të bëjë me interesin e përgjithshëm të Komunës. Kuvendi mund të themelojë edhe Këshillin për zhvillim dhe siguri të Qeverisjes Vendore. Anëtarët e këtij Këshilli, zgjidhen nga qytetarët dhe profesionistët nga sferat e ndryshme.

Kuvendi themelon trupa punuese të përhershme dhe të përkohshme për të shqyrtuar çështjet që u përkasin kompetencave të veta. Këto trupa punues japin mendim mbi propozimet e akteve të nxjerra dhe vendimeve që merr Kuvendi Komunal si dhe kryen të tjera punë që u caktohen.

Këshilli i Komunës në Maqedoni, nxjerr statutin dhe dispozitat e tjera; nxjerr akte të përgjithshme, akte të veçanta, aktvendime për zgjedhje dhe emërime; Organizon, mënyrën e

[42] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Republike Srbije, neni 30, alineja 16

ushtrimit të detyrave të administratës komunale; nxjerr dhe aprovon buxhetin dhe llogarinë përfundimtare; përcakton lartësinë e burimeve të veta të të ardhurave për financimin e Komunës; themelon shërbyes publik në nivel komunal dhe mbikëqyr punën e tyre; emëron anëtarët e bordeve drejtues të atyre shërbyesve publik; miraton programet dhe planet financiare për financimin e shërbyesve publik që themelon Komuna. Miraton raportet për ekzekutimin e buxhetit; miraton raportet dhe llogaritë përfundimtare të shërbyesve publik që është themelues; *"Zgjedh personin i cili do të udhëheq me njësinë territoriale të Ministrisë së Punëve të Brendshme në komunë, në përputhje me ligjin*[43]*"*. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor për sigurinë publike në territorin e Komunës dhe e përcjell te ministri i punëve të brendshme dhe avokati i popullit. Mund t'i jap rekomandime udhëheqësit të njësisë territoriale të Ministrisë së Punëve të Brendshme në sferën e sigurisë publike në komunikacion.

Këshilli i Komunës shpall konkurs për stemë dhe flamur[44] të Komunës si dhe cakton Komisionin i cili ka kompetencë të përcaktohet për një propozim. Pasi t'i vijë propozimi nga Komisioni përkatës, Këshilli i Komunës me shumicë votash e miraton propozimin e arritur. Ky vendim i Këshillit të Komunës është pjesë përbërëse e statutit të Komunës.

Është në kompetencë të Këshillit të Komunës të shqyrtojë propozimin e buxhetit të Komunës dhe të marrë vendim për ndryshimin ose të mosndryshimit të të hyrave dhe të shpenzimeve të parapara në buxhet. Kur e bën këtë, atëherë merr vendim për miratimin ose jo të buxhetit në fjalë. Të gjitha aktet nxirren me shumicë votash. Ato akte të përgjithshme që kërkojnë mjete financiare për t'u realizuar duhet të mbajnë me vete edhe burimet e mjeteve nga do të sigurohen. Kompetencë e Këshillit të Komunës, është që të lejojë përdorimin e simboleve

---

[43] Zakon Za Lokalnata Samouprava ("Sluzben Vesnik na Republika Makedonija" br. 5 od 29 januari 2002 god.): neni 36, alineja 12

[44] Këtë kompetencë e kanë edhe Kuvendet Komunale në Kosovë, Kosovë Lindore dhe Mal të Zi. (shënim i autorit)

të Komunës edhe jashtë ndërtesës së Komunës, kur kërkohet nevoja e përdorimit të tyre.

Kuvendi i Komunës në Malin e Zi, nxjerr statutin, rregulloret dhe aktet tjera të përgjithshme. Jep shpjegimin autentik të rregulloreve që nxjerr. Paraqet planet dhe programet zhvillimore të Komunës që kanë të bëjnë edhe më planet urbanistike hapësinore dhe programin e rregullimit dhe shfrytëzimit të tokës ndërtimore. Aprovon buxhetin dhe llogarinë përfundimtare vjetore. Nxjerr planin e rëndësisë dhe politikës investuese. Cakton shumën e tatimit Komunal, taksave dhe kompensimit. Shpall zgjedhjet për prefekt të Komunës. Shpall referendum në territorin e Komunës ose për një pjesë të territorit të saj. Themelon shërbime publike. Vendos për të drejtat e këshilltarëve. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Kuvendit, emëron sekretarin dhe anëtarët e organeve punuese dhe këshilldhënëse. *"Jep mendim për ligjet, dispozitat dhe aktet tjera të përgjithshme të organeve republikane, me të cilat rregullohen çështjet me rëndësi për Komunën"*[45]. Me këtë nënkuptohet që Kuvendi i Komunës në Mal të Zi, jep propozim për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë të akteve të pushtetit qendror, kur vlerëson se është shkelur e drejta apo janë shkelur të drejtat e vetadministrimit lokal. Shqyrton raportet e Prefektit të Komunës. Sjell konkluzionet për çështje që kanë të bëjnë me përcaktimin dhe udhëheqjen e politikës.

Kuvendi Komunal e ka të drejtën e hapjes së procedurës para Gjyqit Kushtetues për rishikimin e ligjshmërisë dhe të Kushtetutshmërisë të ndonjë akti. Por, mund të nxjerr edhe akte të tjera që u përkasin kompetencave të veta.

1.13. Përgjegjësitë e Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal në Kosovë, mban përgjegjësi për vendimet që merr me shumicë votash të këshilltarëve të Kuvendit Komunal. Këto vendime kanë të bëjnë me miratimin e buxhetit. Miratimin e çështjeve financiare. Kompensimin për anëtarët e zgjedhur. Raportin vjetor. Miratimin, ndryshimin

[45] Statut opstine Ulcinj, "Sl. List RCG" br 23/95, neni 39, alineja 17

dhe anulimin e ligjeve lokale. Krijimin e komiteteve që kërkohen me Ligjin që ka të bëjë me Qeverisjen Vendore. Mban përgjegjësi edhe për zgjedhjen kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Për nivelin e pagesave dhe çmimeve. Për krijimin dhe përdorimin i simboleve, dekorimeve dhe titujve të nderit. Për emërtimin dhe riemërtimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike për planifikimin dhe marrëveshjet me Komunat tjera ose të asociacioneve e Organizatave tjera për bashkëpunim. Çdo nismë e qytetarëve që ka të bëjë me kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit Komunal, duhet ta shqyrtojë dhe t'i kthejë përgjigje qytetarëve. Përgjegjësi e Kuvendit Komunal është të sigurojë baraspeshë gjinore në të gjitha komitetet që krijon.

Kuvendi Komunal në Kosovën Lindore, është përgjegjës për krijimin e kushteve për kryerjen e të gjitha punëve që bien në kompetencat e veta. Kujdeset për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit dhe vendos për pjesëmarrjen apo jo të shumicës së këshilltarëve në mbledhje të Kuvendit. Është përgjegjëse për implementimin e rezultatit të Referendumit të organizuar në atë Komunë.

Këshilli i Komunës në Maqedoni, rregullon kryerjen e kompetencave të Komunës me anë të dispozitave, të cilat hyjnë në kuadër të akteve të përgjithshme. Është përgjegjësi e Këshillit të Komunës, të vendos për përdorimin e gjuhës së qytetarëve që nuk e përbëjnë 20% e popullatës të asaj komune. "*Dispozitat që i përkasin kulturës, përdorimit të gjuhëve dhe të shkrimeve në të cilat flasin më pak 20% e qytetarëve në Komunë, përcaktimi dhe përdorimi i stemës dhe flamurit të Komunës miratohen me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit, gjatë së cilës patjetër të ketë shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të Këshillit të cilët i përkasin bashkësisë që nuk është shumicë e popullatës në komunë*"[46]. Është pra, Këshilli Komunal përgjegjës që t'i kryej këto obligime që ia ngarkon statuti i Komunës si dhe Ligji për Qeverisje Vendore i Republikës së Maqedonisë. Në përgjegjësi të Këshillit të Komunës është miratimi i raportit vjetor për realizimin e të drejtës për qasje të lirë deri te informatat në

[46] Statuti i KK Tetovë, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 55/04, neni 23, alineja 3

Komunë për të gjitha veprimtaritë, përfshirë edhe zbatimin e buxhetit për vitin e kaluar. Për shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë për shërbime më të mira, Këshilli i Komunës, mban përgjegjësinë e themelimit të një Këshilli që do të mbronte konsumatorin.

Në Malin e Zi, Për të gjitha detyrat që hyjnë nën kompetencat e Kuvendit jep llogari dhe është përgjegjëse për krijimin e kushteve të duhura që ato detyra që i ngarkohen t'i kryej me një funksionalitet dhe efektivitet. Pasuria e Komunës është nën përgjegjësinë e Kuvendit, ngase ky organ e ka në dispozicion atë. Përcakton kushtet për themelimin e bashkësive lokale dhe jep pëlqimin edhe për vendimin e themelimit. Kuvendi merr përgjegjësi kur vendos për shumicën e të pranishmëve në mbledhje nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve. Është përgjegjëse edhe për vendimet e nxjerra nga shumica e votave e këshilltarëve të pranishëm, do të thotë që për to jep llogari para këshilltarëve dhe opinionit të gjerë.

1.14. Kryetari i Kuvendit Komunal

Kryetari i Komunës në Komunat e Kosovës, me Rregulloren 2007/30, njëkohësisht ishte edhe kryesues i Kuvendit të Komunës. Tani, me Ligjin që rregullon Qeverisjen Vendore, kryesuesi zgjedhet nga radhët e këshilltarëve. Ai thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit Komunal.

Në Kosovën Lindore, Kuvendi Komunal ka Kryetarin e vet. Kryetari i Kuvendit Organizon punën e Kuvendit Komunal. Thërret dhe kryeson mbledhjet dhe kryen edhe punë të tjera të përcaktuara sipas kompetencave që i jepen. Puna e tij është vullnetare, (por kjo nuk do të thotë që punon pa pagesë).

Kryetari i Kuvendit zgjidhet nga radhët e këshilltarëve, me mandat prej katër vjetësh, me votim të fshehtë. Për të duhet të votojnë shumica e këshilltarëve nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve të Kuvendit Komunal. Kryetari i Kuvendit Komunal, mund të ushtrojë edhe detyrën e kryetarit të Komunës, kur atij i humbin aftësitë vepruese, shkarkohet me iniciativë të qytetarëve ose jep dorëheqje. Këtë detyrë e kryen derisa të zgjidhet kryetari i ri i Komunës. Ai mund të

shkarkohet para kohe në të njëjtën mënyrë si edhe është zgjedhur. Kryetari i Kuvendit ka zëvendësin i cili e zëvendëson në rast të mungesës ose ndonjë pengese tjetër që nuk i mundëson kryerjen e detyrave të veta. Edhe zëvendëskryetari zgjidhet në të njëjtën mënyrë si Kryetari.

Kryetari i Këshillit të Komunës në Republikën e Maqedonisë, zgjidhet nga radha e anëtarëve të Këshillit, me mandat prej katër vjetësh. Personi që merr shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, zgjidhet Kryetar. Procedura e zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit të Komunës është që të propozohet një ose më tepër kandidatë. Nëse në rrethin e parë të votimeve nuk fiton asnjëri nga ta, vazhdon me raundin e dytë të votimeve, nëse edhe kësaj here nuk fiton asnjëri, do të thotë nuk e ka dy të tretën e votave të anëtarëve të Këshillit, atëherë shkohet në raundin e tretë. Në këtë raund, zgjidhet personi që merr më së tepërmi vota, pa marrë parasysh se ka fituar apo jo dy të tretat e votave të anëtarëve të Këshillit të Komunës. Votimi është publik, por me vendim të Këshillit, i cili po ashtu merret me shumicë votash, votimi mund të jetë edhe i fshehtë.

Propozimin për Kryetar mund ta jep Komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërime si dhe secili anëtar i Këshillit. Procedura me votim të fshehtë rregullohet me rregullore të punës së Këshillit të Komunës. Kryetari i Këshillit thërret dhe udhëheq seancat e Këshillit të Komunës, kujdeset për organizimin dhe punën e Këshillit dhe i nënshkruan aktet që miratohen nga Këshilli e në afat prej tri ditësh nga dita e miratimit të tyre ia dorëzon Kryetarit të Komunës për t'i shpallur.

Kuvendi i Komunës në Mal të Zi, po ashtu, ka Kryetarin. Kryetarin e Kuvendit e zgjedh me propozim të një të tretës së këshilltarëve nga radhët e këshilltarëve shumicë. Mandati i Kryetarit të Kuvendit zgjat aq sa zgjat mandati i Kuvendit. Funksioni i Kryetarit është në bazë vullnetare, por, "*Kuvendi mund të vendos që Kryetari ta kryej punën në mënyrë profesionale*"[47].

---

[47] Nacrt Statuta Opstine Ulcinj, "Sl. List RCG" br 42/03, 28/04, 75/05, 13/06, neni 70, paragrafi 2

Kryetari i Kuvendit mund të shkarkohet para skadimit të mandatit në përputhje me statutin e Komunës. Kryetari i Kuvendit thërret Kuvendin, udhëheq punën e Kuvendit dhe përpiqet për realizimin e vendimeve të tyre dhe akteve të tjera. Në rast të mungesës së Kryetarit, punën e Kuvendit e udhëheq këshilltari që caktohet nga Kryetari i Kuvendit.

1.15. Nënkryetari përkatësisht Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal si në Kosovë, ashtu edhe në Kosovën Lindore, në Maqedoni e Mal të Zi, ka edhe nënkryetarin ose zëvendëskryesuesin për Komunitete në Kosovë, të cilin e zgjedh nga këshilltarët e Kuvendit për ta ndihmuar Kryetarin në punën e tij. Në tri vendet tjera, procedura e zgjedhjes është e njëjtë si zgjedhja e Kryetarit, ndërkaq në Kosovë, zakonisht, postin e zëvendëskryesuesit ia rezervojnë një përfaqësuesi të komunitetit pakicë që përfaqësohet ose jo në Kuvend, nëse në atë Komunë jeton një pjesë dërmuese e komuniteteve. Zëvendëskryetsuesi i kryen detyrat në pajtim me statutin dhe rregullat e procedurës. I përgjigjet Kryetarit, por në rastet kur e kryen detyrën në mungesë të Kryetarit, atëherë i përgjigjet Kuvendit Komunal.

1.16. Sekretari i Kuvendit Komunal

Kuvendi i Komunës në Kosovë, nuk e ka paraparë postin e sekretarit të Komunës. Këtë funksion e kryen shefi i departamentit të administratës dhe personelit. Kuvendi i Komunës në Kosovë Lindore, ka sekretarin i cili kujdeset për kryerjen e punëve profesionale të thirrjes dhe mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit dhe të trupave punues dhe udhëheq me punët administrative që kanë të bëjnë me to. Sekretari i Kuvendit emërohet me propozim të Kryetarit të Kuvendit, në afat prej katër vjetësh dhe mund të emërohet përsëri. "*Për sekretar të Kuvendit Komunal emërohet personi i cili ka të kryer fakultetin (juridik), ka dhënë provimin profesional për punë në*

organet e administratës dhe ka përvojë punë së paku tri vjet"[48]. Kuvendi mund ta shkarkojë atë, para kohe me propozim të Kryetarit të Kuvendit.

Edhe në Mal të Zi, Kuvendi i Komunës, mund të ketë sekretarin i cili angazhohet për kryerjen e punëve profesionale si dhe punëve të tjera që kanë të bëjnë me thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit si dhe të organeve të tjera Komunale. Kryen edhe punë të përcaktuara me statut dhe akte të tjera. Sekretarin e emëron Kuvendi me propozim të Kryetarit të Kuvendit. Mandati i sekretarit të Kuvendit zgjat sa edhe mandati i Kryetarit të Kuvendit.

1.17. Komitetet e Kuvendit Komunal në Kosovë[49]

Dy janë komitete të përhershme që krijohen nga Kuvendi Komunal në Kosovë. Këta janë:

- Komiteti për politikë dhe financa; dhe
- Komiteti për komunitete;

Sipas nevojës, mund të krijohen edhe Komitete tjera, të cilave u caktohen kompetencat dhe veprimtaritë e tyre. Komitetet e krijuara mund të kenë në radhët e tyre individë tjerë, por shumica e anëtarëve të Komiteteve duhet të jenë gjithmonë këshilltarë të Kuvendit Komunal.

Gjatë caktimit të anëtarëve të Komiteteve, gjithmonë duhet të kenë parasysh faktin që, ato komitete të përfaqësohen proporcionalisht nga të gjitha partitë që kanë siguruar ulëse në Kuvend. Kryesuesi i Komitetit ose zëvendëskryesuesi zgjidhen nga anëtarët e Komitetit në fjalë. Mbledhjet thirren nga kryesuesi ose nga një e treta e anëtarëve të tij.

Komiteti për politikë dhe financa ka kompetencë të merret me politikën që udhëhiqet në Komunë, si dhe merret me zgjedhjen e kuadrove udhëheqëse në Komunë, që do të përcaktonin drejtimin strategjik të Komunës. Komiteti për komunitete themelohet si i përhershëm. Më parë sipas

---

[48] Statut Opstine Bujanovac, maj 2002 god. neni 35, paragrafi 3

[49] Shih: United nations – Unmik, Rregullore 2000/45, 11 gusht 2000, neni 21 dhe neni 21,alineja 1

Rregullores 2007/30, ishte paraparë të themelohej edhe Komiteti për ndërmjetësim, i cili i paraqiste Kuvendit Komunal raport brenda 28 ditësh nga marrja e ndonjë vendimi duke i dhënë rekomandime për shqyrtimin e asaj çështjeje. Pasi dorëzonte raportin priste që Kuvendi që t'i përgjigjej për atë çështje. Tani me Ligjin e miratuar për Qeverisje Vendore, nuk është paraparë një Komitet i tillë si i përhershëm.

Për një efikasitet më të lartë të punës si dhe racionalitet të kryerjes së detyrave që i ngarkohen në kompetencat e Kuvendit, bëhen bordet dhe Këshillat, si organe punuese të përhershme, por mund të formohen edhe Komisione të përkohshme si organe punuese.

Për anëtarë të bordit të Kuvendit emërohen këshilltarët e Kuvendit dhe persona të tjerë.

Me statut dhe vendim të Kuvendit, bordeve mund t'u besohen vendimet për disa veprimtari nga kompetencat e Kuvendit. Vendimet që merren nga këto borde, paraqiten në mbledhjen e radhës të Kuvendit dhe nëse ato nuk janë në përputhje me ligjin anulohen dhe me vendim rregullohet çështja në fjalë.

1.18. Këshilli për Marrëdhënie Ndërnacionale

Në Komunat e Kosovës Lindore, parashihet edhe themelimi i Këshillit për marrëdhënie ndërnacionale. Ky Këshill themelohet në mjediset e përziera me pakica të ndryshme dhe e përbëjnë pjesëtarë të të gjitha nacionaliteteve që jetojnë në atë mjedis. Mjedise të përziera konsiderohen ato Komuna ku një bashkësi etnike përbën më shumë se 5% të popullatës së Komunës ose të gjitha bashkësitë tejkalojnë 10% e popullatës së Komunës. Në këtë Këshill kanë të drejtën e përfaqësimit edhe ato bashkësi që kanë më tepër se 1% të popullatës. Këshilli ka për detyrë të realizojë, mbrojë dhe avancojë barabarësinë nacionale. Ky Këshill njofton Kuvendin Komunal për vendimet dhe sugjerimet e veta. Ndërkaq Kuvendi Komunal obligohet që për ato çështje të vendos në mbledhjen e ardhshme, më së voni 30 ditë nga marrja e sugjerimit ose propozim-vendimit të Këshillit. Këshilli ka të drejtën e dhënies së mendimit për

çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërnacionale. Po ashtu ka të drejtën e nisjes së procedurës ose ankesës para Gjyqit Kushtetues për të vërtetuar përputhshmërinë dhe ligjshmërinë e ndonjë akti të nxjerrë nga Kuvendi Komunal e që ka të bëjë për marrëdhëniet ndërnacionale, nëse dyshohet që janë shkelur të drejtat e ndonjë etnie ose të ndonjë përfaqësuesi të këtij Këshilli.

1.19. Komisionet e Këshillit të Komunës në Maqedoni[50]

Organizimi dhe puna e Këshillit të Komunës bëhet nëpërmjet komisioneve të Komunës. Për shqyrtimin e çështjeve në kompetencë të vet, Këshilli formon komisione.

Këto Komisione mund të jenë të përhershme dhe të përkohshme. Me vendimin për formimin e komisioneve të tilla, përcaktohet edhe fushëveprimi i punës së tyre. Mandati i Komisioneve të themeluara nga Këshilli i Komunës, zgjat aq sa zgjat edhe mandati i anëtarëve të Këshillit. Komisionet e përhershme janë: Komisioni statutar - juridik; Komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërime; Komisioni për financim dhe buxhet; Komisioni për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor; Komisioni për veprimtari komunale; Komisioni për veprimtari publike; Komisioni për dhurata dhe mirënjohje dhe Komisioni për barabarësi gjinore.

1.20. Përbërja, zgjedhja dhe mënyra e punës në Komisione

Komisionet përbëhen prej 5 anëtarëve, edhe atë anëtarë të brendshëm të Këshillit dhe anëtarë të jashtëm profesionistë të dëshmuar në lëmin për të cilën formohet Komisioni. Kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve i zgjedh Këshilli i Komunës me propozim të Komisionit për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërime.

---

50 Shih: Zakon Za Lokalnata samouprava ("Sluzben vesnik na Republika Makedonija" od 29 januari 2002 god.) neni: 55, dhe Statuti i KK Tetovë, dokument i cituar, neni 27

Propozimi për zgjedhje përmban aq kandidatë sa zgjidhen anëtarë të trupave punues. Partitë politike që marrin pjesë në Këshillin e Komunës përfaqësohen proporcionalisht me numrin e përgjithshëm të anëtarëve të të gjitha Komisioneve. Mënyra e punës së komisioneve më afër rregullohet me Rregulloren e punës të Këshillit të Komunës.

1.21. Kompetencat e Komisioneve

Komisionet e Këshillit të Komunës, kanë kompetenca të diskutojnë për çështje nga lëmi për të cilën janë formuar; japin mendime dhe propozime për Këshillin; i shqyrtojnë dhe marrin qëndrim për propozimet e Kryetarit të Komunës, anëtarëve të Këshillit të Komunës dhe për iniciativat e qytetarëve, për sferat për të cilat janë formuar.

Komisioni statutar - juridik përcakton propozimin e Statutit të Komunës, shqyrton nismat dhe propozimet për ndryshimin e Statutit, përcjell zbatimin e tij dhe i shqyrton çështjet parimore me karakter Statutar. Pastaj, përcakton propozimin e Rregullores së punës të Këshillit, përgatit propozim-vendime, përgatit përgjigje dhe jep mendime për propozimet që i përkasin Komunës si dhe shqyrton edhe akte të tjera të përgjithshme në kompetencë të Këshillit të Komunës.

1.22. Komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërime

Ky Komision, shqyrton dhe përgatit propozime të cilat u përkasin çështjeve të mandatit dhe imunitetit, shqyrton dhe përgatit propozime për zgjedhje, emërime dhe shkarkime në kompetencë të Këshillit të Komunës, si dhe i shqyrton dhe merr qëndrime për propozimet për zgjedhje, emërime dhe shkarkime nga kompetencat e Këshillit të Komunës të propozuar nga anëtarë të Këshillit në seancë. Shqyrton propozimin për kompensimin e punës dhe të ardhurave të tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Jep propozimin për lartësinë e kompensimit të shpenzimeve për udhëtime dhe të mëditjeve të anëtarëve të Këshillit të Komunës, si dhe shpenzimeve të bëra në kryerjen e detyrave që i ka besuar Këshilli i Komunës.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit zgjedhen nga Këshilli i Komunës në seancën e tij të parë.

1.23. Komisionet e tjera

Komisioni për financim dhe buxhet i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me financat e Komunës, përpilimin e Buxhetit, llogarisë përfundimtare dhe të akteve e të veprimeve të tjera në këtë lëmi.

Komisioni për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor i shqyrton çështjet e planifikimit urbanistik, dhënien e lejeve për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale, rregullimin e hapësirës dhe tokës ndërtimore, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës. Propozon ndërmarrjen e masave të duhura për mbrojtjen dhe pengimin e ndotjes së ujit, ajrit, tokës, mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen nga zhurma dhe nga rrezatimi i rajonit.

Komisioni për veprimtari botore i shqyrton çështjet nga sfera e veprimtarive Komunale botore si dhe çështjet nga puna e shërbimeve publike, institucioneve publike dhe të ndërmarrjeve publike të Komunës.

Komisioni për veprimtari publike i shqyrton çështjet në kompetencë të Komunës të cilat i përkasin arsimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit, mbrojtjes sociale e mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes shëndetësore, sigurimit publik dhe sigurimit në komunikacion si dhe mbrojtjes kundër zjarrit

Komisioni për dhurata dhe mirënjohje shqyrton propozimet dhe i propozon Këshillit, ndarjen e dhuratave dhe të mirënjohjeve qytetarëve, organizatave dhe bashkësive që dallohen ose janë dalluar për zhvillimin e Komunës në lëmenj të caktuar. Ky propozim për dhurata dhe mirënjohje bëhet edhe si shprehje e mirënjohjes për zhvillimin e bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve miqësore me subjekte të vendit dhe të huaja.

Komisioni për barabarësi gjinore i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me barabarësinë ndërmjet gjinive në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe jep mendim, propozime dhe sugjerime për zgjidhjen e problemeve dhe zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë problematikë. Ky Komision punon në

bazë të Programit dhe rekomandimeve të seksionit për përparimin e barabarësisë gjinore të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale.

Në Malin e Zi, organet punuese janë të ndara në Komitete, Këshilla e Komisione. Anëtarët e të tyre zgjidhen nga pjesëtarët e këshilltarëve komunal si dhe nga qytetarët tjerë. *"Për anëtarë të Komiteteve të Kuvendit emërohen këshilltarët Komunal".*[51] Si rregull, i shkruar edhe në ligj, është që anëtarë të Komiteteve mund të jenë vetëm këshilltarët, ndërsa nëpër këshilla e Komisione mund të ketë edhe nga ana e të tjerëve.

1.24. Bashkësia Ndërkomunale

Kuvendet Komunale mund të themelojnë bashkësinë ndërkomunale. Këto bashkësi themelohen në marrëveshje ndërmjet Komunave.

Marrëveshja në vete përmban themeluesit, emrin dhe selinë e bashkësisë, përfaqësimin e bashkësisë, llojin, formën dhe mënyrën e kryerjes së punëve, organet e bashkësisë, mënyrën e punës dhe të vendimit, mënyrën e financimit, mënyrën e mbikëqyrjes nga ana e Komunës mbi veprimet e bashkësisë, përgjegjësinë e bashkësisë në kryerjen e punëve, punën publike, procedurën mbi daljen nga bashkësia, ndërprerjen e punës së bashkësisë, si dhe çështjet tjera që kanë rëndësi në organizimin dhe punën e bashkësisë.

2. Këshilli Komunal në Kosovën Lindore[52]

Këshilli Komunal është organi i tretë i Kuvendit të Komunës në Komunat e Kosovës Lindore dhe përbëhet nga 11 anëtarë që zgjidhen nga Kuvendi Komunal, me propozim të kryetarit të Komunës. Ky këshill zgjidhet për një afat prej katër vjetësh me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve. Nëse propozimi i kryetarit të Komunës për zgjedhjen e të njëjtit anëtar të Këshillit nuk kalon dy herë,

[51] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Crne Gore, dokument i cituar, neni 49, paragrafi 2
[52] Shih: Statut Opstine Bujanovac, maj 2002 god. neni 21, paragrafi 3

atëherë, Kuvendi Komunal mund të merr vendim për zgjedhjen e anëtarit të ri të Këshillit pa propozimin e tij.

Anëtari i Këshillit Komunal mund të shkarkohet në të njëjtën mënyrë me propozim të kryetarit të Komunës ose të një të tretës së këshilltarëve të Kuvendit Komunal.

2.1. Kompetencat e Këshillit Komunal në Kosovën Lindore

Këshilli Komunal përcakton propozim vendimet për buxhetin e Komunës. Bën mbikëqyrjen e punës së administratës Komunale. Anulon ose ndalon aktet e administratës Komunale të cilët nuk janë në përputhje me ligjin, statutin dhe akteve të përgjithshme ose me vendimin që merr Kuvendi Komunal. Vendos për procedurën administrative të shkallës së dytë për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve, ndërmarrjeve, institucioneve dhe Organizatave të tjera që janë në kompetenca Komunale. Pos tjerash, ndihmon edhe kryetarin e Komunës në kryerjen e punëve të tjera që janë nën kompetencat e tij.

III. Administrata Komunale

1. Administrata Komunale, përbërja dhe Funksioni

Në Komunat e Kosovës, shërbimin civil në Kosovë e përbëjnë të gjithë të punësuarit në ndonjë organ e që paguhen nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës. Kushtet e shërbimit civil Komunal janë të tilla, sa për të mundësuar punësimin e personelit të nivelit të lartë në bazë të meritës dhe aftësisë.

Të gjithë nëpunësit civil Komunal i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe të drejtë duke respektuar dhe duke vepruar në pajtim me kompetencat që u jepen.

Ata i zbatojnë dhe i përfillin urdhrat e eprorëve të tyre, përveç rasteve kur detyrat e dhëna janë në kundërshtim me ligjin ose me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe me të drejtat e komuniteteve.

Në të gjitha nivelet, shërbimi civil nëpër komuna të Kosovës, pasqyron në mënyrë proporcionale numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve. Kjo është paraparë edhe me ligj. Kështu në Rregulloren mbi Shërbimin Civil të Kosovës, decidivisht thuhet: *"Punësimi në të gjitha nivelet e Shërbimit civil duhet të pasqyrojë karakterin shumetnik të Kosovës dhe nevojën për përfaqësim të barabartë të të gjitha komuniteteve të Kosovës"*[53].

Prej tyre, (nëpunësve civil) kërkohet t'i paraqesin me shkrim, të gjitha konfliktet e interesave të cilat i ruan Drejtoria e administratës dhe personelit.

Shefi i departamentit të administratës dhe personelit dhe anëtari i bordit të drejtorëve, nuk mund të janë këshilltarë të Kuvendit Komunal në Komunën ku punojnë. Në përgjegjësinë e shefit të administratës është që të shqyrtojë ligjshmërinë e

[53] United nations, Rregullore Nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës, neni: 2, alineja 1, paragrafi ë

vendimit si dhe procesin administrativ me të cilin është arritur ndonjë vendim, bazuar në procedurat buxhetore me rregulloret financiare ose me rregullat e prokurimit. Bazuar në këto, ai do të njoftojë Kuvendin e Komunës dhe Kryetarin për papërshtatshmërinë dhe papërputhshmërinë e ndonjë dispozite a vendimi që është në kundërshtim me Statutin, Rregulloren e punës të Kuvendit të Komunës a Rregulloren 2007/30, që ka të bëjë me Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës.

Administrata Komunale në Kosovën Lindore, merret si njësi shërbyese. Me administratën udhëheq kryeshefi. Administrata Komunale mund të ketë edhe njësi organizative për kryerjen e punëve që kanë ngjashmëri me ato të administratës profesionale dhe punëve të tjera. Në veprimet e administratës Komunale në të cilat vendoset për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve si dhe personave juridik, ndërmerren rregullat e procedurës administrative.

Në këto Komuna, është paraparë një kryeshef i organit i cili ka për obligim të qeveris me të gjitha drejtoritë që veprojnë në Komunë. Udhëheqësit e këtyre njësive i cakton Kryeshefi. Administrata mund ta ketë edhe arkitektin, të cilin e emëron dhe e shkarkon kryetari i Komunës. Por, pos arkitektit, në administratën Komunale mund të caktohet edhe një menaxher si dhe profesionistë të tjerë që kanë të bëjnë me sigurimin dhe mbrojtjen parësore shëndetësore, mbrojtjen e mjedisit jetësor, bujqësisë etj.

Në Maqedoni, për kryerjen e punëve që u përkasin kompetencave të Komunës, organizohet administrata Komunale. Kjo administratë organizohet në sektore dhe njësi. Organizimin, veprimtarinë dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës Komunale i cakton Këshilli Komunal me propozim të Kryetarit të Komunës.

Në Maqedoni njësitë e bashkuara të administratës për kryerjen e një pjese të kompetencave mund të themelohen dhe shpërbëhen në bazë të vendimit që merr Këshilli Komunal, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Me këtë rast, duke u thirrur në këtë vendim të Këshillit Komunal, përcaktohen Komunat që do ta përbëjnë këtë bashkësi administrative, si do të kryen punët, format dhe mënyrat e

kryerjes së detyrave nga kompetencat që i takojnë, shfrytëzimi i objekteve dhe mjeteve, aktivitetet, financimi, mënyra e shpërbërjes si dhe kontrolli i të punësuarve në atë njësi administrative.

Në Mal të Zi, për kryerjen e punëve të administratës krijohen organet e administratës lokale (sekretariatet, drejtoritë, byrotë, me të cilat udhëheq kryeshefi i organit). Ndërkaq për kryerjen e punëve specifike formohet policia Komunale, shërbimet dhe qendrat e veçanta. Ato punë që kërkojnë profesionalizëm të veçantë dhe pavarësi në punë, me vendim të Kryetarit të Komunës mund të themelohen agjenci të llojeve të ndryshme që janë të nevojshme për administratën komunale e që do të jenë në shërbim të popullatës lokale. Aktin për organizimin e brendshëm të drejtorive, sekretariateve, byrove, policisë Komunale si dhe shërbimeve dhe qendrave të veçanta e nxjerr administratori, ndërkaq për agjencitë, drejtori me pëlqim të Kryetarit të Komunës. Me administratën lokale kryeson administratori kryesor. Administratori është profesional në kryerjen e punëve të veta. Ai organizon punën e administratës lokale dhe është përgjegjës për ligjshmërinë dhe efikasitetin e punës. Ka autorizime të shkallës së dytë të organit dhe objektet drejtuese. Mbikëqyr ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e punës së policisë Komunale. Për punën e vet dhe të organeve të administratës lokale i përgjigjet (i jep llogari) Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit. Ai mund të shkarkohet nëse nuk di të organizojë punën, nuk i përmbahet ligjit dhe efikasitetit të punës. Në procedurën e shkarkimit të administratorit kryesor, ka të drejtën e sqarimit të arsyes së shkarkimit.

1.1. Nëpunësit Lokal

Të punësuarit nëpër organet e administratës lokale janë nëpunës lokal që i kryejnë në mënyrë profesionale punët nga kompetencat e Qeverisjes Vendore. Atyre nuk mund t'u mohohet e drejta e anëtarësimit në ndonjë parti politike e as në ndonjë sindikatë. Kështu që ata nuk do të mund të përjashtohen nga puna për shkak të ndërmarrjes së ndonjë hapi të tillë. Të punësuarit në administratën Komunale në Maqedoni, që

kryejnë punë profesionale, juridiko-normative, ekzekutues, drejtues, mbikëqyrës dhe zgjidhin çështjet administrative kanë statusin e zyrtarit shtetëror. *"Për të punësuarit në administratën komunale të cilët kryejnë veprimtaritë ndihmëse administrativo-teknike, aplikohen dispozitat e Ligjit mbi punësimin"*[54]. Ndërkaq sa i përket të drejtave, obligimeve si dhe sistemit të pagesave të të punësuarve në administratën komunale aplikohet ligji mbi zyrtarët shtetëror. Në të gjitha këto vende, gjatë punësimit në administratën Komunale dhe në shërbimet publike ku themelues është Komuna, kihet kujdes për një përfaqësim të drejtë të qytetarëve që u përkasin të gjitha bashkësive etnike si dhe respektimi i kriterit të profesionalizmit dhe kompetencave.

1.2. Mbikëqyrja administrative

Në Komunat e Republikës së Kosovës, nga organet kompetente që delegojnë kompetencat, bëhet mbikëqyrja administrative për të pasur nën kontroll çdo akt të përgjithshëm, Rregullore a vendim që marrin Organet Komunale. Kjo bëhet për arsye të ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë të aktit të miratuar, apo vendimmarrjes së drejtë, për të mos tejkaluar kompetencat që u takojnë Komunave. Organet e administratës lokale në Kosovën Lindore, bëjnë mbikëqyrjen administrative të ligjshmërisë së akteve të shërbimeve publike, me të cilat zgjidhet apo vendoset për të drejtat, obligimet dhe interesat juridike të qytetarëve dhe personave juridik. Bëjnë mbikëqyrjen e ligjshmërisë të punës së shërbimeve publike. Inspektojnë apo kontrollojnë punën administrative e organeve të qeverisjes Vendore me qëllim që t'i propozojnë administratorit kryesor për të anuluar aktet që shkelin ligjin të mos ekzekutohen derisa të mos përputhen me ligjin. Po ashtu ndërmarrin iniciativën për vlerësimin kushtetues dhe të ligjshmërisë të akteve të përgjithshme të shërbimeve publike.

---

[54] Zakon Za Lokalnata Samouprava ("Sluzben Vesnik na Republika Makedonija" br 5 od 29 januari 2002 god.) neni: 58, alineja 3

Në Malin e Zi, Organet e administratës lokale, po ashtu, bëjnë mbikëqyrjen administrative të ligjshmërisë së akteve të shërbimeve publike, me të cilat zgjidhen apo vendoset për të drejtat, obligimet dhe interesat juridike të qytetarëve dhe personave juridik. Si e përbashkët e të gjitha këtyre vendeve është që, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e akteve të miratuara si dhe Rregulloreve Komunale dhe vendimeve që merren nga Organet Komunale e mbikëqyr dhe e kontrollon Organi që delegon këto kompetenca.

1.3. Kompetencat e Administratës Komunale

Në Republikën e Kosovës, administratën komunale e përbëjnë shërbyesit civil dhe zyrtarët që janë të punësuar në Komunë. Ato pos shërbimeve të tjera, përgatisin projekt-dispozitat si dhe ndihmojnë Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin Komunal në përgatitjen e dokumenteve të duhura. Pasi të jenë aprovuar vendimet në Kuvend Komunal ose të ketë lëshuar ndonjë udhëzim administrativ Kryetari i Komunës, shërbyesit civil duhet të zbatojnë dhe ekzekutojnë ato vendime.

Në Kosovën Lindore, Administrata Komunale: përgatit projekt-dispozitat dhe aktet e tjera që nxjerr Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës. Ekzekuton vendimet dhe aktet e Kuvendit Komunal dhe të kryetarit të Komunës. Vendos për procedurën e shkallës së parë për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve, ndërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave të tjera që bien në kompetencat e Komunës. Bën mbikëqyrjen e punëve administrative në ekzekutimin e rregullave dhe të akteve të tjera të Kuvendit Komunal. Ekzekuton ligjet që i janë besuar Komunës si dhe kryen punë profesionale të cilat i cakton Kuvendi i Komunës dhe kryetari i Komunës

Në Maqedoni, Administrata Komunale përgatit aktet për Këshillin Komunal dhe Kryetarin e Komunës. Përgatit mbledhjet e Këshillit Komunal si dhe mbledhjet e komisioneve si atyre të përhershme ashtu edhe komisioneve të përkohshme të Këshillit. Kryen punët profesionale të Këshillit Komunal dhe Kryetarit të Komunës. Mban librat llogaritarë (librin e të hyrave dhe të dalave) të Këshillit. Përcjell problematikat e sferave të

kompetencave të Komunës. Bën analiza për gjendjen dhe jep iniciativa dhe propozime për zgjidhjen e tyre. Ofron informacione dhe të dhëna për aktivitetet e Komunës me kërkesë të organeve kompetente. Disponon me dokumentet e Komunës, i ruan deri në prishjen e tyre ose deri në dorëzimin te arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë. Njëkohësisht, kryen edhe punë të tjera që e ngarkon Këshilli dhe Kryetari i Komunës. Kompetencat e Administratës Komunale në Mal të Zi kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera të përgjithshme. Bën përgatitjen e projektvendimeve dhe akteve të tjera që nxjerrin Organet e Qeverisjes Vendore. Kryen mbikëqyrjen administrative. Kryen punët profesionale dhe bën punë të tjera që ia besojnë Organet e Qeverisjes Vendore. Ndërmerr iniciativën për ndërrimin e Statutit të Komunës.

1.4. Përgjegjësitë e Administratës Komunale

Administrata Komunale në Komunat e Kosovës Lindore, mund të bëjë mbikëqyrje administrative me: mandat (vendim). Me atë rast ka të drejtën e marrjes së masave në afat të caktuar. Në përgjegjësi të saj është dënimi mandator si dhe fletëparaqitja në organin kompetent për veprën penale dhe kërkon procedurë për veprën e kundërvajtjes. Lejon ose ndalon përkohësisht ndonjë veprim. Njofton organin tjetër, nëse ka arsye për ndërmarrjen e masave të duhura për të cilat është kompetent ai organ. Merr edhe masa të tjera, për të cilat është e autorizuar.

Në Mal të Zi, është në përgjegjësi të administratës komunale të vendos për procedurat ligjore të shkallës së parë për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve, peronave juridik si dhe personave të tjerë. Udhëheq evidencat publike dhe evidencat e tjera të parapara me ligj, si dhe akteve të përgjithshme të organeve të qeverisjes Vendore. Mban të drejtën e vendimit për procedurën e kundërvajtjes. Parashtron kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, apo të fletëparaqitjeve penale dhe fletëparaqitjeve për shkeljet ekonomike. Njofton organet e tjera, nëse ekzistojnë arsyet për ndërmarrjen e masave në përputhje me kompetencat e tyre.

1.5. Kryeshefi i Administratës Komunale

Në Komunat e Kosovës, me administratën udhëheq shefi i departamentit të administratës dhe personelit dhe ai caktohet nga Kuvendi i Komunës dhe i përgjigjet Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës. Është shumë e rëndësishme që në këtë vend udhëheqës të jetë një person profesionalist dhe me përvojë të duhur pune. Në Kosovën Lindore, "*Për kryeshef të administratës, mund të caktohet personi që ka kryer fakultetin juridik, ka dhënë provimin profesional për punë në organet e administratës shtetërore dhe që ka së paku pesë vjet përvojë pune në profesion*"[55]. Ai caktohet nga Kuvendi Komunal me propozim të prefektit të Komunës. Kryeshefi i përgjigjet Kuvendit dhe prefektit të Komunës. Bën organizimin e brendshëm si dhe sistematizimin e vendeve të punës. Kryeshefi i administratës Komunale, ose kryeshefi i drejtorisë për disa sfera vendos për konfliktet e kompetencave në organizimin e brendshëm të njësive organizative. Vendos edhe për kompetencat e nëpunësve komunal.

Në Mal të Zi, nëpër Komuna, "*Me administratën lokale udhëheq dhe koordinon administratori kryesor*"[56]. Ai është profesional në kryerjen e punëve të veta. Organizon punën e administratës lokale dhe është përgjegjës për ligjshmërinë dhe efikasitetin e punës. Ka autorizime të shkallës së dytë të organit dhe objektet drejtuese. Mbikëqyr ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e punës së policisë Komunale. Për punën e vet dhe të organeve të administratës lokale, i përgjigjet (i jep llogari) Kryetarit të Komunës si dhe Kuvendit. Mund të shkarkohet nëse nuk di të organizojë punën, nuk i përmbahet ligjit dhe efikasitetit të punës. Në procedurën e shkarkimit të administratorit kryesor, ka të drejtën e sqarimit të arsyes së shkarkimit.

Me punët e organeve të administratës lokale udhëheq eprori i Organit, të cilin e emëron dhe e shkarkon administratori kryesor me pëlqim të Kryetarit të Komunës.

---

[55] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Republike Srbije, neni 50, paragrafi 2

[56] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Crne Gore, neni: 74, paragrafi 1

Është përgjegjës dhe llogari i jep administratorit kryesor dhe Kryetarit të Komunës.

Eprori i Organit vendos për zgjedhjen dhe radhitjen e nëpunësve si dhe kryen punë të tjera në përputhje me ligjin dhe statutin e Komunës.

1.6. Arkitekti kryesor dhe Kompetencat e tij në Kosovën Lindore

Në administratën Komunale të Kosovës Lindore, mund të emërohet arkitekti kryesor i cili merr nismën për përpunimin e planeve urbanistike si dhe plotësimin apo ndërrimin e tyre. Jep udhëzime gjatë renovimit a përpunimit të projekteve arkitektonike me qëllim të ruajtjes së vlerave arkitektonike dhe ruajtjes së vlerave ambientale të disa pjesëve të qytetit apo objekteve. Bashkëpunon me institucionet kulturore për ruajtjen e të mirave materiale dhe të mirave të veçanta natyrore. Jep mendim për projektet arkitektonike të karakterit të interesit të përgjithshëm dhe të rëndësisë së Komunës.

1.7. Menaxheri dhe Kompetencat në Kosovën Lindore

Ai propozon projekte të zhvillimit ekonomik për të plotësuar nevojat e banorëve lokal dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Ndërmerr iniciativë për krijimin e aranzhmaneve publike private. Koordinon investimet dhe kapitalin. Inicion ndërrimet dhe plotësimet e rregulloreve ose të akteve tjera të përgjithshme që vështirësojnë veprimtaritë nismëtare.

Edhe në Malin e Zi, Komuna mund të ketë menaxher. Ai merr pjesë në përpunimin e programeve zhvillimore. Propozon projekte në përputhje me programet zhvillimore dhe kujdeset për realizimin e tyre. Menaxherin e zgjedh dhe e shkarkon Kryetari i Komunës. Ai zgjidhet me konkurs, i jep llogari dhe një herë në vit duhet t'i raportojë prefektit.

1.8. Shërbimet e tjera të Komunës

1.8.1. Policia Komunale në Malin e Zi dhe në Kosovën Lindore

Komuna ka shërbimin e mbikëqyrjes Komunale të quajtur policia Komunale. Policia Komunale siguron rendin Komunal në sferat e: parkimit, deponimit të bërllokut, furnizimit me ujë të pijshëm, derdhjen e ujërave të zeza dhe atyre atmosferike, pastrimin dhe ndriçimin publik, mirëmbajtjen e tregut, parqeve, gjelbërimeve, shenjave të komunikacionit dhe sinjalizimit, varrimeve, rrugëve lokale, zhurmën, orarin e punës, transportin e udhëtarëve në komunikacionin urban, ndërurban dhe të auto taksive. Ofron shërbime informative qytetarëve dhe kryen edhe punë të tjera që bien në kompetencë të Komunës.

1.8.2. Shërbimi i Sigurisë në Malin e Zi

Komuna ka shërbimin e sigurisë. Shërbimi i sigurisë ka për qëllim të shpëtojë dhe të mbrojë pasuritë dhe personat nga zjarri, mjetet eksplozive, avaritë dhe aksidenteve tjera si dhe në situata të jashtëzakonshme.

1.8.3. Qendra Informative në Kosovë Lindore dhe në Malin e Zi

Organet Komunale, shërbimet publike dhe personat juridik të cilët kryejnë autorizime dhe ofrojnë shërbime qytetarëve, shërbehen me mjete më moderne të informimit dhe të komunikimit. Komuna themelon ose formon qendrën informative për t'i kryer sa më mirë këto shërbime.

PJESA E TRETË

TË DREJTAT E QYTETARËVE DHE TË DREJTAT E PAKICAVE KOMBËTARE

I. Të drejtat e Qytetarëve

Nocionin "e drejtë" në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe e gjejmë si një tërësi të normave që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore ndërmjet njerëzve në një vend të caktuar, të cilat ndërtohen sipas vullnetit, qëllimeve e interesave të sistemit në fuqi, vendoset nga shteti e mbrohet me ligj.

Meqë kuptimi i nocionit, "e drejta" ka kuptim shumë të gjerë, këtu do të bëjmë fjalë vetëm për të drejtat e qytetarëve në Qeverisjen Vendore. Duhet pasur parasysh që çdo e drejtë sanksionohet me një përgjegjësi. Andaj duke u nisur nga ky konstatim, kam gjetur se si në Kosovë e Kosovë Lindore, po ashtu edhe në Maqedoni dhe Mal të Zi, qytetarëve u jepet e drejta që të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendeve Komunale dhe të komiteteve të tyre. Në këto mbledhje, gjithashtu u lejohet pjesëmarrja edhe medieve. Çdo person mund të bëjë inspektimin e dokumenteve dhe ato janë në dispozicion për të gjithë të interesuarit. Andaj, *"Çdo person i interesuar ka të drejtë që t'i shikojë dokumentet që janë në dispozicion për opinionin"*.[57]

Inspektimi nuk do të lejohet, vetëm në raste kur konstatohet ose dyshohet se ato do të keqpërdoren dhe kur, keqpërdorimi i tyre do të mund të shkaktonte ndonjë çrregullim publik apo dhunë dhe nëse zbatimi i tyre do të rezultonte në zbulimin e informatave për ndonjë çështje të natyrës sekrete. Kjo e drejtë, po ashtu u ndalohet qytetarëve, nëse ka të bëjë me ndonjë informatë personale a komerciale, si dhe kur, informata ka të bëjë me ndonjë proces të mundshëm gjyqësor. Mbledhjet e Kuvendeve Komunale (Këshillave në

[57] Statuti i Kuvendit Komunal Mitrovicë, dokument i cituar: neni 19

Maqedoni) në të gjitha Komunat e këtyre shteteve janë publike. "*Për përjashtimin e publikut nga mbledhjet, vendoset, nëse për këtë akt, ekzistojnë arsyet të përcaktuara me statut, me dy të tretat votave të përgjithshme të anëtarëve të Këshillit*"[58]

Mirëpo, një gjë e tillë nuk mund të bëhet edhe në mbledhjen kur shqyrtohet buxheti i Komunës dhe llogaria përfundimtare. Me këtë rast, qytetarët kanë të drejtë të prezantojnë në këto mbledhje dhe nuk mund të largohen nga salla.

Realizimi i të drejtës për Qeverisje Lokale, nga ana e qytetarëve bëhet drejtpërdrejt dhe nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, në organet Komunale. Ata, kanë të drejtë të informohen në gjuhët zyrtare që përdoren në atë Komunë.

Në Kosovë, gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe dhe ajo serbe, ndërsa në ato Komuna ku ka një numër të konsiderueshëm të Komuniteteve të tjera, në përdorim është edhe gjuha e atij Komuniteti. Në Komunat e Kosovës Lindore, krahas gjuhës serbe përdoret edhe gjuha shqipe.

Në Maqedoni, si gjuhë zyrtare merren gjuha zyrtare e shtetit si dhe gjuha e qytetarëve që përbëjnë së paku 20% e popullatës, në atë Komunë. Do të thotë nëse e arrijnë këtë kuotë, atëherë ajo gjuhë zyrtarizohet dhe përdoret së bashku me gjuhën zyrtare.

Kuvendi i Komunës (në Maqedoni: Këshilli i Komunës) e ka të drejtën që me vendim të veçantë të përcaktohet për të informuar edhe në gjuhën e cila nuk është në përdorim zyrtar në atë komunë, por, kjo bëhet nëse atë gjuhë e flasin një pjesë e banorëve të Komunës. (Më shumë për këtë, në kapitullin tjetër ku bëhet fjalë për të drejtat e pakicave).

1. Pjesëmarrja e qytetarëve në Qeverisje Vendore

Me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje nënkuptojmë të gjitha aktivitetet e qytetarëve që bëhen me iniciativë të njësisë për Qeverisje Vendore ose që

[58] Zakon za Lokalnata Samouprava na Makedonija, dokument i cituar: neni 42, paragrafi 3

ndërmerren nga qytetarët e që ndikojnë në realizimin e të drejtës për vendosje në kuadër të Qeverisje Vendore. Gjithsesi, kjo ka të bëjë me interesin e përbashkët dhe të përgjithshëm për banorët lokal.

Komuna është e obliguar të krijojë kushte për pjesëmarrjen në forma të ndryshme të qytetarëve në vendosje apo në deklarimin në vendimmarrje për çështje të interesit të përgjithshëm të banorëve lokal, me qëllim të përmbushjes së nevojave kulturore, arsimore, shëndetësore, informative etj.

Banorët lokal marrin pjesë në organet drejtuese të shërbimeve publike si dhe në organet e tjera të personave juridik të cilat kryejnë autorizime dhe shërbime publike, të përcaktuara me ligj të veçantë dhe me rregullore të tjera. Organet e Qeverisjes Vendore janë të detyruara të sigurojnë realizimin e të drejtave dhe obligimet e banorëve lokal në mënyrë efikase, duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e qytetarëve. Funksionarët dhe nëpunësit lokal janë të obliguar që t'u përmbahen kodeksit etik të përcaktuar për funksionarët dhe nëpunësit. Organet e Qeverisjes Vendore, janë të obliguara të informojnë dhe t'u sqarojnë qytetarëve mënyrat sesi do të mund të realizojnë të drejtat e veta. Funksionarët lokal janë të obliguar që të parashohin kohë të lirë për pranimin e qytetarëve.

Emërtimi i organit vendoset në vendin ku shihet. Po ashtu edhe radhitja e zyrave, emri e mbiemri i nëpunësit në derën e zyrës si dhe profesioni dhe thirrja.

2. Qendra informative

Qendra informative është një qendër apo një zyre në lokalet e objektit të Kuvendit Komunal, ku qytetarët informohen lidhur me procedurat e shërbimeve të ofruara nga organet Komunale si dhe të kërkuara nga qytetarët. Organet Komunale, shërbimet publike dhe personat juridik të cilët kryejnë autorizime dhe ofrojnë shërbime qytetarëve, shërbehen me mjete më moderne të informimit dhe të komunikimit. Komuna themelon ose formon qendrën informative për t'i kryer sa më mirë këto shërbime.

2.1. Informimi i publikut

Organet Komunale, komisionet e Kuvendit dhe shërbyesit publik të themeluara nga Komuna janë të obliguara që pa dëmshpërblim t'i informojnë qytetarët për punët e veta si dhe për planet dhe programet që do të ndërmarrin e që janë të rëndësisë së zhvillimit dhe avancimit të Komunës. Komuna është e obliguar që t'u mundësojë qytetarëve informimin për shërbimet që do t'u ofrojë.

3. Shërbimi publik i qytetarëve

Qytetarët kanë të drejtë të kenë shërbim të mirë dhe të shfrytëzojnë të mirat materiale si dhe shërbimet e tjera që themelohen nga Komuna. Kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet asnjë qytetari pa marrë parasysh prejardhjen etnike, nacionale, fetare, të pasurisë etj. Shërbimet publike janë themeluar për qëllime të tilla, do të thotë që të shërbehen qytetarët.

4. Këshilli për mbrojtjen e konsumatorit

Për shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë për shërbime më të mira, Këshilli Komunal mund të themelojë Këshillin për mbrojtjen e konsumatorit. Këtë këshill e përbëjnë pjesëtarët e grupeve më të mëdha të konsumatorëve në Komunë.

5. E drejta në vendimmarrje

Sa i përket të drejtës në vendimmarrje të qytetarëve, ata shfrytëzojnë forma të ndryshme pjesëmarrjeje si: *iniciativa*[59], iniciativa qytetare, tubimi i qytetarëve, referendumi (i Bashkësisë lokale si dhe ai Komunal) si dhe mënyrat e tjera të deklarimit dhe të vendosjes. Të gjitha këto janë paraparë dhe janë përcaktuar me statut.

Në legjislacionet e tre shteteve të tjera, nuk është paraparë iniciativa, sikur që është paraparë në legjislacionin që rregullon

[59] Shih: Zakon O Lokalnoj Samoupravi Crne Gore, dokument i cituar: neni 100

Qeverisjen Vendore në Mal të Zi. Do të thotë, në Kosovë, Kosovë Lindore e Maqedoni janë paraparë vetëm: Iniciativa Qytetare, Tubimi i Qytetarëve dhe Referendumi si dhe vërejtjet, ankesat, peticionet e propozimet..

5.1. Iniciativa në Mal të Zi

Qytetarët kanë të drejtë të marrin iniciativën që t'u kërkojnë organeve kompetente për të shqyrtuar dhe vendosur për çështjet e caktuara të interesit të banorëve lokal. Për iniciativën e nisur, Organi kompetent është i obliguar të merr vendim brenda afatit kohor prej 30 ditësh dhe të informojë iniciuesit e kësaj çështjeje. Nëse Organi kompetent nuk u përgjigjet, atëherë, iniciuesit e kanë të drejtën që t'u drejtohen Prefektit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës.

5.2. Iniciativa qytetare

Qytetarët nëpërmjet iniciativës qytetare i propozojnë Kuvendit Komunal nxjerrjen e aktit, me të cilin do të rregullohet çështja e caktuar nga kompetencat e tij, ndërrimin e statutit ose akteve të tjera si dhe shpalljen e Referendumit në atë Komunë. Iniciativa e ndërmarrë nga qytetarët dhe e shqyrtuar nga Kuvendi komunal bart edhe shpenzimet e veta. Mirëpo, "*Shpenzimet për këto aktivitete të qytetarëve i heq Komuna*".[60] Me këtë akt, qytetarët e obligojnë Kuvendin që për këto çështje të ndërmarra nga qytetarët të mbajë seancën, të shqyrtojë çështjet e parashtruara dhe të informojë qytetarët në afat kohor të kufizuar. Ky afat është paraparë të jetë prej 60 ditësh nga marrja e propozimit në Komunat e Maqedonisë, Kosovës Lindore, ndërsa në Mal të Zi në afat prej 30 ditësh.

Me këtë iniciativë, qytetarët mund të ndërrojnë ndonjë akt që rregullon çështje me rëndësi nga kompetenca e Qeverisjes Vendore.

---

[60] Zakon Na Lokalnata Samouprava na Makedonija, dokument i cituar: neni 25, alineja 2

Nëse Organi kompetent në Malin e Zi, nuk e lejon një gjë të tillë, atëherë, iniciativa qytetare mund të shpall referendum në afat prej 90 ditësh për atë çështje. Që një iniciativë e qytetarëve të vihet në rend dite për t'u shqyrtuar, kërkohet nënshkrimi i së paku 10% të elektoratit të asaj Komune në Maqedoni si dhe në Komunat e Kosovës Lindore.

Në Malin e Zi, mund ta iniciojnë 250 qytetarë. Ndërkaq, në Kosovë për të ndërmarr një iniciativë duhet nënshkrimi i 15% të votuesve. Siç e kemi thënë edhe në pjesën ku kemi bërë fjalë për prefektin e Komunës e sidomos në mundësinë e shkarkimit të prefektit, qytetarët kanë të drejtën e iniciativës për shkarkimin e tij nga detyra, nëse ai është pengesë e zhvillimit të proceseve ekonomike e politike të Komunës. Ata, kanë të drejtë në Shërbimin e Sigurisë i cili shërbim shërben për të mbrojtur qytetarët dhe pronën e tyre nga zjarri, avaritë dhe aksidentet e ndryshme.

E drejta e qytetarëve në Maqedoni është që t'i propozojnë Këshillit Komunal, nxjerrjen e një akti ose të vendos për një çështje që i përket kompetencave të Këshillit, ashtu si vendosin qytetarët, nëpërmjet votimit të tyre. Qytetarëve u duhet mbledhja e nënshkrimeve (të duhura që kërkohen me ligjin e atij vendi) të zgjedhësve të asaj zone për të ndërmarrë këtë hap. Kur qytetarët të ndërmarrin një hap të tillë, Këshilli Komunal është i detyruar që të merr masa për këtë iniciativë brenda afatit kohor (po ashtu të paraparë me ligj) dhe të informojë qytetarët për vendimin që merr.

5.3. Tubimi i Qytetarëve

Qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në tubime që i organizon Kuvendi Komunal. Aty, ata do të njoftohen me punën e përfaqësuesve të tyre komunal. Në tubim, përfaqësuesit Komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës, kurse pjesëmarrësit mund t'u parashtrojnë pyetje dhe t'u japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur Komunal.

Tubimi i qytetarëve mund të thirret, ose ta nis iniciativa, për një pjesë të territorit të njësisë së Qeverisjes Vendore, do të thotë Komunës, ose për krejt territorin e asaj Komune. Në të

shqyrtohen dhe jepen propozimet për çështjet që i dedikohen Kuvendit ose organeve dhe shërbimeve të caktuara. Organet dhe shërbimet e njësisë së Qeverisjes Vendore janë të obliguara që në afat prej 60 ditësh nga mbajtja e tubimit, të shqyrtojnë dhe të marrin qëndrim për çështjen e shtruar nga Qytetarët. Ato, organet Komunale janë të obliguara, njëkohësisht që të njoftojnë qytetarët për vendimin e tyre. Mënyra e thirrjes dhe e mbajtjes së tubimit është rregulluar me statut të Komunës.

Tubimi i qytetarëve, me vota të shumicës së të pranishmëve, mund të konfirmojë propozimet dhe t'ia dërgojë Organit kompetent. Organi kompetent është i obliguar që në afat prej 60 ditësh nga mbajtja e Tubimit të Qytetarëve të vendos për atë çështje dhe të informojë qytetarët.

Në Maqedoni, tubimi i qytetarëve mund të thirret për tërë territorin e Komunës si dhe për një pjesë të territorit të saj. Këtë mund ta bëjnë Kryetari i Komunës, me iniciativë të veten, ose me kërkesë të 10% të qytetarëve me të drejtë vote të asaj zone. Tubimi mbahet për ndonjë çështje me rëndësi të atij lokaliteti. Organet Komunale në një afat prej 90 ditësh janë të obliguara që të vendosin për vendimet që marren në atë tubim dhe të informojnë qytetarët. Gjatë përgatitjes së dispozitave të Komunës, Këshilli Komunal, përkatësisht Prefekti mund të organizojnë tribuna publike me qëllim të informimit sa më të mirë të qytetarëve dhe të marrin propozime ose të anketojnë të pranishmit për ndonjë çështje që ka të bëjë me këto punë.

5.4. Referendumi

Në Komunat e Republikës së Kosovës, qytetarët me iniciativë të veten mund të kërkojnë që ndonjë Rregullore e Komunës t'i nënshtrohet Referendumit. Kjo kërkesë e qytetarëve duhet të bëhet në afat prej 30 ditësh nga aprovimi i Rregullores dhe duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të Komunës.

Kuvendi Komunal në Komunat e Kosovës Lindore, mund që me iniciativë të veten të shpall referendum. Por, është i obliguar që të shpall Referendum në kuadër të kompetencave të veta nëse këtë e kërkojnë qytetarët, kuptohet nëse me

nënshkrim i plotësojnë kushtet e parapara me statut dhe ligj. Vendimi që merret nëpërmjet Referendumit është valid kur për të është votuar me shumicë votash dhe kur në Referendum kanë marrë pjesë më se gjysma e zgjedhësve të atij territori.

Në Maqedoni, përmes Referendumit, qytetarët, mund të vendosin për çështjet që janë në kompetenca të Komunës si dhe për çështjet e tjera që janë me rëndësi për banorët lokal. Këshilli Komunal, mund të shpall Referendum me iniciativë të veten si dhe kur këtë e kërkojnë së paku 20% të zgjedhësve të Komunës. Vendimi që merret në Referendum është i detyrueshëm për Këshillin Komunal.

Në Mal të Zi, me anë të Referendumit, qytetarët mund të ndërrojnë diçka ose të ndërmarrin nismën për të vendosur ndryshe për çështjet që kanë të bëjnë me atë bashkësi Lokale e që është në kompetenca të Qeverisjes Vendore.

Sipas statutit të Komunës së Ulqinit, Referendumi Komunal mund të shpallet në territorin e krejt Komunës, në rastet e deklarimit të mëhershëm për ndonjë çështje.

5.5. Diskutimi Publik

Para nxjerrjes së planit zhvillimor, planit hapësinor e urbanistik, buxhetit dhe akteve të përgjithshme me të cilat caktohen të drejtat dhe obligimet e qytetarëve, Komuna përcakton planin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe cakton Organin që do të mbajë diskutimin publik. Ky diskutim duhet të zgjat së paku 15 ditë.

Në këtë mënyrë do të dëgjohet edhe zëri i qytetarëve për ato çështje që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm e banorëve lokal. Në ato vende ku jetojnë pakicat plani duhet t'u dorëzohet në gjuhën e folur të atij komuniteti.

5.6. E drejta në peticion

Çdo person apo Organizatë që ka interes në Komunë ka të drejtë t'i paraqes peticion Kuvendit Komunal për çfarëdo çështje rreth përgjegjësisë dhe kompetencave të Komunës. Kuvendi Komunal e shqyrton peticionin në pajtim me Statutin

dhe rregullat procedurale të tij. Çdokush ka të drejtë në ankesë dhe peticion dhe të kërkojë sqarime nga veprimtaritë e Qeverisjes Vendore.

Procedura e këtyre formave është rregulluar me statut, ndërsa Organet kompetente janë të obliguara që të informojnë qytetarët për vendimin, brenda 30 ditësh, prej ditës kur është pranuar peticioni.

Pos kësaj të drejte, qytetarët kanë të drejtën të ndërmarrin edhe iniciativën para Gjyqit Kushtetues për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve të përgjithshme të organeve shtetërore, me të cilat shkelet e drejta e Qeverisjes Vendore.

5.7. Ankesat dhe vërejtjet e qytetarëve

Në Kosovë, çdo qytetar mund të parashtrojë ankesë kundër vendimit administrativ të Komunës, nëse mendon se me atë vendim i janë cenuar të drejtat dhe liritë njerëzore. Ankesat i dorëzohen me shkrim drejtuesit të drejtorisë së administratës dhe personelit brenda një afati prej një muaji pasi qytetari të jetë njoftuar për atë vendim. Me këtë akt, qytetari nuk do të ndëshkohet për shkak të ankesës.

Në Maqedoni, qytetari po ashtu ka të drejtë në vërejtje dhe propozime për punët e Komunës dhe të administratës së saj. Ata e kanë të drejtën e krijimit të kushteve nga organet e Komunës, për të pasur ku të vendosin vërejtjet dhe propozimet e tyre. Po ashtu edhe në Mal të Zi si dhe në Kosovën Lindore, qytetarët e kanë të drejtën e ankesave dhe propozimeve të tyre.

Kur bëjmë fjalë për të drejtat e qytetarëve të Malit të Zi dhe të Kosovës Lindore, organet e Qeverisjes Vendore kanë për obligim të vendosin kutitë ku, qytetarët do të vendosin vërejtjet ose propozimet e veta si dhe librin e përshtypjeve. Në këtë libër do të shënohen përshtypjet e palës (qytetarit) që kanë të bëjnë me pritjen, angazhimin dhe punën e zyrtarëve dhe nëpunësve lokal. Vërejtjeve të qytetarëve, Organet duhet t'u përgjigjen brenda 15 ditësh nga marrja e vërejtjes, nëse një përgjigje të tillë, e kërkon qytetari.

5.8. Vetëkontributi

Në Komunat e Kosovës Lindore, me anë të vetëkontributit qytetarët me dëshirë të veten japin kontributin për të zhvilluar një aktivitet në Komunën e tyre. Vendimi mbi vetëkontributin merret nga qytetarët drejtpërdrejt me vota të fshehta.

Ai në vete përmban të dhënat lidhur me nevojat për të cilat tubohen mjetet; territori në të cilin tubohen ato mjete; afati kohor i mbledhjes së mjeteve; shuma e caktuar totale që do të mblidhet; obliguesit, mënyra dhe afati i kryerjes së vetëkontributit si dhe personat që lirohen nga vetëkontributi; lartësia (shuma e vetëkontributit); mënyra e evidencës; shuma e mjeteve të caktuara kur ajo punë kryhet me punë krahu ose me ndonjë kompensim tjetër, mënyra e mbikëqyrjes nga ana e qytetarëve si dhe mënyra e kthimit të mjeteve që e tejkalojnë shumën e kërkuar.

Kuvendi Komunal përcakton propozim-vendimin për mënyrën e veprimit të paraparë me statut të Komunës. Me marrjen e iniciativës për vetëkontribut, bëhet edhe programi me të cilin parashihen burimet, përdorimi dhe mënyra e sigurimit të të gjitha mjeteve financiare për realizimin e vetëkontributit.

Vendimin e sjellin qytetarët që kanë të drejtë vote dhe janë banorë të atij territori ku mblidhen mjetet. Mund të vendosin edhe ata që nuk banojnë në atë territor por kanë patundshmëri atje. Nëse për të votohet me shumicë votash, atëherë, Referendumi është i suksesshëm.

Vendimi publikohet në të njëjtën mënyrë si edhe akti i nxjerrë nga Organet Komunale. Ky vendim me nënshkrimet e qytetarëve i dërgohet paguesit që ka selinë jashtë territorit ku mblidhen mjetet.

Vetëkontributi mund të realizohet me mjete, (në bankënota) me mall, punë, shërbime të transportit si dhe shërbimeve të tjera të nevojshme për qytetarët e atij territori.

Nëse me vendim nuk është caktuar ndryshe, atëherë, shuma themelore e vetëkontributit rregullohet me hyrjen në fuqi të vendimit të vetëkuntributit.

Shuma themelore caktohet sipas të ardhurave të qytetarëve, varësisht nga paga apo nga pagesa e tatimit vjetor të

punës së bujqësisë dhe të pylltarisë, vlerës së patundshmërisë që i paguhet tatimi. Në vetëkontribut nuk hyjnë të ardhurat që nuk tatimohen.

Llogaria dhe pagesa kryhet në atë mënyrë dhe në ato afate që janë të caktuara me vendim. Në rastet kur kjo bëhet me anë të pagesës së tatimit, obligim i paguesit është në çdo ratë të pagesës së tatimit të paguaj edhe ratën për vetëkontributin.

Shuma e vetëkontributit është proporcionale dhe përcaktohet me vendim. Lehtësitë dhe lirimi nga vetëkontributi përcaktohen me vendim.

Ato që kanë të bëjnë me vonesa të pagesave të ratave, vjetërsia etj, që nuk janë paraparë me vendim të posaçëm, do të shqyrtohen në të njëjtën mënyrë si është paraparë me ligj rregullimi i pagesës së tatimit të qytetarëve.

Mjetet në të holla, të cilat tubohen me vendim të vetëkontributit, përdoren vetëm për atë qëllim, për të cilin janë mbledhur. Pagesa bëhet vetëm për atë njësi ku është mbajtur vetëkontributi.

II. Të drejtat e pakicave kombëtare (minoriteteve)

1. Përkufizimi i emërtimit pakicë kombëtare (minoritet) dhe trajtimi i tyre

Rregullorja 2007/30 që ka të bëjë me rregullimin e Qeverisjes Vendore në Kosovë, përkufizimin për minoritetet e parasheh kështu: *"Bashkësitë e banorëve që i përkasin grupit të njëjtë etnik, fetar ose gjuhësor."*[61] Nëpërmjet këtij përkufizimi, me këtë Rregullore që tani më është shfuqizuar, Kosova, kishte saktësuar minoritetet dhe duke pasur për bazë këtë, pushteti aktual kishte saktësuar dhe mund të konsiderohej që angazhohej në përmbushjen e detyrimeve që kishte ndaj minoriteteve. Ligji që rregullon Qeverisjen Vendore në Republikën e Kosovës, nuk e ka paraparë këtë nocion, por emërtimi "Komunitet" ka po këtë shpjegim. Kur bëhet fjalë për minoritetet, Ligji thekson: "Komuniteti pakicë ose jo-shumicë".

I njëjti konstatim vlen edhe për Kushtetutat e të tri shteteve tjera: Serbisë, Maqedonisë dhe e Malit të Zi, të cilat po ashtu nuk e kanë paraparë qartësimin ose përkufizimin e nocionit "minoritet". Meqë në Kushtetutat e këtyre shteteve nuk ka përkufizim për këtë emërtim, mbetet e paqartë, cilat janë ato bashkësi që do të trajtoheshin si minoritete.

Bazuar në përbërjen etnike, Presheva e Bujanoci komuna, këto të Kosovës Lindore që aktualisht janë nën kufijtë administrativ të Serbisë si dhe Ulqini e Tuzi në Mal të Zi, konsiderohen si mjedise të përziera.

Në Ligjin që rregullon Qeverisjen Vendore në Republikën e Serbisë, *"Mjedis i përzier konsiderohet kur një bashkësi etnike ka një përbërje me më shumë se 5% të popullatës së Komunës ose të gjitha bashkësitë tejkalojnë 10% e popullatës"*.[62]

---

[61] Rregullore 2007/30, dokument i cituar: neni 2, alineja 3, paragrafi 3

[62] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Republike Srbije: neni 63, paragrafi 2

Në këto Komuna, pakica shqiptare tejkalon 50% të popullatës së përgjithshme. Në Preshevë ka mbi 90% e në Bujanoc mbi 60% banorë shqiptarë.

Në Maqedoni janë me dhjetëra Komuna që e tejkalojnë 50% e popullsisë, e posaçërisht Komunat që bëjnë pjesë në Maqedoninë Perëndimore si dhe në Mal të Zi janë aktualisht Ulqini me status të Komunës dhe Tuzi (që ka statusin e Komunës Urbane, brenda qytetit të Podgoricës), që të dyja këto lokalitete me mbi 50% të banuara me shqiptarë.

Të drejtat e minoriteteve në Kosovë, Kosovë Lindore (Serbi), Maqedoni e Mal i Zi, kanë vënë në sprovë politikën udhëheqëse të këtyre shteteve. Nëpër Kushtetutat, (Në Kosovë: Korniza Kushtetuese, Rregullorja 2000/45 e ndryshuar në atë 2007/30, Dokumenti gjithëpërfshirës i Ahtisarit) si dhe në Ligjet për Qeverisje Lokale, të këtyre shteteve, ka gjetur vend kjo çështje. Është një çështje që ka të bëjë me liritë themelore të njeriut. Mirëpo, meqë në qarqet më të larta ndërkombëtare, nuk është arritur ndonjë unanimitet sesi do të përkufizohej termi minoritet, shtetet në fjalë edhe pse kanë trajtuar çështjen e të drejtave dhe lirive të minoriteteve edhe në Qeverisjen Vendore të tyre, nuk i kanë dhënë vendin e merituar e as e kanë trajtuar drejt. Hiq Kosovën e cila po pretendon t'ua kalojë edhe shteteve më demokratike me anë të propozimeve nëpër dokumente juridike siç janë: Korniza Kushtetuese, Rregulloret 2000/45, 2007/30 e 2001/36, Dokumentet mbi të Drejtat e minoriteteve, Dokumenti i propozuar nga Ahtisari, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës.

2. Integrimi i minoriteteve në Qeverisjen Vendore

Konventa-kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare e Këshillit të Evropës ka paraparë që shtetet nënshkruese të këtij dokumenti në një mënyrë të obligohen për krijimin e kushteve për pjesëmarrje efektive të minoriteteve, duke i integruar ato në shoqëritë e tyre. Kështu "*Palët do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike,*

veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta"[63]. Në këtë mënyrë, pakicat kombëtare do të duhej të integroheshin në Qeverisjen Vendore në përpjesëtim të numrit të përgjithshëm të banorëve të Komunës.

Ky rekomandim i kësaj Konvente, nuk e ka forcën obliguese që do t'i detyronte shtetet që të ndërmarrin nismat për përmbushjen e këtij obligimi. Detyrimet që bien ndaj shteteve janë të formuluara aq në mënyrë të mjegullt, sa që mbetet vetëm një dëshirë e mirë e tyre për ta përmbushur. Në çdo nen të këtij dokumenti, që ka të bëjë me rekomandimet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, paraqitet edhe fjalia: *"...në përputhje me procedurat e parashikuara në sistemin e tyre ligjor"*[64]

Në Kosovë, si para ashtu edhe pas zgjidhjes së statusit përfundimtar, Komunat nëpërmjet politikës dhe praktikës së tyre vënë në veprim nevojën dhe nxisin bashkëjetesën mes banorëve si dhe krijojnë kushte për t'u mundësuar të gjitha komuniteteve që ta shprehin, ta ruajnë dhe ta zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.

Në Kosovën Lindore, Maqedoni e Mal i Zi, në masë më të vogël, janë të njëjtat tentativa që minoritetet të integrohen në shoqëri, duke pasur parasysh ruajtjen e zhvillimin e vlerave etnike, kulturore, fetare e gjuhësore të tyre.

Vlen të theksohet se në Mal të Zi, në Ligjin që rregullon Qeverisjen Vendore, pakicat përmenden vetëm dy herë edhe atë kur bëhet fjalë për sigurimin e kushteve për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të pakicave si dhe kur saktësohet përdorimi i gjuhës së grupeve etnike në disa dokumente.

Derisa në rastin e parë, përdoret emërtimi pakica[65], në rastin e dytë e shohim emërtimin: grupe etnike kombëtare.

2.1. Përdorimi i gjuhës së pakicave kombëtare

Gjuhë zyrtare nëpër Komunat e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Kështu, shenjat zyrtare që mbajnë emrat e qyteteve, vendbanimeve, rrugëve dhe vendeve të tjera publike

---

[63] Konventa – kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe raporti shpjegues, Council of Europe, prepared in electronic format in Tirana, (March 2003): neni 15

[64] Po aty: neni 11, alineja 1

[65] Shih: Zakon O Lokalnoj Samoupravi Crne Gore, dokument i cituar: neni 10

shkruhen në gjuhën shqipe dhe në atë serbe. Në ato Komuna ku popullsinë e përbëjnë më shumë se dhjetë për qind të ndonjë pakice tjetër kombëtare, shenjat zyrtare të qyteteve dhe emërtimet e rrugëve dhe vendbanimeve të tjera, jepen edhe në gjuhën e pakicave kombëtare që jetojnë aty.

Ata e kanë të drejtën e komunikimit në gjuhën e tyre amtare me të gjitha organet e Komunës si dhe me nëpunësit civil.

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunës, të komiteteve të tyre dhe tubimet publike mbahen në të dy gjuhët: shqip dhe serbisht. Në Komunat ku ka shumicë të ndonjë pakice tjetër kombëtare, aktet dhe procesverbalet përkthehen në gjuhën e tyre sa herë që të ketë nevojë. Bazuar në këto të dhëna, mund të konstatohet që Qeverisja Vendore në Kosovë përmbush kriterin e përdorimit të lirë të gjuhës së pakicave kombëtare sikur që parashihet në Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës. Në këtë dokument shprehimisht thuhet: *"Palët angazhohen të njohin që çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të përdorë lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e tij/saj të pakicës, në mënyrë personale dhe publike, me gojë dhe me shkrim"*[66].

Jo vetëm përmbush këtë rekomandim ndaj këtij dokumenti që dyshoj ta ketë nënshkruar Kosova, por, ky subjekt që tani së voni fitoi statusin e shtetësisë, duke u pavarësuar nga Serbia, ec drejt një demokratizimi të jetës. Kështu ajo mundohet të avancojë të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare që jetojnë nëpër Komunat e Kosovës. Të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës shtypen në gjuhët shqipe dhe serbe. Në Komunat ku jetojnë bashkësitë kombëtare, (pakicat e tjera) dhe ku ata përbëjnë një pjesë substanciale të popullsisë, të gjitha dokumentet zyrtare shtypen gjithashtu edhe në gjuhën e tyre. Statuti i këtyre Komunave përfshin në mënyrë të detajuar dispozita për përdorimin e gjuhës së pakicave kombëtare, duke pasur parasysh përbërjen e pakicave kombëtare në Komunë.

---

[66] Konventa – kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe raporti shpjegues, Council of Europe, prepared in electronic format in Tirana, (March 2003): neni 10, alineja 1

Në Mal të Zi, parashihet përdorimi i gjuhës së pakicave në disa raste. *"Nëpër Komunat ku numrin më të madh të banorëve e përbëjnë përfaqësuesit e grupeve etnike nacionale, plani përmban edhe mënyrën e sigurimit të pjesëmarrjes së grupeve etnike nacionale edhe në gjuhën e tyre"*[67]. Ndërkaq projekt statuti i Komunës së Ulqinit ka paraparë përdorimin e barabartë të gjuhëve siç janë: *"gjuha malazeze, përkatësisht serbe dhe ajo shqipe"*[68].

Në Maqedoni, varësisht nga numri i banorëve të përkatësisë etnike, nëpër Komuna, përcaktohet edhe përdorimi i gjuhës tjetër zyrtare pos asaj maqedonase. Në Komunat me shumicë shqiptare, gjuhë zyrtare janë: gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik si dhe gjuha shqipe dhe shkrimi i saj latin. Në përdorim zyrtar në territorin e një Komune të tillë, mund të jenë edhe gjuhët që i cakton me vendim Këshilli i Komunës.

Në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe, shkruhen të gjitha emërtimet e vendbanimeve në Komunë, pastaj, titujt e shërbimeve të ndryshme si dhe të institucioneve publike; mbishkrimet e institucioneve kulturore dhe arsimore dhe të ndërmarrjeve; mbishkrimet e tjera publike dhe aktet e përgjithshme. Në këto gjuhë bëhet edhe komunikimi me qytetarët dhe subjektet e tjera.

Në ato institucione kulturore dhe arsimore, ku mëtohet të zhvillohet dhe të avancohet kultura dhe arsimi i ndonjë nacionaliteti tjetër, pos mbishkrimeve në gjuhët maqedonase dhe shqipe, vendosen edhe mbishkrimet në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare përkatëse. Në Komunat ku pos maqedonasve dhe shqiptarëve, ka edhe pakicë tjetër kombëtare që e përbën 20% të popullatës të asaj Komune, atëherë edhe ajo gjuhë bëhet zyrtare dhe përdoret në organet Komunale. *"Në territorin e Komunës së Tetovës gjuhë zyrtare janë: Gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik, gjuha shqipe dhe shkrimi i saj latin"*[69]. Ndërsa, për përdorimin e gjuhës së qytetarëve që nuk e përbëjnë 20% e popullatës të asaj komune, vendos Këshilli i

[67] Zakon o Lokalnoj Samoupravi Crne Gore, dokument i cituar: neni 110, alineja 4
[68] Nacrt Statuta Opstine Ulcinj, dokument i cituar: neni 19, paragrafi 2
[69] Statuti i Komunës së Tetovës, dokument i cituar: neni 145, alineja 1, paragrafi 1 e 2

Komunës (Kuvendi i Komunës). Kjo mënyrë e vendosjes është edhe në Komunat e Kosovës.

2.2. Përdorimi i simboleve Kombëtare

Nëpër të gjitha këto vende që po trajtojmë, Ligjet që rregullojnë Qeverisjen Vendore, politikën e tyre e mbështesin në demokratizimin e Qeverisjes, duke pretenduar që u japin të gjitha të drejtat pakicave kombëtare. Mirëpo, një gjë e tillë, nuk shihet në vepër. Vlen të theksojmë që, në Kosovë, sipas Kornizës Kushtetuese të Kosovës si dhe Rregullores 2007/30, është paraparë të përdoret flamuri i pakicave kombëtare. Kosova, qëndron para Serbisë dhe Maqedonisë sa i përket lejimit të përdorimit të simboleve të pakicave kombëtare. Maqedonia e Mali i Zi, edhe pse me Kushtetutat e tyre lejohet përdorimi i simboleve kombëtare, megjithatë, Ligjet që rregullojnë Qeverisjen Vendore të këtyre vendeve, nuk e përmendin këtë të drejtë. Aty mund të shihet vetëm vullneti i mirë i këtij shteti për të mbrojtur të drejtat e pakicave kombëtare dhe avancimi i kulturës dhe i identitetit të tyre etnik. Statuti i Komunës së Ulqinit ka paraparë përdorimin e simboleve të pakicave kombëtare. Si i tillë, Statuti i kësaj Komune i referohet Kushtetutës së këtij vendi. Ndërsa në Maqedoni, edhe pse me Kushtetutë është lejuar, megjithatë, janë bërë përpjekje për heqjen e kësaj të drejte, duke ndërruar nenin që bën fjalë për këtë të drejtë. Andaj, ende është e paqartë se çfarë vendimi do të merret. Partitë politike shqiptare që veprojnë në Maqedoni, janë kah bëjnë presione mbi pushtetarët që të mos ndërmarrin hapa të ngutshëm duke hequr një të drejtë e cila pakicave u lejohet me Kushtetutë. Deri më tani, pakicat kombëtare, në këtë shtet kanë mundur lirshëm ta përdorin Flamurin kombëtar të tyre, por se çfarë do të bëhet në të ardhmen, kjo do të mbetet të shihet nga hapat që do të ndërmarrin partitë politike që janë në koalicion udhëheqës të Pushtetit Qendror. Në Komunat e Kosovës Lindore, një gjë e tillë, nuk lejohet. Në këto Komuna, gjatë festave shtetërore e Kombëtare, vendoset vetëm flamuri i kombit përkatësisht i shtetit serb.

2.3. Përfaqësimi i pakicave kombëtare (minoriteteve)

Pakicat kombëtare përfaqësohen nëpër Kuvendet Komunale, proporcionalisht sipas përqindjes që jetojnë nëpër ato Komuna. Si në Kosovë, Kosovë Lindore, Maqedoni e Mal të Zi, përfaqësimi i tyre bëhet në këtë mënyrë. Numri i këshilltarëve (anëtarëve të Këshillit) Komunal, varet nga numri i zgjedhësve a votuesve të Komunave veç e veç. Në këtë mënyrë përfaqësohen edhe në trupat punuese të Komunës.

2.4. Posti i zëvendëskryetarit, nënkryetarit të Kuvendit të Komunës

Në Komunat e Kosovës Lindore, në Maqedoni, Mal të Zi si dhe në Kosovë, vendi i zëvendëskryetarit të Komunës, përkatësisht i një nënkryetari të Kuvendit (Këshillit) Komunal, është rezervuar për një përfaqësues të pakicave kombëtare që jetojnë në atë Komunë e që përfaqësohen në Kuvend.

Në Kosovë, në Komunat ku jetojnë një apo më shumë komunitete, të cilët nuk janë shumicë por që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të popullatës, Kuvendi Komunal emëron një zëvendëskryesues nga ana e komuniteteve edhe po që se ata nuk përfaqësohen në Kuvend Komunal.

3. Përfaqësimi i pakicave nëpër Komisione, Këshilla e Pleqësi

Në Komunat e Kosovës Lindore, Preshevë e Bujanoc, është paraparë themelimi i një Këshilli për marrëdhënie ndërnacionale, të cilin e përbëjnë pjesëtarë të të gjitha nacionaliteteve që jetojnë në atë mjedis. Në këtë Këshill kanë të drejtën e përfaqësimit edhe ato bashkësi që kanë më tepër se 1% të popullatës. Këshilli ka për detyrë të realizojë, mbrojë dhe avancojë të drejtat e barabarta nacionale. Ky Këshill është i obliguar që të njoftojë Kuvendin e Komunës për të gjitha vendimet dhe sugjerimet e veta.

Në Maqedoni, pjesëtarët e pakicave kombëtare, përfaqësohen nëpërmjet Komisioneve e veçanërisht atë që ka të bëjë me marrëdhëniet ndërnacionale.

Nëpër Komunat e Kosovës, sipas Ligjit që rregullon Qeverisjen Vendore, themelohet Komiteti i komuniteteve. Kuvendi Komunal është themelues i Komitetit të komuniteteve si Komitet i përhershëm. Të drejtat e Komitetit të komuniteteve janë të drejta shtesë e anëtarit të Komitetit apo të komunitetit ose të qytetarit, i cili çdo çështje mund ta paraqes te ombudspersoni apo në gjykatë. Emërimi i anëtarëve të Komitetit të komuniteteve, bëhet me anë të procedurës e cila rregullohet me anë të statutit të Komunës. Nëpërmjet asaj procedure garantohet përfshirja e këshilltarëve të Kuvendit dhe të përfaqësuesve të komunitetit në këtë Komitet.

3.1. Komiteti i komuniteteve (i bashkësive)

Angazhohet për të drejta të barabarta civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi e të drejta të barabarta në punësim.

Bën përpjekje që në kuadër të territorit të Komunës të sigurojë, që funksionarët politik si dhe ata që marrin përsipër detyra publike ose mbajnë ndonjë post tjetër publik të mos bëjnë diskriminim ndaj ndonjë personi tjetër, për shkak të gjuhës, përkatësisë etnike ose të shoqërimit me komunitetin.

Ky Komitet përkrah të drejtat dhe interesat e komuniteteve që jetojnë në atë Komunë dhe veç kësaj përkrah një shoqëri ku traditat e ndryshme kulturore, shoqërore dhe fetare jo vetëm që do të tolerohen, por edhe do të inkurajohen. Komiteti në fjalë, ka për obligim që çdo e pa drejtë që konsiderohet se u bëhet komuniteteve nga ana e Kuvendit Komunal, ta paraqes para organit kompetent që merret me këtë çështje. Në këtë Komitet është paraparë përfaqësimi i çdo komuniteti me së paku nga një anëtar. Komuniteti që është shumicë në atë komunë, do të ketë më pak se gjysmën e numrit të anëtarëve të komitetit të komunitetit. Ndërkaq numri tjetër i anëtarëve do të jetë i përfaqësuar proporcionalisht nga përqindja e banorëve të komuniteteve tjera.

Në Maqedoni, themelohet një Komision i quajtur Komisioni i Bashkësive, të cilin e përbëjnë anëtarë të barabartë të bashkësive etnike që jetojnë në Komunë dhe ata anëtarë nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit të Komunës (këshilltarë). Është i ngjashëm me Komitetin e komuniteteve në Kosovë dhe i kryen të njëjtat detyra.

Në Preshevë, ekziston një organ i ashtuquajtur Pleqësia për marrëdhënie ndërnacionale.

Siç shihet në çdo shtet, nëpër Komuna të përziera themelohen institucione në formë Komitetesh, Komisionesh ose Pleqësive e që kanë të bëjnë me të vetmin qëllim: Mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërnacionale në Komunë.

3.2. Komiteti për ndërmjetësim

Komiteti për ndërmjetësim, (sipas Rregullore 2007/30 në Kosovë, e që nuk përmendet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale) kishte numër të barabartë të këshilltarëve të Kuvendit Komunal, të cilët nuk ishin anëtarë të Komitetit të komuniteteve. Këtë e përbënin përfaqësuesit e komuniteteve të Komunës, në përpjesëtim të drejtë, të cilët nuk i takonin komunitetit që ishte shumicë në Komunë. Ky komitet ishte themeluar për të shqyrtuar ankesat apo vërejtjet e Komitetit të komuniteteve kur ky i dyti pretendonte se u ishin shkelur të drejtat e tyre. Kishte për obligim që të kryej hetime të nevojshme për të konstatuar në ishin shkelur apo mund të shkeleshin të drejtat e një komuniteti. Në këtë mënyrë, ky Komitet, do të provonte nëse është ndërmarrë apo propozuar ndonjë masë ndaj atij veprimi që mund të ishte i dëmshëm për interesat e komunitetit. Për krejt veprimet që ndërmerrte, Komiteti për ndërmjetësim ishte i obliguar që, t'i paraqiste raport Kuvendit Komunal si dhe t'i ofronte ndonjë zgjidhje.

Nëse Kuvendi Komunal, injoronte vërejtjet e paraqitura nga ky Komitet, apo nuk ndërmerrte asgjë për evitimin e atyre problemeve, çështja i kalohej Pushtetit Qendror.

3.3. Zyra e komunitetit në Kosovë

Në Kosovë, në ato Komuna ku komuniteti i cili nuk është shumicë përbën një pjesë të rëndësishme të asaj popullate, themelohet edhe Zyra e Komunitetit. Ato janë të përkohshme dhe do të ekzistojnë për aq sa Pushteti Qendror e konsideron të nevojshme ekzistimin e saj.

Kjo zyre është përgjegjëse për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të komunitetit dhe sigurimin e shërbimeve të barabarta publike në nivel Komunal.

Është pjesë përbërëse e Komunës dhe e strukturës së përbashkët administrative. Sa i përket nënzyrave, ato, do të themelohen nëse kërkohet nevoja për të ofruar shërbime publike të sigurta dhe të lira.

Shefi i kësaj zyreje sipas funksionit është edhe anëtar i jashtëm i bordit të drejtorëve të Komunës. Obligim i shefit është që të dërgojë raport me shkrim për secilën mbledhje të zyrës së komunitetit, duke përshkruar në detaje punët e kryera për të cilat, ajo zyre është përgjegjëse.

4. Shërbimi civil dhe të drejtat e pakicave

Në Kosovën Lindore, Maqedoni dhe në Mal të Zi, shërbyesit civil mundohen që të shërbejnë banorët e Komunave që e përbëjnë shumicën absolute apo edhe ka një përqindje të konsiderueshme të pakicave kombëtare, me qëllim të përmbushjes së nevojave të tyre. Të gjithë banorët trajtohen njësoj. Por, jo edhe të gjitha dokumentet dhe informacionet tjera, jepen në gjuhën e tyre.

Në Kosovë, nëpunësit civil Komunal, janë të detyruar që të punojnë sipas udhëzimeve dhe urdhrave të eprorëve të tyre. Mirëpo, në raste të veçanta, ata e kanë të drejtën e shkeljes të këtyre rregullave, edhe atë kur vihet në dyshim urdhri i dhënë. Atëherë, kur konsiderohet se me atë urdhër a udhëzim shkelen të drejtat e pakicave kombëtare. Nëpunësit marrin urdhra dhe udhëzime për mënyrën e punës së tyre, *"përveç nëse këto udhëzime janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, të drejtat dhe*

liritë e njeriut ose të drejtat e komuniteteve".[70] Në këtë mënyrë, luftohen padrejtësitë e mundshme ndaj pakicave kombëtare.

Shërbimi Komunal në të gjitha nivelet pasqyron në mënyrë proporcionale numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve.

5. E drejta e pakicave në bashkëpunim me Komunat dhe asociacionet e tjera

Sipas Ligjit që rregullon Qeverisjen Vendore në Kosovë, bazuar në dokumentin gjithëpërfshirës të Ahtisarit, Komunave me popullsi serbe, u është dhënë një hapësirë e madhe veprimi. Atyre u është lejuar si vertikalisht ashtu edhe horizontalisht lidhja me shtetin e Serbisë.

Edhe nëpër shtetet tjera, duke u thirrur në fqinjësinë e mirë u është lënë hapësirë Komunave të përziera ose atyre etnikisht të pastra me pakica kombëtare që të zhvillojnë bashkëpunim me shtetin e tyre amë, por, të drejtat që u janë dhënë komunitetit serb në Kosovë, nuk mund të krahasohen me asnjë shtet të rajonit. Derisa në shtetet tjerë, është lejuar bashkëpunimi kulturor me Komunat apo edhe me Pushtetin Qendror të shtetit amë, në Kosovë është ecur një hap para. Ligji për Vetëqeverisje Lokale, bazuar në dokumentin gjithëpërfshirës të Ahtisarit, ka paraparë që në Kosovë, t'u lejohet serbëve lokal që të financohen edhe nga Serbia. Kështu *"Komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë, brenda kompetencave të tyre, me Komunat dhe institucionet, përfshirë agjencitë qeveritare të Republikës së Serbisë. Bashkëpunimi i tillë do të ketë formën e ofrimit të asistencës financiare dhe teknike nga ana e institucioneve të Serbisë, duke përfshirë personelin e specializuar dhe pajimet, në zbatimin e kompetencave komunale"*[71].

Edhe pse e formuluar në këtë mënyrë (në formë të paqartë, të dykuptimësisë) megjithatë vërehet një tendencë e përmbushjes së disa të drejtave diskriminuese pozitive që nuk janë në shtetet e rajonit.

---

[70] Rregullore Nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës: "Rregullat e mirësjelljes së shërbimit civil", pika 10

[71] Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës, neni 30, alinea 2

Duke marrë për bazë të gjitha ato që u thanë më lart dhe duke u bazuar në dokumentet e nënshkruara nga shtetet evropiane për mbrojtjen dhe të drejtat e lirive të pakicave kombëtare, mund të konstatojmë se në disa fusha që kanë të bëjnë me ruajtjen, zhvillimin dhe avancimin e kulturës, të katër këto shtete i janë përafruar rekomandimeve të dokumenteve ndërkombëtare. Sa i përket, të drejtave të tjera e në veçanti atyre që flasin për bashkëpunimin me shtetin amë, serbëve të Kosovës u është dhënë më tepër hapësirë se akëcilës pakice tjetër në shtetet që na rrethojnë. Vlen të theksojmë edhe të drejtën e komunitetit serb që të përcaktohet për Komandantin e Policisë së rajonit në Komunat e banuara me shumicë serbe. Kosova prin për të mirë. Ajo, është angazhuar dhe angazhohet që në Qeverisjen Vendore të ketë avancime në të drejtat e pakicave, duke filluar nga integrimi, (hiq serbët që nuk shprehin gatishmëri të integrohen) pakicat tjera i gëzojnë të gjitha të drejtat, duke filluar nga përdorimi i gjuhës së folur dhe asaj të shkruar, shprehjen e mendimit të lirë si dhe përfaqësimin e tyre në Kuvendet Komunale dhe në organet e tyre.

Në shtetet tjera, nuk janë në masë të duhur këto avancime. Ato si duket i shfrytëzojnë sqarimet e mjegullta nëpër dokumentet siç janë: ajo e Kopenhagenit, Konventa kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Dokumenti mbi gjuhët e pakicave rajonale etj.

Këto dokumente i kanë paraparë të gjitha të drejtat e pakicave kombëtare, por nuk e kanë forcën detyruese me çka do të detyronin shtetet që t'i plotësojnë ato kushte. Pastaj, në ato dokumente qëndrojnë edhe rekomandimet që, gjatë përmbushjes së të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, të kihet parasysh të mos shkelet Ligji dhe integriteti i shtetit ku jetojnë ato pakica.

6. Kompetencat e zgjeruara për Komunat me popullsi serbe në Kosovë

Janë disa kompetenca të zgjeruara që Komunave: Mitrovicës së veriut, Graçanicës dhe Shtërpcës u janë dhënë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës e që në shtetet tjera janë kompetenca të institucioneve Qendrore.

6.1. E drejta e komunave serbe në arsimin e lartë dhe në shëndetësinë dytësore

Serbët lokal të Kosovës sipas Ligjit në fuqi për Qeverisje Vendore e sidomos ata që jetojnë në Mitrovicë, kanë të drejtën e arsimit të lartë dhe të shëndetësisë dytësore, duke i marrë të gjitha të drejtat, që nga themelimi, mirëmbajtja, licencimi i biznesit dhe financimi. Ndërkaq sa i përket dy Komunave të tjera, asaj të Graçanicës dhe Shtërpcës, u lejohet shëndetësia dytësore që në shtetet e tjera janë kompetenca të Pushtetit Qendror.

Shqyrtime përfundimtare

E kemi thënë edhe më herët që Qeverisja Vendore konsiderohet si një nga vlerat elementare të arritjeve demokratike dhe me rëndësi të veçantë e sistemit politik në përgjithësi. Por, kjo arritje nuk varet shumë nga populli edhe pse populli është ai që vendos që kush do të qeveris dhe kush do të vendos për problemet e tyre. Por, gjithnjë duhet pasur kujdes që: *"Zgjedhjet vendosin kush do të qeveris dhe shumë pak se ç'përmbajtje do të ketë qeverisja"*.[72] Andaj, përmbajtja e Qeverisjes, nuk varet nga populli që i zgjedh përfaqësuesit, por, janë të zgjedhurit e tyre që vendosin si do të qeverisin. Mu për këtë shpesh ndodh që zgjedhësit të zhgënjehen me veprimet e të zgjedhurve të tyre. Ata (zgjedhësit) kërkojnë një transparencë, pse jo edhe një partneritet me të zgjedhurit e vet. *"Prandaj, marrëdhëniet me qendrën janë bazuar në partneritetin e institucioneve të lira demokratike"*.[73] Në shtetet e rajonit ende nuk është praktikuar apo edhe s'ka filluar një praktikë e tillë. Pushteti në këto shtete (të rajonit) është ende i centralizuar (në Kosovë, deri më 17 shkurt të vitit 2008, shumë kompetenca ishin të rezervuara për zyrtarët e UNMIK-ut). Janë duke u bërë përpjekjet e para, të mos them eksperimentet për decentralizimin e pushtetit vendor. Mirëpo, kjo nismë nuk duket të ketë sukses ngase:

Nën një: në Kosovë ende nuk është bërë centralizimi i plotë i pushtetit;

Nën dy: ende udhëheqin zyrtarët e UNMIK-ut, (tani EULEX);

Nën tre: tentohet të bëhet decentralizimi horizontal;

Nën katër: shkohet kah ndarja territoriale në baza etnike; dhe së fundi,

---

[72] Gjovani Sartori: Ç'është Demokracia. Fq. 45

[73] Po aty: fq. 480

Nën pesë: një e treta e Kosovës (veriu i saj) është jashtë institucioneve të shtetit të Kosovës.

Kur krejt këtë e përmbledhim do të shohim që kemi të bëjmë me një decentralizim politiko-etnik. Edhe pse si Korniza Kushtetuese e Kosovës, Rregullorja 2000/45, kjo e fundit 2007/30 që shfuqizoi Rregulloren e parë për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, Kushtetuta dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës, ashtu edhe Kushtetutat dhe ligjet e Qeverisjes Vendore në Kosovë Lindore, Maqedoni e Mal të Zi, Qeverisjen Vendore e theksojnë ndër vlerat themelore të rendit Kushtetues dhe njëherit përcaktojnë principet themelore në bazë të cilave organizohet dhe funksionon ajo, megjithatë shihet qartë që diçka nuk funksionon. Në të gjitha këto shtete, nëpër disa Komuna janë parë dhe vërejtur përplasjet politike, me ç'rast, në disa prej Komunave, ka pasur edhe bllokime të punës së Kuvendit Komunal. Që të gjitha këto vende, Komunat i kanë paraparë si Njësi të Qeverisjes Vendore, të cilat e kanë territorin e vet, kufijtë e caktuar dhe shtrihen në vendet urbane dhe në ato rurale.

Si në Kosovë, Kosovë Lindore, Maqedoni e Mal të Zi, sipas kushtetutave të tyre dhe Ligjeve në fuqi, qytetarët e kanë mundësinë e pjesëmarrjes në procesin e vendosjes për sa i përket Qeverisjes Vendore. Forma e saj manifestohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, siç janë: iniciativa qytetare, tubimi i qytetarëve dhe referendumi, si formë më e avancuar e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe forma tjetër e Qeverisjes Vendore. Kjo Qeverisje, realizohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur nëpër organet Komunale. Bazuar në dokumentet që përcaktojnë obligimet, të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e Qeverisjes Vendore kam konstatuar që Qeverisja Vendore në këto vende ka tiparet e ngjashme dhe ato që dallojnë në mes vete.

Tiparet e organizimit të këtyre njësive që ngjasojnë në mes vete janë:

1. Komunat, në të gjitha këto vende, janë paraparë që të jenë njësi të Qeverisjes vendore. Ato janë themeluar ose mund të themelohen sipas kushteve të përcaktuara me ligj e në përputhshmëri me Kushtetutat e shteteve.

2. Kanë territorin e vet. Kompetencat dhe përgjegjësitë, janë të një natyre të ngjashme.

3. Secila Komunë, ka emërtimin dhe kufijtë e vet. Ka stemën dhe flamurin. Stema dhe flamuri i Komunës është paraparë që të dallohen nga stema dhe flamuri i shtetit si dhe nga stema dhe flamuri i Komunave të tjera. Kanë buxhetin e tyre.

4. Financohen nga të hyrat Komunale dhe me mjete të cilat Pushteti Qendror i ndan për njësitë e Qeverisjes Vendore. Për realizimin e interesave të përbashkëta dhe kryerjen e punëve të përbashkëta, në kuadër të veprimit të tyre, në territor më të gjerë, Komunat mund t'i bashkojnë mjetet dhe të formojnë ndërmarrje publike të përbashkëta, shërbime publike dhe administratë të përbashkët.

5. Kanë të drejtën e organizimit në asociacione, gjë e cila duhet të bëhet në pajtim me ligjin. Një asociacion i tillë në Kosovë ekziston që nga zgjedhjet e para vendore të pasluftës së vitit 1999, të mbajtura në vitin 2000.

6. Mbajnë të drejtën e bashkëpunimit edhe me njësi të Qeverisjes Vendore të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare.

7. Kanë të drejtën e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me Pushtetin Vendor.

8. Duke pasur për bazë vendimmarrjen nëpër Komuna, është paraparë që Komunat, në mënyrë të pavarur të vendosin për disa çështje që kanë të bëjnë me territorin e Komunës e që janë në interesin e përgjithshëm të banorëve lokal.

9. Administrata e Komunës organizohet nëpërmjet kryerjes së punëve të cilat bien në kompetencë të organeve Komunale. Ajo i kryen dhe përgatit propozim-rregullat dhe aktet e tjera të cilat i miraton Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës si dhe zbaton vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit të Komunës dhe të Kryetarit të Komunës. Ajo gjithkund mund të ketë edhe njësitë organizative për kryerjen e punëve të ngjashme administrative, profesionale dhe punëve të tjera. dhe

10. Përdorimi i gjuhëve nëpër Komuna është përcaktuar me statut të Komunës.

Duke shfletuar dhe komentuar Ligjet që rregullojnë Qeverisjen Vendore të këtyre shteteve, (Rregulloreve të më pashme të UNMIK-ut, në Kosovë), do të thotë Komunave të Kosovës, atyre të Kosovës Lindore, Maqedonisë dhe të Malit të Zi, vërehen edhe disa dallime të theksuara sidomos në ndarjen e pushtetit.

E para: Deri më tani Komunat e Kosovës kishin vetëm Kuvendin Komunal nga dilnin organet udhëheqëse të Komunës. Mirëpo, nga nëntori i vitit 2007, doli edhe organi tjetër, Kryetari Komunës, i cili zgjedhet drejtpërdrejtë nga vota e popullit. Nëpër Komunat e Republikës së Kosovës nuk është paraparë posti i Kryeshefit të Ekzekutivit që zgjidhej nga Kuvendi. Këto ndryshime janë bërë, ngase një formë e tillë e qeverisjes së kombinuar në Kosovë, në trekëndëshin Kuvend - Kryetar i Kuvendit të Komunës – Kryeshef i Ekzekutivit, nëpër Komuna që qeveriseshin nga koalicionet e partive të ndryshme, doli që të jetë joefikase, mbase për shkak të ambicieve politike të partive konkurrente në Kuvendin Komunal. Deri në miratimin e Ligjit mbi Vetadministrimin lokal, nëpër Komunat e Kosovës, Kuvendet Komunale i kryesonin kryetarët e Komunave. Mirëpo pas miratimit të këtij Ligji, Kuvendet Komunale do të zgjedhin kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin nga radhët e anëtarëve të Kuvendit.

E dyta: Në Komunat e Kosovës Lindore, tani për tani janë tre organe udhëheqëse Komunale: Prefekti, Kuvendi dhe Këshilli Komunal. Mirëpo, me ndryshimet që janë bërë tash së voni, në Kushtetutën e Serbisë, Prefekti i Komunës nuk del më nga vota e lirë e qytetarëve, por atë do ta zgjedhin anëtarët e Kuvendit Komunal. Kjo do të thotë që nga Kuvendi i Komunës, do të dalë edhe ekzekutivi. Këtë ndryshim, funksionarët e lartë shtetëror e arsyetojnë me mendimin që do të ketë qeverisje më të mirë. Një nga ministrat serb, kështu e arsyeton ndryshimin e ligjit: "*Sipas mendimit tonë, organet ekzekutive qeverisëse duhet të dalin nga organi përfaqësues*".[74] Vlen të theksohet që në Komunat

[74] Dnevnik: "Uskoro novi zakon o Teritorijalnoj Organizaciji Srbije", intervistë e Milan Markoviq, ministër i administrates shtetërore të Serbisë, Beograd, 12. 11. 07, si dhe shih linkun: www.drzavnauprava.sr.gov.yu/news/

e Kosovës Lindore, sidomos në Komunën e Preshevës, për shkak të mos efikasitetit dhe mos durimit të qeverisjes së kombinuar në mes të Prefektit (ekzekutivit) dhe të Kuvendit Komunal (legjislativit), po për të njëjtat arsye, për pak sa nuk erdhi te bllokimi i punës së Kuvendit Komunal, me ç'rast, me Referendum të organizuar, ra nga posti prefekti i Komunës. Ky lloj qeverisës u tregua dhe po tregohet i paqëndrueshëm në këto Komuna.

E treta: Në Maqedoni e Mal të Zi, edhe më tutje funksionon forma e kombinuar e Qeverisjes Vendore. Do të thotë, Qeverisja e Komunave realizohet duke ndarë pushtetin Kuvendi i Komunës dhe Kryetari Komunës.

E katërta: Në Komunat e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Kosovës Lindore, zgjedhjet për këshilltarë, organizohen çdo katër vite. Në Kosovë edhe kësaj here (mandati i parë pas miratimit të Rregullores 2007/30), këshilltarët e Kuvendeve Komunale do të kenë mandat dy vjeçar.

E pesta: Prefektët e Komunave, në Maqedoni e Kosovë Lindore (prefekti i Komunës në dy Komunat e Kosovës Lindore zgjedhet nga anëtarët e Kuvendi i Komunës) kanë mandat katër vjeçar, Në Mal të Zi, pesë vjeçar, ndërsa në Kosovë, (edhe kësaj here) mandat dy vjeçar.

E gjashta: Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, me rekomandim të dokumentit gjithëpërfshirës të Ahtisarit, në kompetenca të Qeverisjes Vendore nëpër Komunat e Kosovës që janë të banuara kryesisht me banorë serb, ka hyrë edhe shkollimi i lartë dhe shëndeti publik sekondar. Këto kompetenca në shtetet e tjera janë të rezervuara për Pushtetin Qendror.

E shtata: Në Komunat e Kosovës Lindore, nuk lejohet përdorimi i simboleve të pakicave kombëtare. Ndërsa në Komunat e Maqedonisë, u bë përpjekja e parë për ndalimin me ligj e përdorimit të simboleve kombëtare shqiptare. Mirëpo, me reagimin e spektrit politik shqiptar në këtë shtet, u pezullua një tentativë e tillë. Por, ende qëndron pezull, ngase është kufizuar lejimi i përdorimit i simboleve vetëm nëpër godinat e Komunave e jo edhe jashtë tyre.

E teta: Në Kosovë, bëhen përpjekje të decentralizohet pushteti në baza politike- etnike.

E nënta: Komunat që qeverisen nga serbët lokal të Kosovës, (me Ligjin për Qeverisje Lokale, me rekomandim po ashtu të dokumentit gjithëpërfshirës të z. Ahtisari) përkatësisht enklavave serbe u jepet e drejta që të financohen edhe nga Serbia.

E dhjeta: Në Komunat e Kosovës nuk do të ketë sekretar të Kuvendit Komunal. Atë funksion do ta kryej shefi i departamentit të administratës dhe personelit.

Synimi parësor i teoricienëve bashkëkohorë është kërkimi dhe gjetja e teorive të reja rreth Qeverisjes vendore. Ata kërkojnë forma të reja të pjesëmarrjes së qytetarëve në punët me karakter vendor, të cilat do t'i përmbushnin nevojat e popullatës. Sepse, *"Instituti i Qeverisjes marrë në kuptimin e përgjithshëm paraqet njërin nga institutet themelore të proceseve shoqërore"*[75]. Gjithnjë duke u mbështetur në mendimet e teoricienëve bashkëkohorë, mund të konstatohet që Kosova, Kosova Lindore, Maqedonia e Mali i Zi ndodhen para sfidave të mëdha në drejtim të reformave, veçanërisht në ato që i përkasin pushtetit vendor.

Kushtetutat aktuale të këtyre shteteve të dala nga ish Jugosllavia, paraqesin një problem konceptual sa i përket Qeverisjes Vendore edhe përkundër faktit që të gjitha, këtë e radhitin në kuadër të vlerave themelore kushtetuese. Shthurja e karakterit nacional e Kushtetutës së këtyre shteteve dhe animi i tyre kah koncepti qytetar do t'i ndryshonte proceset e hapura në këto shtete, si në aspektin politik ashtu edhe në hapjen e shtigjeve drejt një rregullative tjetër juridike e cila do të binte ndryshime edhe në kuadër të pushtetit lokal. Në këto shtete, disa punë të cilat bien në kompetenca të Komunave, ende i kryejnë organet e administratës qendrore. Këto kompetenca do të duhej të barten në organet Komunale, në mënyrë që të kuptohet dhe të flitet për decentralizim dhe Qeverisje Vendore më reale. Garanci më të mëdha të ekzistimit të një Qeverisjeje

[75] Esat Stavileci: Hyrje në Shkencat Administrative, fq. 246

Vendore reale do të bëheshin kur, këto kompetenca do të kryheshin nga vetë organet Komunale.

Duke pasur parasysh këto që u thanë më lart, shihet që Komunat si njësi qeverisëse duket që nuk kanë një pozitë të volitshme të Qeverisjes. Andaj, ato nuk arrijnë që ta sendërtojnë një gjë të tillë ashtu siç pritet nga zgjedhësit. Thënë ndryshe, kjo varet nga shkalla e decentralizimit të pushtetit. Ose siç do të shprehej sociologu Giddens, e tëra varet nga: *"Pushteti i të cilit mbështetet nga një sistem ligjor dhe nga aftësia për të përdorur forcën për zbatimin e politikave të tij"*.[76] Në Kosovë, pretendohet të bëhet diçka jashtë kësaj natyre. Për të përmbushur apetitet e politikës aktuale serbe, autoritetet qeverisëse në Kosovë, (me rekomandim të faktorit ndërkombëtar) tentojnë që ndarjen territoriale ta marrin në rishqyrtim dhe ta bëjnë një ndarje tjetër që nuk përputhet me dëshirat e qytetarëve e as të interesit të përgjithshëm. Kjo shihet sidomos në Komunat e përziera (multietnike) si në Gjilan, Viti, Novo-Bërdë, Mitrovicë, Graçanicë e Shtërpce. Duke u thirrur në decentralizimin horizontal, ose më mirë të thuhet politik, Komunës së Gjilanit tentohet t'i merren shumë fshatra, përfshirë edhe Bresalcin i cili gjendet diku në kilometrin e dhjetë nga ky qytet e t'i bashkëngjitet Novo- Bërdës. Në këtë mënyrë, qytetarët e këtij lokaliteti që të gjitha lidhjet i kanë me qytetin e Gjilanit do të bëheshin pjesë artificiale e Novo-Bërdës. Po ashtu, kur bëhet fjalë për themelimin e Komunës së Parteshit (fshat me popullatë serbe, në Komunën Gjilanit), tentohet t'i merret territori i Komunave të Gjilanit dhe Vitisë. Pra, këtu po bëhet përpjekja e ndarjes territoriale dhe e ndryshimit të kufijve të Komunave ekzistuese, për të themeluar Komuna të reja, pa konsultuar dhe pa marrë miratimin e banorëve (shqiptarë) lokal. Sa i përket gjuhës së përdorur në të shkruar dhe në të folur, (asaj zyrtare), në Kosovë, gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe dhe ajo serbe. Në Kosovë Lindore gjuha serbe dhe ajo shqipe. Në Maqedoni gjuha maqedonase e në Komunat ku ka më shumë se 20% e popullatës shqiptare si gjuhë zyrtare përdoret edhe gjuha shqipe. Po ashtu edhe në Mal të Zi si në Ulqin ashtu edhe në

[76] Anthony Giddens: Sociologjia, fq.298

Tuz, gjuhë zyrtare janë gjuha malazeze (serbishtja) dhe shqipja. Komunat mund të vendosin për ndonjë gjuhë të ndonjë pakice që ka një numër të konsiderueshëm të banorëve.

Përkrah krejt asaj që u shtjellua dhe u tha më lart, Pushteti Qendror i këtyre vendeve, nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, shfrytëzojnë tërë potencialin e tyre shtrëngues për të kontrolluar këto njësi të Qeverisjes Vendore. Edhe pse janë të përcaktuara të gjitha të drejtat, obligimet, kompetencat e përgjegjësitë dhe të saktësuara me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Komunat edhe më tutje mbahen nën kontrollin e Pushtetit Qendror. Kështu në mënyrë mbase indirekte, Pushteti Qendror, me ndihmën e mekanizmave të ndryshëm, bën udhëheqjen, menaxhimin, administrimin si dhe kontrollin e Pushtetit Vendor. Kjo në dukje, nuk paraqet ndonjë rëndësi të veçantë, ngase Kushtetutat, ligjet dhe dispozitat e tjera ligjore, Komunave u japin të drejtat e Qeverisjes me atë territor të caktuar. Por, njësitë e Qeverisjes Vendore, në vete ngërthejnë organet udhëheqëse politike të cilat zgjidhen në mënyrë demokratike në zgjedhjet që organizohen, menaxhohen dhe kontrollohen nga Pushteti Qendror i këtyre vendeve. Për dallim nga shumë shtete të Evropës, në këto shtete, shumë kompetenca të cilat janë të lidhura për Qeverisjen Vendore, ende i kryejnë Organet e Administratës Qendrore. Andaj me të drejtë mund të konstatohet që Qeverisja Vendore në këto shtete, është ende larg standardeve të parapara në Kartën Evropiane për Autonominë lokale. Kjo vjen si rrjedhojë e shkallës së lartë të centralizimit të pushtetit. *"Më pak pushtet për qeverisësit nuk do të thotë automatikisht më shumë pushtet për të qeverisurit"*.[77] Por ama, Politika evropiane moderne do një angazhim më të madh të shteteve në decentralizimin e pushtetit nga lart poshtë. Në këtë mënyrë, qytetarët do të realizonin nevojat dhe të drejtat elementare, të drejta këto që i gëzojnë qytetarët e vendeve skandinave si dhe ata të Francës, Britanisë dhe Amerikës. Demokracisë së drejtpërdrejtë duhet t'i jepet një rëndësi më e madhe, për shkak se nuk mund të ketë shkollë më të mirë as për pushtetarët e as për qytetarët se sa Referendumi, Iniciativat

[77] Gjovani Sartori: Ç'është Demokracia, fq. 70

Qytetare dhe Tubimet e Qytetarëve. Sa i përket rregullativës juridike në kuadër të sistemit juridik në përgjithësi, e në kuadër të Qeverisjes Vendore në veçanti, ndryshimet janë të patjetërsueshme. Vetëm kështu do të shkohet drejt një shoqërie civile të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme e cila do të ndërtonte Qeverisjen Vendore të mbështetur në parimet demokratike, që do të ishte e pranueshme për popullatën vendore. Shikuar nga ky aspekt, në Kosovë, janë duke u bërë përpjekjet e para, të mos them eksperimentet për decentralizimin e pushtetit vendor. Mirëpo, kjo nismë nuk duket të ketë sukses ngase në Kosovë ende nuk është bërë centralizimi i plotë i pushtetit. Andaj do të duhej së pari bashkuar tërë vendin e më pas të punohet rreth decentralizimit. Ndërkaq në shtetet për të cilat bëmë fjalë, i kanë të gjitha parametrat që të bëjnë një hap të tillë. Kështu, para opinionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, do të paraqiteshin si shtete demokratike evropiane. Deri sa nuk bëhet një gjë e tillë, Qeverisja Vendore, nuk do të sheh ndonjë ndryshim për të mirë. Andaj, si përfundim i krejt kësaj që u shtjellua më lart do të ishte:

nën një: Shtetet si Serbia e Maqedonia, të bënin një hap para drejt një shteti qytetar;

nën dy: në të gjitha këto vende, të punohet më tepër rreth dhënies së kompetencave Komunave (përafërsisht si në shtetet perëndimore);

nën tre: të avancohen të drejtat e qytetarëve;

nën katër: të rishqyrtohen të drejtat e pakicave; dhe

nën pesë: të gjithë qytetarët, pavarësisht etnitetit kombëtar, fetar a kulturor të trajtohen të barabartë.

Concluding analyses

We said previously that local governance is one of elementary values of democratic achievements and has particular importance in political system in general. But, this achievement does not very much depend on people even if people decide who will govern and decide about their problems. But, always should be cautious that: "*Elections decide who will govern and least about substance of government*". Therefore, the substance of government does not depend on electorate who elects representatives but the elected ones decide how to govern. Very much so, this is the reason that electorate often is disappointed by their elected representatives. Electorate requires transparency and even a partnership with their elected representatives. "*Therefore, relations with central level are based on partnership of free democratic institutions*". Yet such a practice is not initiated at regional countries. In these countries (region) power still remains at central level (in Kosovo many competences are reserved to UNMIK officials). First efforts, not to say experiments on decentralization of local authority are being made. However, this initiative should succeed as:

First: In Kosovo complete centralization of authority is not achieved yet;

Second: Still lead UNMIK officials;

Third: Attempts are being made on horizontal decentralization;

Fourth: It leads to territorial separation on ethnic grounds; and in the end

Fifth: One third of Kosovo (north part) remains out of Kosovo state institutions.

While summarizing all the above, it appears that this is a political-ethnic decentralization. Even if Constitutional Framework of Kosovo, Regulation 2000/45 and 2007/30 invalidate the very first Regulation on Self governance of

Kosovo Municipalities and also Constitutions and Laws on local self-administration in East Kosovo, Macedonia, Montenegro, local governance is highlighted as fundamental value of constitutional order and at the same time determines basic principles under which it should be organized and function, however, it is evident that something is not functioning properly.

In all the above-mentioned countries, there have occurred political clashes within certain municipalities including blockage of functioning of the municipal assembly. Municipalities are foreseen as local administration unit, with their own territory, borders and extend to urban and rural areas. In Kosovo, East Kosovo, Macedonia and Montenegro, according to their constitutions, respectively Constitutional Frameworks, citizens have possibility to take part in deciding process regarding local governance. This is reflected directly through citizens' initiatives, citizens association and referendum as an advanced manner of direct democracy and other forms of local governance. Such governance is realized throughout elected representatives within municipal bodies.

Similar organizational features of these units are:

1. In all the above-mentioned countries, municipalities are foreseen to be local self government units. Municipalities are or should be established according to requirements prescribed by law in accordance with state constitution.

2. Municipalities have their own territory, competences and responsibility.

3. Each municipality has its own name and boundaries, budget, emblem and flag. Emblem and flag of each municipality should be different from state and other municipalities' flag and emblem.

4. Municipalities are financed by incomes from municipal assets and means allocated by government to local self government units. In order to achieve joint interest and accomplish common duties, municipalities may join their means and establish common public enterprises, public services and joint administration.

5. Municipalities have the right to organize associations, which should be in compliance with the law. Such association in Kosovo exists since the first after war elections in 2000.

6. Municipalities enjoy the right to cooperate with other local governmental units of other countries and also with international organizations.

7. Enjoy the right to become members of international organizations related to local administration.

8. Within their territory, municipalities may decide about certain issues of general interest of local community.

9. Municipal administration is organized within the competence of municipal bodies. Administration prepares and proposes rules and other documents that should be adopted by Major and Municipal Assembly. Also, administration should have organizational unit to perform similar administrative and professional duties.

10. Use of language within municipalities should be regulated by municipal statute.

However, reading and commenting Laws on local Self administration of municipalities within these countries (applicable Regulation in Kosovo) which means Kosovo municipalities have some dissimilarities concerning apportion of power.

First: So far, Kosovo municipalities had only municipal assemblies from which emerge municipal leading bodies. However, as from this year (2007) for the first time, Municipal Assembly will be leaded by a president, elected directly by electorate and there would not be any Chief Executive appointed by assembly. Such changes occurred as combined governance in Kosovo in a sort of triangle Assembly- Mayor of Municipal Assembly- Chief Executive in municipalities leaded by coalition of different political parties appeared non effective, possibly because of ambitious of competing political parties. Kosovo is the first country in the region with such a governing system, where Mayor of the Municipal Assembly is not selected by members of Assembly but by direct free vote of electorate.

Second: Currently in municipalities in East Kosovo, there are three municipal leading bodies: Mayor, Assembly and Municipal Council. However, late changes in Constitution of Serbia (even if such changes still did not become component part of Law on Local Self-Administration of this state) in the future there would not be Mayor but only President of the Municipal Assembly, while from the Assembly would come up executive. "*According to our opinion, governmental executive bodies should lead to representing bodies*". It is worth to emphasize that in municipalities in East Kosovo in particular in Presheva Municipality as a result of non efficiency and non tolerance of combined governance between Prefect (executive) and Municipal Assembly (legislative) the functioning of Municipal Assembly almost got a blockage. In that case, a referendum was organized and Prefect of Municipality failed to obtain sufficient number of votes. Therefore, this type of self governance in these municipalities appears to be unsustainable.

Third: In Macedonia and Montenegro yet functions combined structure of local administration. This proves that municipal administration functions by sharing power between Municipal Assembly and Prefect of Municipality.

Fourth: In municipalities in Macedonia, Montenegro and East Kosovo, members of municipality are elected every four years. In Kosovo, this time (first mandate after approval of UNMIK Regulation 2007/30) members of Municipal Assembly would have a two years mandate.

Fifth: In Macedonia, Mayor has a four years mandate while in Montenegro five years. In Kosovo, Mayor has a two years mandate. In East Kosovo municipalities (according to Constitutional changes) there would not be a Mayor.

Sixth: According to Ahtisari comprehensive document, municipalities in Kosovo inhabited with majority of Serbs, high education and secondary public health fall within their municipal self governance competences. In other countries such competences are reserved for central governance.

Seventh: In East Kosovo municipalities is forbidden use of national symbols of minorities. In Macedonia, there were attempts to prohibit by law the use of Albanian national

symbols. However, such an attempt was suspended after reaction of Albanian political parties. Hence, the use of national symbols remains limited as symbols might be used only within municipality buildings.

Eighth: In Kosovo effort are being made to decentralize the power on political-ethnic backgrounds.

Ninth: Municipalities leaded by Kosovo local Serbs (according to Ahtisary comprehensive document) respectively Serb enclaves enjoy the right to be financed from Serbia.

Tenth: Municipal Assemblies in Kosovo should not have a Secretary. Head of the Department of Administration and Personnel shall act as Secretary to the Municipal Assembly.

Primary goal of contemporary theoretician is to search and find new theories concerning local governance. They search for new ways of citizen participation at local matters in order to fulfill the needs of population. "*General perception of Governmental Institute represents one of fundamental institutions of society processes*". Relying on ideas of contemporary theoreticians, it might be concluded that Kosovo, East Kosovo, Macedonia, Montenegro stand before big challenges with regard to reforms in particular local governance.

Current constitutions of former Yugoslav republics represent a conceptual problem regarding local governance notwithstanding the fact that they consider it as constitutional fundamental value. Destruction of national character of constitutions and their incline to civil concept would change the opened processes in these countries at political aspect and would lead to a legal regulation that would make changes within local governance. In the above-mentioned countries, certain duties falling under municipal competences are being performed by central administration bodies. Municipalities should hold such competences in order to understand and talk about decentralization and local governance. Real local governance would exist when municipal bodies would carry such competences.

In the light of the above, it appears that municipalities as governmental units do not have a convenient governmental position. Therefore, municipalities do not fulfill electorate

expectations. So, this depends from the level of decentralization or sociologist Giddens would say everything depends on "*Authority supported by a legal system and capability to make use of force in implementing its policies*".

In Kosovo is assumed to make something different. In order to fulfill appetites of Serbs current policies, authorities in Kosovo (UNMIK) are attempting to make a territorial separation which is not in accordance with aim and general interest of population. This is evident in particular in multiethnic municipalities as in Gjilan, Viti, Novo –bërdë, Mitrovica, Graçanica and Shtërpce. Relying on horizontal decentralization or better to say political decentralization, Gjilan municipality may lose many villages including village Bresalce which is 10 km far from the town and be jointed to Novo-Bërda municipality. In this way, citizens of this locality that are connected to Gjilan would become artificial part of Novo-Bërdo.

In Kosovo, official languages are Albanian and Serbian. In East Kosovo official languages are Serbian and Albanian. In Macedonia, official language is Macedonian language but in municipalities were more than 20 % o population is Albanian, official language is also Albanian language. In Montenegro, in Ulqin and Tuz official languages are Montenegrin (Serbian) and Albanian language. However, municipalities may decide about use of any other language of minorities in case they have considerable number of inhabitants.

Notwithstanding the above, central authority of these countries, in particular in Kosovo, through different mechanism UNMIK is using all potential to control local government units. Even if rights, obligations, competences and responsibilities are clearly described in Law on Local Self Governance, municipalities are still under control of central authority, respectively UNMIK. Hence, central authority, perhaps indirectly leads, manages, administers and has control over local authority. Apparently, this might not be of particular importance having in mind that constitution, laws and other legal provisions provide to municipalities the rights to govern certain territory. However, local governmental units include leading political bodies elected

in a democratic way during elections organized, managed and controlled by central authorities of these countries. Unlike in Europe, in these countries many competences related to local governance are still under central administration. Therefore, it might be concluded that local governance in these countries is far from standards as provided in European Chart for Local Self Administration. This appears as a consequence of high level of centralization of authority. "*Less authority to governmental does not necessarily mean less authority to govern*". But, modern European policy requires higher engagement of states to decentralize authority from the top to the bottom. In this way, citizens would enjoy their fundamental rights as do people in Scandinavia, France, Great Britain and USA. Particular attention should be given directly to democracy as there is no better education for government and people than Referendum, Initiatives and Citizens' Associations.

As for legal rules within legal system in general, in particular local governance changes are inalienable. This is the only way to move forward into an accountable and contentious civil society which would establish local governance relying on democratic principles, accepted by local population. From this aspect, in Kosovo there are ongoing attempts not to say experiments regarding decentralization of local authority. However, this initiative does not appear to be successful as Kosovo has lack of centralization of authority. On the other hand, the above-mentioned countries have all parameters to take such a step. Accordingly, in front of national and international community they would appear as democratic countries. Until this is not reached, local governance would not experience any positive change. Thus, conclusion of all the above would be:

First: Serbia and Macedonia should make a step forward to a civic state;

Second: In all these countries more efforts should be made regarding proving competences to municipalities

Third: Civic rights should be more advanced;

Fourth: minority rights should be reviewed;

Fifth: All citizens despite their ethnic, religious and cultural background should be treated equally.

BIBLIOGRAFIA

BURIMET PARËSORE

- Congress of Local and Regional Authorities of Europe (Fifth Session). Rapporteurs: Henry Frendo (Malta) Hans Ulrich STOECKLING (Switzerland). Strasbourg, 7 May 1998
- Congress of Local and Regional Authorities of Europe (Sixth Session). Rapporteur: Viorel Coifan (Romania). Strasbourg, 22 June 1999
- Council Of Europe: Konventa për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Strasburg, Prepared in electronic format by the Council of Europe Field Office in Tirana. March, 2003
- Council of Europe Publishing: European Charter Of Local Self-Government and explanatory report. Strasbourg, 1986, Reprinted 1996, March 1998, October 1998, October 1999
- Evropska Konvencija Za Zastitu Ljudskih Prava i Osnovnih Sloboda. Rim, 4 novembra 1950, 4 novembra 2000
- Evropska povelja o regionalnim i manjinskim jezicima. Strazbur, 5 Novembra 1992
- Filo, Lambro. Historia për Sistemet e Qeverisjes. Botim i përmirësuar, Tiranë, 2004
- Karta Evropiane e Autonomisë Lokale. Seri traktatesh Evropiane nr. 122. shkurt 1991
- Këshilli i Evropës: Hyrje në Marrëveshjen Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. tetor 1998 H (98) 5 rev 3, 1999
- Këshilli i Evropës: Veprimtari e realizime, material i plotësuar në shtator 1999, konceptimi: Isabelle Caraës, përkthim jozyrtar, shtypur në Gjermani
- Këshilli i Evropës: Karta Evropiane e Autonomisë Lokale. Strasburg, 1991
- Kval&Mellbye&Tranoi, Politika dhe Demokracia. Rozafa, Prishtinë, 2007
- Konventa - kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe raporti shpjegues. Prepared in elektronik format by the Council of Europe Field Office in Tirana, (March 2003

- Konventa e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (STE1 nr. 5) (Amenduar sipas Protokollit nr. 11) shoqëruar nga Protokolli shtojcë dhe Protokollet nr. 4, 6, 7, 12 dhe 13. Sekretariati i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Vilnius 3 maj 2002
- Kushtetutat. Përgatiti për botim: Dritan Palnikaj. Tiranë, 2006
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991, tekst i përkthyer në gjuhën shqipe
- Ligji për Vetadministrim Lokal. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 52/1995)
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Doracak i Ligjeve për Komunat Nr A-001/01, 14 prill 2006
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës (internet)
- Nacrt Statuta Opstine Ulcinj.("Sluzbeni list RCG" br 42/03, 28/04, 75/05, 13/06) 29.03. 2007
- Obrazlozenje Evropske Povelje o Lokalnoj Samoupravi. Strazburg, 1986
- Okvirna Konvencia za Zastitu Nacionalnih Manjina. Strazburg, 1 februar 1995
- Propozimi Gjithëpërfshirës Për Marrëveshjen Për Statusin e Kosovës. (Dokument) 2 shkurt 2007
- Rohmer, Benoit Florence. Çështja e minoriteteve në Evropë. Tekste dhe analiza, Albin, Tiranë, 1996
- Savjet Evrope: Obrazlozenje Evropske Povelje o Lokalnoj Samoupravi, Strazburg, 1986
- Sopjani, Enver. Përmbledhje aktesh ndërkombëtare për Kosovën 1999-2004. Prishtinë, 2005
- Statuti KK Preshevë. "Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë" nr. 9/2002
- Statutarna Odluka Opstine Tuzi. ("Sluzbeni List RCG-opstinski propisi" br. 60/06, 28. 12. 2006
- Statuti i KK Tetovë. ("Fletorja Zyrtare e RM" br. 55/04)09.06. 2006
- Statut Opstine Bujanovac. (Sluzbeni glasnik Republike Srbije" br 9/02) 16 maj 2002
- Statut Opstine Ulcinj ("Sluzbeni list RCG"br 23/95, 12. 01. 1996
- United Nations-Unmik Rregullore Nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës. 22 dhjetor 2001
- United Nations - Unmik: Rregullore Nr 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, 11gusht 2000

- United Nations - Unmik: Rregullore Nr 2007/30 Mbi Ndryshimin e Rregullores 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, 16 tetor 2007
- Unmik/Reg/2001/9. Rregullore Nr. 2001/9 Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë. 15 maj 2001
- Unmik – Kosovë- Dragash. Statut. 11. 08. 2000
- Zakon o Lokalnoj Samoupravi Republike Srbije. "Sluzbeni glasnik RS", br. 49/99 i 27/01
- Zakon o Lokalnoj Samoupravi Crne Gore."Sluzbeni list RCG", br. 30/92
- Zakon za Lokalnata Samouprava. "Sluzben vesnik na Republika Makedonija" br. 5 od 29 januari 2002 god.

LITERATURA NDIHMËSE

- Ahmeti, Zef. Mendime mbi kushtetutën dhe shtetin. Zagreb, 2005
- Bianku, Ledi. Të Drejtat e Njeriut në Evropë. Botim i Qendrës Evropiane, Tiranë, 2001
- Bytyçi, Enver. Shqipëria peng i një Demokracie të Manipuluar. Koha. Tiranë, 2004
- Duhamel, Oliver. E Drejta Kushtetuese. Logos - A: Shkup, 2004
- Dutertre, Gilles & Jakob van der Velde. Përzgjedhje e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe vendimeve e raporteve të Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut. Drejtoria e të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës. përktheu: Kastriot Myftiu. Tiranë, Shtator, 1998
- Eko, Umberto. Si bëhet një punim diplome. Botime përpjekja, Tiranë, 1997
- Giddens, Anthony. Sociologjia. Përkthyen nga origjinali: Teuta Starova, Kastriot Myftiu. Shtëpia botuese Çabej. Tiranë
- Horvath, M. Tamas. Decentralizacija: Eksperimenti i reforme. Adea, Prishinë, 2007
- Index Kosova: Kosovski Mozaik 2006 Istrazivanje lokalne vlasti i javnih usluga. Prishtina. Oktobar, 2006
- Islami, Hivzi. Kosova dhe Shqiptarët. Pena. Prishtinë, 1990
- Ismaili, Hilmi e Fatmir Sejdiu. Historia e Shtetit dhe e së Drejtës. Prishtinë, 2002
- Ismaili, Osman: Fillet e së Drejtës, Prishtinë, 2004
- Ismaili, Osman: Filozofia e së Drejtës. Prishtinë, 2006

- Kasimati, Mimoza & Mimoza Manxhari. Sjellje Organizative. SHBLU. Tiranë, 2005
- Kelmendi, Ibrahim. Një shtyllë e Kosovës quhet Preshevë. Preshevë, 2006
- KIPRED: Local Government and Administration in Kosovo. Prishtina, September 2004
- Klosi, Ardian. Shqipëria ç'mund të jetë. Botime përpjekja. Tiranë/Munchen, 1997
- Lean, Mc Iain. Fjalor Politik. Përktheu dhe përshtati: Zef Simoni. Shtëpia e Librit & Komunikimi, Tiranë, 2001
- Maroviç, Miodrag. Balkanski dzoker Albanija i Albanci. Bar, 1995
- Mjeldhejm, Leiv & Solvi Lillejord e Erik Solvberg. Spektri – Shkencat shoqërore për nxënësit e shkollave të mesme. (Botim i dytë) Rozafa, Prishtinë, 2006
- Nishku Majlinda. Procesi dhe shkrimet funksionale. Qendra për Arsim Demokratik. Tiranë, 2004
- Ramosaj, Berim. Management -Bazat e menaxhimit (botim i katërt). Prishtinë, 2004
- Sadiku, Nehat. Demokracia në perëndim. Shkupi. Shkup, 2006
- Salihu, Kurtesh, E Drejta Kushtetuese I, Prishtinë, 1998.
- Sartori, Gjovani. Ç'është Demokracia. Tiranë, 1998
- Si të shkruajmë një ese. Përgatiti Bardhyl Musai. Qendra për Arsim Demokratik. Tiranë, 2004
- Si të shkruajmë një punim kërkimor. Përgatiti Elona Boce. Qendra për Arsim Demokratik. Tiranë, 2004
- Stavileci, Esat. E drejta administrative. dispensë, Prishtinë, 1981
- Stavileci, Esat. Elemente të së Drejtës Administrative. Fakulteti Juridik, skript, Prishtinë, 1995
- Stavileci, Esat. Hyrje në Shkencat Administrative. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës. Prishtinë, 1997
- Stavileci, Esat & Pajazit Nushi. Të vërteta për Kosovën. Lidhja Shqiptare në Botë. Prishtinë, 2000
- Stavileci, Esat. Vazhdimësia e mendimit për Kosovën dhe çështjen shqiptare. Lidhja Shqiptare në Botë. Prishtinë-Tiranë-Tetovë, 2001
- Stavileci, Esat. Kosova dhe çështja shqiptare në udhëkryqet e kohës. Instituti Për Studime Bashkëkohore. Prishtinë, 2005
- Stumpf, S. E: Filozofia, Historia, Problemet, përkth: Kastriot Myftiu & Paqsor Shehu, Tiranë: Toena
- Weber, Max. Politika si profesion. Asdreni. Shkup, 2006

Burime nga shtypi:

- „Koha Ditore“8 gusht 2006, „Korniza Për Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë“ (dokument)
- “Zeri” e enjte, 8 mars 2007 “Ndryshimet në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”, faqe 4-5
- “Zeri” 4 shtator 2007, “Partitë i mbajnë sekret emrat e kandidatëve për prefekt të Prishtinës”, faqe 1-3
- “Bota Sot” 6 shtator 2007” “Listat e hapura një avancim i Demokracisë në Kosovë”, intervistë e Sazan Ibrahimit, Kryeshef ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, faqe 7.
- “Dnevnik” 12 nëntor 2007, “Uskoro novi zakon o Teritorijalnoj Organizaciji Srbije”, intervistë e Milan Markoviq, ministër në Qeverinë e Serbisë, faqe 1.

Burime nga interneti:

- linku: www.drzavnauprava.sr.gov.yu/news;

FERID SELIMI

QEVERISJA VENDORE
- SHQYRTIME KRAHASIMTARE

Formati B5 (16 x 24 cm)

Madhësia: 9½ tabakë shtypi

Tirazhi: 500 copë

Realizimi kompjuterik
Valon J. Fetahu
Prishtinë

U shtyp në shtypshkronjën

_____
Prishtinë

Katalogimi në botim – (**CIP**)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës